Funded by
the European Union

unicef
for every child

# RISHIKIMI I SISTEMEVE TË TË DHËNAVE ADMINISTRATIVE

## për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë



**Publikuar nga:**
Programi i UNICEF-it në Kosovë*
Prishtinë, Kosovë

**Autor:** Dr./Prof. Robin N. Haarr, PhD
Konsulente UNICEF-it
robinhaarr@yahoo.com

*2023*

Ky vlerësim është përgatitur si pjesë e partneriteti me Bashkimin Evropian në Kosovë për projektin "Mbrojtja e fëmijëve të cenueshëm në Kosovë", të financuar nga Bashkimi Evropian dhe të zbatuar nga UNICEF-i. Materialet, përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të ekspertit të angazhuar në vlerësim dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe UNICEF-it.

**Citimi i sugjeruar:**
Haarr, R.N. (2022). ***Rishikimi i Sistemeve administrative të të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe Çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë. UNICEF: Prishtinë, Kosovë.***

**Të gjitha referencat për Kosovën duhet të kuptohen duke iu referuar Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999).*

# Përmbajtja


**HYRJE 7**

Arsyetimi dhe sfondi ... 7

Të kuptuarit e të dhënave administrative ... 7

**METODOLOGJIA ... 10**

Qëllimi dhe fushëveprimi ... 10

Objektivat ... 10

Qasja e rishikimit ... 10

**AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS (ASK) ... 14**

Të dhënat administrative ... 14

Të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe banesavea ... 14

**MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE (MFPT) ... 15**

Kuadri Ligjor ... 15

Të dhënat administrative ... 16

**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT (MASHTI) ... 18**

Të dhënat administrative ... 18

Anketa e mbështetur nga UNICEF për funksionimin e fëmijëve ... 21

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË (MSH) ... 23**

Të dhënat administrative ... 23

**POLICIA E KOSOVËS ... 25**

Të dhënat administrative ... 25

**KËSHILLAT PROKURORIAL DHE GJYQËSOR TË KOSOVËS ... 26**

Të dhënat administrative ... 26

**MINISTRIA E DREJTËSISË (MD) ... 28**

Të dhënat administrative ... 28

**STREHIMORET PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE TË OPERUARA NGA OJQ-të ... 30**

Të dhënat administrative ... 30

**KONKLUZIONET ... 32**

**REKOMANDIME ... 34**

Koordinimi për Fuqiaimin e Sistemeve Administrative të të Dhënave ... 34

Të zhvillohen standarde/udhëzime për të dhënat administrative ... 35

Ngritja e kapaciteteve për të përmirësuar mbledhjen dhe analizën e të dhënave ... 35

Ngritja e kapaciteteve për të forcuar përdorimin e të dhënave ... 36

Të zhvillohen grupe minimale të të dhënave dhe ndarje ... 36

Të zhvillohen Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Ndarjen e të Dhënave ... 37

Të fuqizohet rëndësia, saktësia dhe afati kohor i të dhënave ... 37

**SHTOJCA A: TREGUESIT PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE TË MBROJTJES SË FËMIJËVE ... 39**

**SHTOJCA B : MJETI PËR RISHIKIMIN E TË DHËNAVE ADMINISTRATIVE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE ... 50**

# SHKURTESAT

| | |
|---|---|
| **MFF** | Moduli i funksionimit të fëmijëve |
| **SIMR** | Sistemi Informativ për Menaxhimin e Rasteve |
| **RCSV** | Regjistrimi civil dhe statistikat vitale |
| **OShC** | Organizatë e shoqërisë civile |
| **SMIFAK** | Sistemi i menaxhimit të informatave për fëmijët me aftësi të kufizuara |
| **SIMDhF** | Sistemi i menaxhimit të informatave për dhunën në familje |
| **SMIA** | Sistemi i menaxhimit të informatave në arsim |
| **BE** | Bashkimi Evropian |
| **DShMS** | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale |
| **SMISh** | Sistemi i menaxhimit të informatave shëndetësore |
| **PIShS** | Platforma e integruar për shërbime sociale |
| **ASK** | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| **SMIPK** | Sistemi i menaxhimit të informatave të Policisë së Kosovës |
| **MFPT** | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| **MPB** | Ministria e Punëve të Brendshme |
| **MASHTI** | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit |
| **MSH** | Ministria e Shëndetësisë |
| **MD** | Ministria e Drejtësisë |
| **OJQ** | Organizatë joqeveritare |
| **KSC** | Korniza e Sigurimit të Cilësisë |
| **OZhQ** | Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm |
| **KSSC** | Korniza Statistikore e Sigurimit të Cilësisë |
| **SMIShS** | Sistemi për menaxhimin e informatave të Shërbimeve Sociale |
| **SIMS** | Sistemi i Integruar i Mirëqenies Sociale |
| **TransMonEE** | Monitorimi transformues dhe ekuiteti i shtuar |
| **OKB** | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| **KKSC e OKB-së** | Korniza Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë e Kombeve të Bashkuara |
| **UNICEF** | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët |

# PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Përderisa ka pasur progres të konsiderueshëm në Kosovë në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve, situata e përgjithshme nuk ka qenë uniforme. Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm bën thirrje për investim në të gjithë fëmijët dhe të rinjtë me qëllimin që "të mos lëmë askënd prapa". Investimi në të gjithë fëmijët dhe të rinjtë është thelbësor për përkushtimin e Kosovës për përparim drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ-ve). Një sfidë e madhe mbetetkapaciteti institucional për të gjeneruar të dhëna të besueshme që janë ndërkombëtarisht të krahasueshme dhe mund të përdoren për të monitoruar progresin drejt OZhQ-ve dhe për të informuar vendimmarrjen dhe formulimin e politikave.

Qëllimi i kësaj pune është rishikimi i sistemeve të të dhënave administrative që mbledhin të dhëna për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve. Fokusi kryesor ishte në sistemet administrative të të dhënave të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) dhe sektorëve të tjerë përkatës, duke përfshirë të dhënat e shpërndara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Ky rishikim eksploroi se ku ekzistojnë mundësitë për të fuqizuar mbledhjen e të dhënave, për të lidhur dhe harmonizuar sistemet e të dhënave administrative dhe për të forcuar raportimin për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe treguesit e lidhur me mbrojtjen e fëmijëve. Gjetjet nga ky rishikim nxorrën rekomandime të bazuara në dëshmi që synojnë të informojnë hapat e ardhshëm dhe ndërhyrjet vijuese. Kjo analizë e rëndësishme është pjesë e një projekti më të gjerë që ka UNICEF-i në Kosovë me BE-në Kosovë për të mbështetur fëmijët nga komunitetet e margjinalizuara.

Gjetjet nga ky rishikim tregojnë se të dhënat administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve janë të fragmentuara nëpër dhe brenda ministrive dhe sektorëve. Të dhënat ekzistojnë ndara sepse sistemet e menaxhimit të të dhënave janë krijuar veçanta nga ministritë/ agjencitë përkatëse, si MFPT, MASHTI dhe tjera. Sfidat e rrjedhës së të dhënave (data flow) janë të pranishme në shumicën e ministrive/agjencive për shkak të ekzistencës së sistemeve të dyfishta të menaxhimit të të dhënave dhe kanaleve të shkëputura të ndarjes së të dhënave nëpër ministri dhe sektorë. Si rezultat, aftësia e shërbimeve sociale dhe familjare për të ofruar shërbime të integruara dhe të koordinuara për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në nevojë për mbrojtje është e kufizuar në mënyrë të konsiderueshme.

Përpjekja për të digjitalizuar sistemet e menaxhimit të të dhënave është një proces i ngadaltë dhe sfidues, siç dëshmohet nga përpjekjet për të zhvilluar Sistemin e Integruar të Mirëqenies Sociale (SIMS), Platformën e Integruar për Shërbimet Sociale (PIShS) dhe Sistemin për Menaxhimin e Informatave të Lëndëve (SMIL). Kjo ndërlikohet edhe më tej kur ata që janë përgjegjës për futjen e të dhënave kanë probleme të kyçjes në internet me sistemet e kompjuterizuara të menaxhimit të të dhënave. Kjo situatë ishte e dukshme në shkollat që kishin nevojë të futnin të dhënat e nxënësve në Sistemin për Menaxhimin e Informatave në Arsim, por hasën në probleme me kyçjen në internet.

Përpilimi dhe validimi i të dhënave janë gjithashtu sfiduese në ministri/agjenci, pjesërisht, sepse stafit i mungojnë aftësitë e analizës së të dhënave dhe ekspertiza në sistemet e menaxhimit të të dhënave administrative. Pavarësisht këtij rishikimi, ishte ende e paqartë se si dhe nëse të dhënat administrative validohen nga ministritë/agjencitë që mbledhin të dhëna të tilla. Ministrive/agjencive u mungon edhe aftësia për të monitoruar dhe vlerësuar sistemet e tyre administrative të menaxhimit të të dhënave, duke përfshirë vlerësimin nëse të dhënat në sisteme të tilla janë relevante, të sakta dhe në kohë.

Me pak staf të aftë në dispozicion për të analizuar të dhënat për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve, është sfiduese të përdoret ky informacion në mënyra që janë kuptimplote për politika dhe vendimmarrje. Gjithashtu, është e paqartë se si ministritë ose ofruesit e shërbimeve përdorin të dhënat e administratës për të gjurmuar modelet dhe trendet për fëmijët me aftësi të kufizuara ose mbrojtjen e fëmijëve për planifikim ose vendimmarrje, formulim të politikave, zhvillim të programeve dhe të ndërhyrjeve; dhe/ose buxhetimin dhe alokimin e burimeve.

Gjatë dekadës së fundit, ka pasur investime të konsiderueshme nga donatorët dhe ministritë e Kosovës për digjitalizimin dhe forcimin e sistemeve administrative të të dhënave, megjithatë, kalimi nga sistemet e të dhënave të bazuara në letër në sistemet digjitale të menaxhimit të të dhënave është i ngadalshëm. Ekziston një potencial i madh për të përmirësuar të dhënat administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve, dhe rekomandimet e përshkruara në këtë rishikim do të ndihmojnë në forcimin e përkushtimit të institucioneve të Kosovës për ta bërë këtë.

# HYRJE

## Arsyetimi dhe sfondi

Përderisa ka pasur progres të konsiderueshme në Kosovë në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve, situata e përgjithshme nuk ka qenë uniforme. Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm bën thirrje për investim në të gjithë fëmijët dhe të rinjtë me qëllimin që "të mos lëmë askënd prapa". Investimi në të gjithë fëmijët dhe të rinjtë është thelbësor për përkushtimin e Kosovës për të bërë përparim drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ). Megjithatë, zbatimi i Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe dokumentimi i progresit drejt OZhQ-ve varet, në një pjesë të madhe, nga mbledhja e të dhënave të cilësisë së lartë, të besueshme dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht.

Në Kosovë, kapacitetet institucionale për të gjeneruar të dhëna të besueshme që janë ndërkombëtarisht të krahasueshme dhe që mund të përdoren për të monitoruar progresin drejt OZhQ-ve dhe për të informuar vendimmarrjen dhe formulimin e politikave mbetet një sfidë e madhe. Është thelbësore që Kosova të ketë kapacitetet institucionale për të gjeneruar të dhëna të besueshme që janë të krahasueshme me rajonin dhe që mund të përdoren për të raportuar mbi treguesit që janë pjesë e Bazës së të dhënave të Monitorimit Transformativ dhe Barazisë të Avansuar (TransMonEE). TransMonEE kap një gamë të gjerë të dhënash për tregues që lidhen me çështje sociale dhe ekonomike që lidhen me situatën dhe mirëqenien e fëmijëve, të rinjve dhe grave.

Ky rishikim i sistemeve të të dhënave administrative synon të adresojë rekomandimet ose udhëzimet e ofruara nga Bashkimi Evropian (BE) në Kosovë lidhur me fuqizimin e të dhënave administrative, veçanërisht të dhënave në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve. Kjo punë është pjesë e një projekti më të gjerë që ka UNICEF-i në Kosovë me BE-në Kosovë për të mbështetur fëmijët nga komunitetet e margjinalizuara.

Në përgjithësi, numri i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë nuk dihet. Krahas kësaj mungese të të dhënave thelbësore, mbledhja e të dhënave vështirësohet për shkak të mungesës së protokoleve adekuate, qasjeve të integruara dhe mekanizmave të koordinimit institucional për mbledhjen dhe harmonizimin e të dhënave dhe sistemeve administrative. Si rezultat, këto boshllëqe të dhënash për situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe çështjet të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve krijojnë sfida domethënëse për institucionet dhe partnerët zhvillimor të Kosovës.

Në përputhje me Programin e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) në Kosovë për vitet 2021-2025, UNICEF synon të mbështesë institucionet e Kosovës për të fuqizuar cilësinë dhe besueshmërinë e të dhënave. Përmirësimi i sistemeve administrative të mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë aftësinë për të gjeneruar dëshmi të bazuara në të dhëna që mund të përdoren për të informuar formulimin e politikave dhe programeve për fëmijët në Kosovë, është kyç. Për të arritur këtë prioritet, UNICEF-i po mbështet institucionet e Kosovës për të kryer një vlerësim fillestar të sistemeve ekzistuese të të dhënave administrative dhe për të identifikuar mundësitë për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave, analizën dhe mekanizmat e raportimit në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve.

## Të kuptuarit e të dhënave administrative

Fokusi i këtij rishikimi është në të dhënat administrative. Gjatë dekadës së fundit, shumë Shtete Anëtare të Kombeve të Bashkuara (OKB) kanë nisur një proces të rëndësishëm të vlerësimit më të mirë dhe forcimit të të dhënave administrative të lidhura me shërbimet për fëmijët, duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve. Megjithëatë, në shumë vende, të dhëna të tilla nuk mblidhen, përpilohen dhe analizohen rregullisht apo sistematikisht. Për këtë arsye është rritur interesimi në nivel ndërkombëtar, veçanërisht midis partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit, për të eksploruar mënyra për të përdorur më mirë të dhënat ekzistuese

administrative për të monitoruar dhe raportuar mbi situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe mbrojtjen e fëmijëve. Të dhënat administrative janë një burim i rëndësishëm informacioni në të cilin shpesh (por jo gjithmonë) janë  lehtësisht të qasshme dhe mund të përdoren për të plotësuar anketat e shkallës së gjerë, të tilla si anketat e ekonomive familjar dhe anketat e zhvilluara  në shkolla, që masin prevalencën e personave me aftësi të kufizuara, cenueshmërinë e fëmijëve dhe fëmijët në nevojë për mbrojtje, si dhe shkaqet dhe pasojat e cenueshmërisë së fëmijëve. Të dhënat administrative mund të përdoren gjithashtu për të matur numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të fëmijëve që i qasen sistemit për mbrojtjes së fëmijëve dhe të raportojnë mbi progresin e bërë drejt objektivave dhe treguesve të OZhQ-ve lidhur me fëmijët.

Në shumë, por jo në të gjitha vendet, të dhënat administrative mblidhen dhe përpilohen rregullisht në nivel kombëtar dhe lokal. Një avantazh i mundshëm i të dhënave administrative është se ato mund të kapin të dhëna  të ekonomive familjare dhe të tjera, si dhe të dhëna dhe informacione në lidhje me popullatat (grupet) e vështira për t'u arritur, të cilat mund të mos jenë të arritshme nëpërmjet metodave tradicionale të anketimit (p.sh. familjet dhe fëmijët e cenueshëm, dhe popullatat minoritare dhe popullatat e zhvendosura). Megjithatë, kjo është e mundshme, vetëm deri në masën kur fëmijët dhe familjet nga këto grupe mund të kenë qasje në shërbime.

Institucionet qeveritare (p.sh. arsimi, shëndetësia, mbrojtja sociale, mbrojtja e fëmijëve, policia dhe gjyqësori), ofruesit e shërbimeve joqeveritare dhe institucionet private të arsimit dhe shëndetësisë kanë një mori informacionesh për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe disponueshmërinë  e shërbimeve të mbrojtjes dhe mbështetjes. Ato gjithashtu kanë njohuri për llojin e mbështetjes dhe shërbimeve që ofrojnë këto institucione  (p.sh. kujdes mjekësor, mbështetje/këshillim psikosocial, strehim, arsim, qasje në drejtësi dhe më shumë) (shih Diagramin 1).

Sfida, megjithatë, qëndron aty se institucionet qeveritare, ofruesit e shërbimeve joqeveritare dhe subjektet private shpesh nuk kanë sisteme të integruara të mbajtjes së të dhënave për të mbledhur rregullisht këto të dhëna, veçanërisht pasi ato kanë të bëjnë me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve. Nëse ekzistojnë sistemet e mbajtjes së të dhënave, ato zakonisht u përmbahen kërkesave ose nevojave të brendshme. Edhe kur mblidhen të dhëna administrative të bazuara në shërbime që lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve, të dhënat rrallë analizohen ose përdoren për monitorimin e efikasitetit të shërbimeve, programeve dhe/ose politikave që ekzistojnë për të mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara dhe/ose fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje ose për të përmirësuar qasjen në shërbimet thelbësore për të zvogëluar cenueshmëritë. Përveç kësaj, të dhënat administrative përdoren rrallë për të vlerësuar nëse ka pasur përmirësime në sistemet e mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë menaxhimin e rasteve për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në shumë vende, shpesh është gjithashtu e vështirë të gjurmohen rastet dhe referimet fëmijëve në sistemet e mirëqenies sociale, mbrojtjes së fëmijëve, arsimit, kujdesit shëndetësor, policisë dhe drejtësisë.

**Diagrami 1. Sektorët me burime të të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjën e fëmijëve**



Ndërsa ministritë, institucionet dhe ofruesit e shërbimeve mbledhin disa nga këto të dhëna automatikisht, të dhënat administrative zakonisht nuk janë përfaqësuese, pasi një numër i madh i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje mbesin të paidentifikuar. Në shumë raste, identifikohen dhe regjistrohen vetëm rastet më të rënda të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Përveç kësaj, në varësi të rregulloreve të qeverisë, nëse monitorimi i zhvillimit në fëmijërinë e hershme nuk ekziston, fëmijët me aftësi të kufizuara nuk mund të kategorizohen zyrtarisht si me aftësi të kufizuara dhe niveli i paaftësisë mund të mos vlerësohet deri në moshën e adoleshencës. Kështu, asnjë kalkulim i të dhënave administrative nuk do të japë një kuptim të plotë të prevalencës së fëmijëve me aftësi të kufizuara ose fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Megjithëse të dhënat administrative nuk nxjerrin prevalencën aktuale të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje, ato mund të nxjerrin numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje të identifikuar dhe raportuar tek autoritetet dhe ofruesit e shërbimeve. Të dhënat administrative mund të nxjerrin çështje të rëndësishme të hyrjes, ndërhyrjeve dhe qasjes në shërbimet e mbrojtjes dhe mbështetjes brenda një periudhe të caktuar dhe në të gjitha komunitetet, komunat dhe regjionet. Të dhënat administrative mund të përdoren gjithashtu për të eksploruar modelet dhe trendet historike që lidhen me identifikimin dhe raportimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje dhe reagimet ndaj këtyre fëmijëve. Në një nivel praktik, të dhënat administrative mund të përdoren për të informuar planifikimin e përgjithshëm të programit, ofrimin e shërbimeve dhe shpërndarjen e burimeve, pasi të dhënat mund të demonstrojnë shfrytëzimin e shërbimeve dhe sistemeve (p.sh. mbrojtja sociale, mbrojtja e fëmijëve, shëndetësia, arsimi, policia dhe sistemet e drejtësisë, dhe shërbimet me bazë në komunitet).

Në shumicën e institucioneve, të dhënat administrative mblidhen dhe përdoren për qëllime të brendshme, por jo domosdoshmërisht përpilohen, raportohen apo monitorohen. Nëse të dhënat administrative përdoren për qëllime të monitorimit dhe vlerësimit ose për qëllime të jashtme, është e rëndësishme të mbani mend se ky lloj sistemi i mbajtjes së shënimeve vjen nga një mostër jo përfaqësuese dhe të dhënat nuk mund të përgjithësohen lehtësisht për popullatën e përgjithshme. Rëndësia dhe dobia e të dhënave institucionale dhe të dhënave administrative varen nga cilësia e sistemit të regjistrimit dhe mbajtjes së të dhënave dhe shkalla në të cilën regjistrat dhe të dhënat mund të përdoren për t'iu përgjigjur pyetjeve, të tilla si: Sa fëmijë përdorin institucionet ofruese dhe shërbimet e tyre? Çfarë lloj ndihme kërkojnë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe/ose fëmijët në nevojë për mbrojtje? Çfarë lloj ndihme ofrojnë institucionet për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe/ose fëmijët në nevojë për mbrojtje? Të dhënat administrative mund të jenë gjithashtu të dobishme kur vlerësohet cilësia e shërbimeve dhe kur vlerësohen kostot e shërbimeve.

Pavarësisht avantazheve të të dhënave administrative, këto të dhëna kanë disa kufizime dhe sfida. Një sfidë është se shpesh ka mospërputhje në metodat e mbledhjes së të dhënave (p.sh. mospërputhje në mënyrën se si regjistrohen të dhënat administrative në nivel komunal, rajonal dhe kombëtar, dhe mospërputhje në saktësinë, plotësinë dhe mbulimin e të dhënave administrative). Në shumë vende, mund të ketë nivele të larta të të dhënave që mungojnë ose janë të mangëta, procese jokonsistente ose të kufizuara të sigurimit të cilësisë së të dhënave dhe mospërputhje në mënyrën se si grumbullohen dhe raportohen të dhënat nga nivelet komunale, rajonale dhe kombëtare. Kjo sepse mbledhja e të dhënave nuk është përgjegjësi kryesore e ministrive dhe institucioneve që ofrojnë shërbime; prandaj, cilësia e të dhënave është shpesh e dobët dhe jokonsistente.

Në vendet me sisteme të menaxhimit të të dhënave administrative të zhvilluara dhe funksionale, të dhënat administrative mund të jenë burim i mirë i të dhënave. Kjo shpesh vlen në disa, por jo në të gjitha vendet me të ardhura të mesme-të larta dhe të larta. Duke punuar në mënyrë më sistematike me të dhënat administrative, kufizimet që janë specifike për çdo vend mund të identifikohen dhe adresohen. Ky informacion më pas mund të përdoret për të informuar përpjekjet për të fuqizuar të dhënat dhe sistemet administrative, duke përfshirë praktikat e mbledhjes së të dhënave administrative, sistemimit dhe analizës, dhe për të informuar përpjekjet për të zhvilluar programe, mekanizma referimi dhe sisteme të menaxhimit të rasteve për të përmirësuar qasjen dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

# METODOLOGJIA

## Qëllimi dhe fushëveprimi

Qëllimi i kësaj pune ishte rishikimi i sistemeve të të dhënave administrative që mbledhin të dhëna mbi fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështje të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve. Fokusi kryesor ishte në sistemet administrative të të dhënave të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) dhe sektorëve të tjerë përkatës, duke përfshirë të dhënat e shpërndara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Rishikimi hulumtoi se ku ekzistojnë mundësitë për të fuqizuar mbledhjen e të dhënave, për të lidhur dhe harmonizuar sistemet e të dhënave administrative dhe për të përmirsuar raportimin për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe treguesit e lidhur me mbrojtjen e fëmijëve. Gjetjet nga ky rishikim çuan në rekomandime të bazuara në prova që synojnë të informojnë hapat e ardhshëm dhe ndërhyrjet vijuese.

## Objektivat

Objektivat kryesore të rishikimit ishin:

- Rishikimi i literaturës për të dhënave dhe informacioneve në dispozicion për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, me fokus në sistemet administrative të të dhënave.
- Dizajnimi i një metodologjie për identifikimin dhe vlerësimin e të dhënave ekzistuese administrative dhe sistemeve të të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve, me fokus në sistemet e të dhënave administrative të menaxhuara nga MFPT, MSH dhe MASHTI, dhe sektorë të tjerë përkatës, duke përfshirë të dhënat e raportuara dhe të shpërndara nga ASK-ja.
- Identifikimi i boshllëqeve të të dhënave dhe mundësitë për të fuqizuar të dhënat administrative dhe sistemet e të dhënave për të përmirësuar mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe treguesit e lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.
- Takimi me palët e interesit nga ministritë dhe institucionet përkatëse përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave përkatëse administrative dhe menaxhimin e sistemeve ekzistuese të të dhënave administrative. Për të kuptuar më shumë rreth mbledhjes, përpilimit dhe analizës së të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve, si dhe mënyrën se si përdoren këto të dhëna administrative.
- Krijimi i një raporti narrativ që nxjerr në pah gjetjet nga rishikimi dhe zhvillimi i rekomandimeve të bazuara në prova për ndërhyrje afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Përmirësimi i mbledhjes, analizës dhe raportimit të të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve, në përputhje me standardet dhe metodologjitë rajonale dhe ndërkombëtare.

## Qasja e rishikimit

Për t'u siguruar që rishikimi të ishte sa më i plotë që të ishte e mundur, u përdorën metoda dhe procese të ndryshme analitike të mbledhjes së të dhënave: shqyrtimi i literaturës, përdorimi i instrumenteve të rishikimit dhe pyetësorëve, dhe intervista me palët përkatëse të interesit. Secila prej këtyre metodave të mbledhjes së të dhënave përshkruhet më në detaje më poshtë.

### *Shqyrtimi i literaturës (dokumenteve)*

Shqyrtimi i dokumenteve përkatëse u krye për të vlerësuar gjendjen aktuale të të dhënave administrative mbi fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë. Shqyrtimi i

dokumenteve u fokusua në dokumentet e politikave të Kosovës dhe raportet kombëtare që ishin relevante për treguesit kombëtarë, rajonalë dhe globalë të lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve. Të gjeturat nga raportet e mëparshme, vlerësimet dhe të dhënave dhe statistikave për fëmijët në Kosovë, së bashku me materialet e tjera relevante të ofruara nga UNICEF dhe të disponueshme nga institucionet e Kosovës, janë përfshirë gjithashtu.

Rishikimi i literaturës ka përfshirë analizën dhe sintezën e:

- Dokumenteve të politikave kombëtare që ndërlidhen me koordinimin e statistikave dhe rregulloret për prodhimin e statistikave për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve.
- Funksionimi i sistemit kombëtar statistikor.
- Strategjitë kombëtare ekzistuese për zhvillimin e statistikave për fëmijët.
- Planet dhe raportet kombëtare të zhvillimit që lidhen me zotimet ndërkombëtare, si Konventa për të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Ky shqyrtim i dokumenteve u fokusua edhe në burime të tjera që ofronin të dhëna statistikore për fëmijët në Kosovë, duke përfshirë të dhënat e TransMonEE për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë.

Sfida kryesore e shqyrtimit të të dhënave administrative është se mungon informacioni bazë dhe kontekstual rreth të dhënave administrative dhe sistemeve të menaxhimit të të dhënave. Shumica e dokumenteve të shqyrtuara nuk trajtojnë burimet e të dhënave administrative ose pikat e forta dhe kufizimet e sistemeve të tilla; në shumicën e rasteve, ky informacion mund të merret vetëm përmes konsultimeve dhe intervistave.

### *Instrumenti për raportimin e treguesve*

Një instrument për raportim të treguesve u zhvillua në Excel dhe u përdor për të gjurmuar disponueshmërinë ose mungesën e të dhënave për secilin prej treguesve përkatës kombëtar, rajonal dhe global në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve (shih Aneksin A). Kjo përfshinte 71 tregues që lidhen me fëmijët:

- 2 tregues për fëmijët pa kujdes prindëror
- 2 tregues për fëmijët në përkujdesje alternative
- 10 tregues për fëmijët në kujdesin rezidencial
- 22 tregues për fëmijët në kujdesin e bazuar në familje
- 4 tregues për adoptimin e fëmijëve
- 8 tregues për dhunën ndaj fëmijëve dhe shfrytëzimin e fëmijëve (çështje të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve)
- 2 tregues për qasjen në drejtësi (çështje të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve)
- 7 tregues për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen sociale
- 11 tregues për fëmijët me aftësi të kufizuara
- 3 tregues për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe arsimin

Janë marrë hapa për të përcaktuar burimin parësor të të dhënave, zbërthimin e të dhënave (p.sh. gjinia, mosha) dhe nëse secili tregues është raportuar rregullisht. UNICEF-i gjithashtu u përpoq të përcaktojë numëruesin dhe emëruesin për secilin prej treguesve, të propozojë mënyrën e llogaritjes për secilin prej treguesve dhe të identifikojë institucionet përgjegjëse për llogaritjen e secilit prej treguesve. Regjistrimi i fundit i bërë në Kosovë ishte në vitin 2011, kështu që të dhënat aktuale kanë kufizime të mëdha. Aty ku ishte e mundur, treguesit e llogaritur për raportimin TransMonEE janë përfshirë në listën e treguesve (shih Aneksin A).

Saipas Shtojcës A, vetëm 5 nga 71 treguesit e lartpërmendur raportohen rregullisht nga institucionet e Kosovës. Këtu përfshihet një tregues për fëmijët pa kujdes prindëror, një tregues për fëmijët në kujdes alternativ, një për adoptimin e fëmijëve, një tregues për fëmijët me aftësi të kufizuara

dhe mbrojtjen sociale dhe një tregues për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe arsimin. Konsulenti kombëtar i UNICEF-it i cili kishte punuar me institucionet e Kosovës për të përmirësuar raportimin e treguesve për fëmijët, në kohën e këtij vlerësimi, deklaroi se treguesit nuk raportoheshin rregullisht sepse 1) të dhënat bazë të kërkuara për llogaritjen e treguesve ose nuk ekzistojnë ose ekzistojnë vetëm pjesërisht dhe 2) nuk ka përllogaritje të paraqitura si përqindje e popullsisë së përgjithshme, veçanërisht të fëmijëve të moshës 0-17 vjeç. Së fundi, treguesit nuk raportohen rregullisht edhe pse Kosova posedon korniza kombëtare të treguesve për mbrojtjen e fëmijëve,[1] drejtësinë për fëmijët, [2] arsimin[3] dhe shëndetësinë.[4]

### *Instrumenti për rishikimin e të dhënave administrative*

*Instrument për rishikimin e të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve* është zhvilluar posaçërisht për të përmbushur nevojat e këtij rishikimi. *Instrumenti* u modelua duke u bazuar në instrumente të tjera të sistemit të të dhënave administrative të zhvilluara nga autori për UNICEF-in për të vlerësuar sistemet e të dhënave administrative që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve dhe dhunën ndaj fëmijëve.[5] *Instrumenti* mundësoi vlerësimin e treguesve kombëtar, rajonal dhe global për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve, dhe sistemet kombëtare të të dhënave administrative që ekzistojnë në të gjithë sektorët (p.sh., sektorët e arsimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, mbrojtjes së fëmijëve, policisë dhe drejtësisë) dhe ministritë/institucionet përkatëse.

*Instrumenti* grumbulloi informata në lidhje me kornizën kombëtare ligjore dhe të politikave për mbledhjen e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve si dhe treguesve të tjerë përkatës. *Instrumenti* gjithashtu përmban informata në lidhje me treguesit; shënimin/regjistrimin e obligueshëm; udhëzimet/protokollet kombëtare dhe formularët standard; sistemet e menaxhimit të të dhënave; ndarjen e të dhënave; dhe analizën, shpërndarjën dhe përdorimin e të dhënave.

*Instrumenti* u përdor gjatë konsultimeve me akterët kryesor nga secila prej ministrive/institucioneve që janë përgjegjëse për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje, si dhe me institucionet që ofrojnë shërbime esenciale për këta fëmijë. *Instrumenti* gjithashtu mundësoi mbledhjen sistematike të informacionit dhe të dhënave nga një pjesë e të anketuarve nga ministritë/institucionet dhe sektorët përkatës.

### *Intervistat me palët relevante të interesit*

Konsultimet janë kryer me palët kyçe të interesit nga institucionet e Kosovës përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve (shih Kornizën 1). Duke pasur parasysh se asnjë burim i vetëm i të dhënave administrative nuk pasqyron në mënyrë adekuate situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje në Kosovë, intervistat multisektoriale lejuan një pasqyrim të shumanshëm të situatës të të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë.

Intervistat u zhvilluan me një mostër jo të rastësishme të akterëve kryesorë që kanë njohuri dhe informacion në lidhje me sistemin e të dhënave 'administrative' të institucioneve/organizatave të tyre, duke përfshirë të dhënat dhe udhëzimet e përdorura nga ministritë përkatëse; rrjedhën e të dhënave (dataflow) dhe vlerësimet (feedback) (d.m.th. si mblidhen të dhënat në nivel komunal dhe si grumbullohen në nivel kombëtar); praktikat e sigurimit të cilësisë (d.m.th. si verifikohen të dhënat admin-

1 Korniza Kosovare e Treguesve për Mbrojtjen e Fëmijëve, 2020.
2 Korniza e Treguesve të Drejtësisë për Fëmijë në Kosovë, 2013.
3 Korniza e Treguesve të Arsimit të Kosovës, 2017.
4 Korniza e Treguesve Shëndetësor të Kosovës, 2018.
5 Haarr, RN (2020). *Paketa e veglave diagnostikuese dhe pikëzuese për të dhënat administrative të VAC – Versioni 2. UNICEF Kazakistan; Haarr, RN (2020). Të dhënat administrative mbi dhunën ndaj grave dhe fëmijëve në kontekstin e zhvillimit; Haarr, RN (2019). Dokumenti Strategjik për Angazhimin mbi të Dhënat Administrative për Dhunën ndaj Fëmijëve. UNICEF; Haarr, RN (2018). Udhëzimet Rajonale të Shoqatës së Kombeve të Azisë Juglindore (ASEAN) për Dhunën kundër Grave dhe Vajzave Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave. Australian Aid & Zyra Rajonale e UN Women për Azinë dhe Paqësorin; Haarr, RN (2018). Një udhëzues praktik për forcimin e burimeve të të dhënave administrative mbi dhunën ndaj fëmijëve. UNICEF; Haarr, RN (2018) Mjeti i poentimit dhe vlerësimit të të Sistemit administrativ të të dhënave të VAC-ut multi-sektorial; Haarr, RN (2017). Rishikimi dhe vlerësimi i burimeve të të dhënave administrative për dhunën ndaj fëmijëve. UNICEF.*

istrative); dhe përdorimi dhe shpërndarja e të dhënave (d.m.th. si përdoren të dhënat administrative në secilin prej niveleve administrative dhe si shpërndahen për të marrë vendime të informuara për politikat dhe shpërndarjen e burimeve). Janë bënë gjithashtu përpjekje për të kuptuar modulet e menaxhimit të rasteve që janë në zhvillim e sipër në MFPT.

Instrumenti u përdorë për të udhëzuar gjithashtu intervistat me akterët kryesore të interesit nga secila prej ministrive. Shumica e intervistave janë kryer me akterët kryesore të interesit në institucionet e Kosovës në nivel kombëtar, por disa intervista janë kryer me palët kryesore të interesit në nivel komunal për të mësuar më shumë rreth sistemeve të menaxhimit të të dhënave në atë nivel të regjistrimit të dhënave. Gjithashtu është bërë një intervistë me drejtorin e një organizate joqeveritare (OJQ) që operon një strehimore për viktimat e dhunës në familje në Kosovë.

Mesatarisht, intervistat kanë zgjatur rreth një orë. Shumica e intervistave janë kryer si intervista në grupe të vogla me dy deri në gjashtë persona; megjithatë, disa intervista ishin individuale. Shënimet e hollësishme nga intervistat u ruajtën drejtpërdrejt në Word gjatë çdo interviste; intervistat nuk u regjistruan në audio.

**Korniza 1. Shembull i autoriteteve dhe sektorëve kombëtar dhe komunal**

**Niveli kombëtar**

- **Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve** (Shef i Departamentit për Politikat Sociale dhe Familjare (DPSF), Zyrtar Statistikor për DPSF, Shef i Teknologjisë së Informacionit, Konsulentë nga Banka Botërore)
- **Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit** (Shef i Divizionit për Arsimin Gjithëpërfshirës, Shef i Departamentit për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, Shef i Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve, Shef i Sistemit për Menaxhim të Informatave në Arsim)
- **Ministria e Shëndetësisë** (Shef i Sistemit për menaxhimin e informatave shëndetësore)
- **Ministria e Drejtësisë** (Shef i Departamentit për Integrime Evropiane, Shef i Shërbimit Sprovues, Shef i Shërbimit Korrektues, Kryesusesi i Sistemit për menaxhimin e informatave të dhunës në familje)
- **Zyra për Qeverisje të Mirë** (Zyrtari për Monitorimin e të Drejtave të Fëmijëve)
- **Policia e Kosovës** (Koordinator për të dhënave, Shef i Departamentit të Delikuencës së të Miturve, Drejtor për Hetimin e Trafikimit të Njerëzve)
- **Agjencia e Statistikave të Kosovës** (Drejtori i Departamentit për Statistikat Sociale)
- **Këshilli Gjyqësor** (Shef i Statistikave)
- **Këshilli Prokurorial** (Shef i Statistikave)

**Niveli komunal**

- **Drejtoria e Arsimit** (Shef i Financave)
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**
- **Drejtor i Qendrës për Punë Sociale**
- **Shefi i Shërbimeve Sociale**
- **Punonjës social nga Qendra për Punë Sociale**
- **Shkolla** (Drejtori, Psikologu dhe Logopedi)
- **Shkolla Speciale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara** (Shefi)
- **Strehimore për viktimat e dhunës në familje** (Drejtori)

# AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS (ASK)

## Të dhënat administrative

Në përputhje me Ligjin Nr. 04/1.-036 "Për Statistikat Zyrtare", është përcaktuar se Agjencia e Statistikave të Kosovës është institucion profesional, i pavarur, bartës dhe shpërndarës dhe koordinator i sistemit statistikor të Kosovës, që vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (neni 6). Ngjashëm me agjencitë e tjera kombëtare statistikore, ASK është e varur nga ministritë për të dhënat administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve, megjithatë, ministritë shpesh nuk dëshirojnë ose hezitojnë të ndajnë të dhëna të tilla administrative. Kjo mund të jetë pjesërisht për shkak se ministrive u mungojnë të dhënat e tilla ose ka mangësi në sistemin e të të dhënave administrative në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve që e bëjnë sfidë ndarjen e të dhënave të sakta dhe të besueshme. ASK-ja është përballur edhe me sfida në marrjen e të dhënave nga sistemi i Regjistrimit Civil dhe Statistikave Vitale (RCSV), duke përfshirë regjistrimet e lindjeve. Derisa RCSV argumenton se kjo është një çështje e privatësisë, ASK argumenton se ekzistojnë protokolle për privatësinë e të dhënave.

Gjithashtu u potencua se kur ASK kërkon të dhëna nga ministritë, ministritë shpesh nuk ofrojnë asgjë më shumë se të dhëna të përmbledhura (agreguara), gjë që e bën të pamundur për ASK-në të vlerësojë cilësinë e të dhënave ose të bëjë analiza të mëtejshme për të gjeneruar statistika të nevojshme. Një sfidë tjetër e identifikuar është se kur ASK kërkon të dhëna administrative nga ministritë (veçanërisht të dhënat relevante për fëmijët me aftësi të kufizuara, mbrojtja e fëmijëve dhe drejtësia për fëmijët) për të raportuar mbi treguesit TransMonEE, ASK nuk kërkon gjithmonë të dhëna të zbërthyera që janë të nevojshme për të raportuar mbi tregues të veçantë. Kjo ka bërë që ministritë të gjenerojnë gabimisht statistika në lidhje me disa tregues të fëmijëve. Pa qasje në të dhënat administrative të ministrive përkatëse, ASK-ja nuk është në gjendje të kryejë analizat e saj dhe të gjenerojë raporte gjithëpërfshirëse statistikore dhe tregues të nevojshëm për të informuar politikat kombëtare dhe raportimin ndërkombëtar.

## Të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe banesavea

Është e rëndësishme të theksohet se ASK është përgjegjëse për kryerjen e regjistrimit të popullsisë dhe banesave; megjithatë, ata janë përballur me sfida të shumta kur bëhet fjalë për kryerjen e një regjistrimi të përditësuar. Regjistrimi i fundit është kryer në Kosovë në vitin 2011. Si rezultat, ASK-ja ende përdor të dhënat e regjistrimit të vitit 2011 për të zhvilluar projeksione të popullsisë dhe të njëjtat projeksione të popullsisë i përdorë për të llogaritur treguesit.

Të dhënat e popullsisë janë kritike për të informuar proceset e planifikimit, për zhvillimin e politikave dhe për të raportuar mbi tregues të caktuar, duke përfshirë treguesit për fëmijët (shih Kornizën 2). Megjithatë, mungesa e të dhënave të përditësuara të një regjistrimi të popullsisë dhe banesave ka krijuar sfida për ASK-në dhe qeverinë duke përfshirë pamundësinë për të krahasuar të dhënat e përditësuara të regjistrimit me të dhënat e RCSV. Një krahasim i tillë do të mundësonte të dhëna më të sakta mbi popullsinë e Kosovës, demografinë, karakteristikave sociale dhe ekonomike dhe kushteve të banimit.

Në përgjithësi, ASK-ja ka një rol kyç për të luajtur në gjenerimin e informacionit statistikor i cili mund të shërbejë si bazë për ndërtimin e parashikimeve të planifikimit dhe informimin e ndërhyrjeve të synuara dhe llogaridhënies.

**Korniza 2. Pesë objektivat kryesore të të dhënave të regjistrimit të popullsisë dhe banesave**

- Numërimi i popullsisë dhe ekonomive familjare në vend.
- Mbledhja e informacionit demografik për llogaritjen e vlerësimeve të popullsisë dhe treguesve kombëtar, rajonal dhe global.
- Mbledhja e të dhënave dhe prodhimi i informacionit për institucionet qeveritare dhe autoritetet lokale për qëllime planifikimi dhe buxhetimi.
- Mbledhja e informacionit socio-ekonomik për një mostër të madhe njerëzish në popullatë, i cili mundëson marrjen e të dhënave dhe informacionit për grupe të vogla, unike të popullsisë.
- Prodhimi i informacionit që u shërben institucioneve qeveritare, organizatave dhe subjekteve të tjera publike dhe private në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, ekonomisë, biznesit, kërkimit shkencor etj.

# MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE (MFPT)[6]

## Kuadri Ligjor

Në përputhje me Ligjin Nr. 02/L-17 'Për Shërbimet Sociale dhe Familjare', në rrethanat kur nuk ka mbështetje familjare ose kur është e pamjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, Kosova ka për detyrë t'u ofrojë ndihmë atyre personave. Shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë ofrimin e kujdesit të drejtpërdrejtë social, këshillimin dhe në rrethana të jashtëzakonshme, mbështetjen materiale për përfitim të njerëzve në nevojë.

Në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-081 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin", Ligji Nr. 02/L-17 "Për Shërbimet Sociale dhe Familjare", përkufizon kujdesin e drejtpërdrejtë social si ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, në lidhje me punët e shtëpisë, kujdesin personal, lëvizshmërinë, komunikimin dhe mbikëqyrjen. Kujdesi mund të ofrohet në shtëpinë e personit, në shtëpinë e një familjeje tjetër, në një qendër të specializuar për qëndrim ditor ose në një institucion rezidencial. Mbështetja materiale përkufizohet si ofrimi i parave, strehimit të përkohshëm, ushqimit, tarifave mjekësore, veshjeve ose çdo materiali tjetër thelbësor emergjent për individët ose familjet që nuk kanë asnjë burim tjetër në dispozicion. MFPT /MD ka përgjegjësi të përgjithshme për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë.

Nën kujdesin e Qendrës për Punë Sociale (QPS), e cila funksionon në nivel komunal dhe përbën autoritetin e kujdestarisë, shërbimet sociale dhe familjare ofrohen në emër të MFPT-së, MD-së. Sipas nenit 8 të Ligjit nr. 02/l-17, personat juridik që nuk janë në sektorin qeveritar, duke përfshirë ndërmarrjet, organizatat dhe shoqatat vullnetare, organizatat bëmirëse, grupet vetëndihmuese dhe organizatat e tjera lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare inkurajohen gjithashtu të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, qoftë me iniciativën e tyre ose, sipas kontratës, në emër të drejtorisë komunale (për shërbimet lokale), ose departamentit (për shërbime në mbarë Kosovën). Gjithashtu, MFPT / MD lejohet të lidhë kontrata me OJQ-të për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në mbarë Kosovën. Për sa i përket fëmijëve, shërbime të tilla përfshijnë shërbimet për fëmijët dhe familjet (neni 9), mbrojtjen e fëmijëve (neni 10) dhe format alternative të kujdesit ndaj fëmijëve (neni 11).

Ligji Nr. 03/L-22 "Për mbështetjen materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme" rregullon të drejtën e mbështetjes materiale për familjet që mbrojnë dhe kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme dhe realizimin e kësaj mbështetjeje materiale. Fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme përkufizohen të gjithë fëmijët nga lindja deri në 18 vjeç me banim të përhershëm në Kosovë dhe që janë plotësisht të paaftë për të kryer aktivitetet e përditshme pa ndihmën e një personi tjetër. Aftësitë e kufizuara të përhershme përfshijnë format fizike, mendore dhe shqisore; fëmijë të verbër; dhe fëmijët të cilët, për shkak të natyrës së ndonjë sëmundjeje ose sëmundjeje të përhershme, nuk janë në gjendje të lëvizin në mënyrë të pavarur në shtëpi/apartament ose në vendet që kanë nevojë; nuk janë në gjendje të përdorin mjetet përkatëse ndihmëse; nuk janë në gjendje të ushqehen ose të veshin dhe të heqin rrobat; dhe nuk janë në gjendje të përmbushin nevojat fiziologjike dhe ta mbajnë higjienën e nevojshme personale (neni 6). Mbështetja materiale përkufizohet si një përfitim financiar, duke përfshirë një shumë mujore ose një formë tjetër pagese me para, që administrohet nga MFPT për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme. Në përputhje me nenin 3, MFPT siguron mbështetje materiale për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, në përputhje me kapacitetet buxhetore të Kosovës, përmes Departamentit të Mirëqenies Sociale (që nga viti 2023, Departamenti i Skemave Sociale). Mbështetja materiale për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme paguhet në emër të prindit ose prindit kujdestar (kujdestarit) të fëmijës nëpërmjet transfereve bankare.

6 Në vitin 2023, Qeveria e Kosovës miratoi vendimin me të cilin menaxhmenti i Departamentit për Shërbime Sociale nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ku ishte më parë, kaloi në Ministrinë e Drejtësisë. Ky ndryshim ka transferuar menaxhimin e shërbimeve sociale pranë Departamentit të Shërbimeve Sociale dhe Mbrojtjes së Fëmijëve në Ministrinë e Drejtësisë (MD). Megjithatë, duke qenë se vlerësimi është kryer në pjesën e dytë të vitit 2022, dhe raporti është finalizuar në vitin 2023, referenca MFPT – MD është përdorur për të shpjeguar këtë tranzicion.

## Të dhënat administrative

Për të monitoruar ofrimin e kujdesit të drejtpërdrejtë social (përfshirë shërbimet sociale dhe familjare) dhe për të siguruar transferimin e duhur të fondeve për ofrimin e mbështetjes materiale (përfshirë mbështetjen materiale për familjet në nevojë dhe familjet që mbrojnë dhe kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara), MFPT shfrytëzon tre sisteme të ndryshme të të dhënave administrative.

- **Baza e të dhënave të shërbimeve sociale (BDhShS)** regjistron të gjithë individët që përfitojnë shërbime ose ndihmë sociale, regjistron shërbimet që u ofrohen nëpërmjet QPS dhe përmban 60 kategori të dhënash historike. MFLT / MD ka kërkuar zhvillimin e një platforme për menaxhimin e rasteve posaçërisht për fëmijët.
- **Sistemi i Menaxhimit të Informatave për Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara (SMIFAK)** mbledh të dhëna për fëmijët (të moshës prej 0 -18 vjeç) me aftësi të kufizuara të përhershme dhe aftësia e kufizuar e të cilëve vërtetohet nga Komisioni Mjekësor, një grup ekspertësh mjekësor të caktuar nga ministria. Ai shërben gjithashtu për të identifikuar fëmijët që kanë nevojë për shërbime përtej pagesave të marra nga skema sociale e aftësisë së kufizuar.
- **Baza e të dhënave për strehim familjar** është një modul që mbledh të dhëna të nevojshme për të procesuar pagesat për fëmijët në sistemet e strehimit familjar dhe të strehimit tek farefisi.

Këto tre sisteme funksionojnë si sisteme të pavarura të menaxhimit të të dhënave, nuk janë të integruara dhe nuk janë të lidhura.

Për të plotësuar të dhënat administrative, çdo QPS kërkohet të regjistrojë informacionin në format e Excel-it që ata ia dërgojnë MFPT-së/MD-së. QPS dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve zakonisht mbështeten në dosjet e tyre të rasteve  që janë në letër për të plotësuar format e Excel-it. Megjithatë, shumë pak të dhëna të rasteve ndahen me MFPT/MD, dhe të dhënat që ndahen janë të përmbledhura (agreguara) gjë që kufizon mundësinë e MFPT/MD për të analizuar të dhënat administrative. Stafi i MFPT/MD pastaj transferon të dhënat nga format e Excel-it në sistemin e duhur të të dhënave administrative. QPS-ja dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve zakonisht  ofrojnë të dhëna tek MFPT/MD në baza javore, mujore, gjashtëmujore dhe vjetore.

Fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda (p.sh. paraplegjikë dhe të verbër) të cilët nuk trajtohen nga QPS-ja duhet të regjistrohen në Zyrën e Administratës Pensionale e Kosovës, e cila është një skemë tjetër pagese.

Të dy bazat e të dhënave SMIFAK dhe strehimit familjar i mundësojnë MFPT / MD të procesojnë transferet mujore për fëmijët e regjistruar në këto sisteme. Këto dy sisteme të menaxhimit të të dhënave mund të përdoren për të raportuar mbi numrin total të përfituesve (të ndarë sipas gjinisë) dhe shumën totale të fondeve të paguara. Mirëpo, këto dy sisteme të dhënash nuk mund të përdoren për të gjeneruar ose nxjerrë të dhëna për të raportuar mbi tregues të tjerë thelbësorë (p.sh. numri i fëmijëve të ndarë sipas gjinisë dhe moshës, numri i rasteve të reja të regjistruara brenda vitit dhe të ndara sipas gjinisë dhe moshës). Përveç kësaj, SMIFAK nuk gjeneron të dhëna në lidhje me llojin e aftësisë të kufizuar.

Sistemet administrative të menaxhimit të të dhënave të MFPT/MD-së mund të gjenerojnë numrin total  të ndara sipas gjinisë, grupmoshave të paracaktuara, përkatësisë etnike dhe komunës. Llogaritja e proporcioneve  dhe përqindjeve dhe gjenerimi i treguesve aktualisht kryhet manualisht, gjë që është shumë joefikase dhe mund të çojë në një margjinë të lartë gabimi. Këto sisteme prodhojnë të dhëna të mangëta, të pasakta dhe të vjetruara. Si rezultat i kësaj, ky sistem administrativ nuk mund të përdoret për të gjeneruar statistika të sakta ose në kohë reale të nevojshme për të raportuar mbi treguesit kombëtar, rajonal dhe global, duke përfshirë ato që lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara, mbrojtjen e fëmijëve dhe ofrimin e shërbimeve e sociale dhe familjare dhe të mbështetjes materiale sipas skemave përkatëse. Kjo mungesë e të dhënave të sakta dhe në kohë reale për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve paraqet një sfidë domethënëse për MFPT/MD.

Në përgjithësi, MFPT mund të gjurmojë mbështetjen financiare ose materiale që u ofrohet familjeve

dhe fëmijëve në nevojë dhe familjeve që mbrojnë dhe kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara. Megjithatë, MFPT/MD e ka më të vështirë gjurmimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, duke përfshirë llojet e ndryshme dhe cilësinë e shërbimeve që u ofrohen fëmijëve dhe familjeve të tyre. MFLT/MD nuk është gjithashtu në gjendje të gjurmojë sistematikisht shërbimet e ofruara nga OJQ-të si shërbimet sociale dhe familjare dhe kujdesin alternativ për fëmijët (p.sh. kujdesi ditor, kujdesi rezidencial dhe strehimin familjar). Kjo pasi nuk mblidhen të dhëna për numrin e fëmijëve që hyjnë dhe dalin nga këto shërbime gjatë gjithë vitit dhe as për llojet e shërbimeve që ofrohen në këto sisteme alternative të kujdesit. Në Kosovë, QPS-ja përcakton nëse një fëmijë hyn në strehimin në familje/farefis, ndërsa QPS dhe një panel ekspertësh përcaktojnë nëse një fëmijë hyn në strehim familjar apo rezidencial. MFPT/MD ka nevojë për këto të dhëna për të gjeneruar statistika; për të raportuar për treguesit përkatës; për të informuar planifikimin dhe politikëbërjen; për të siguruar një buxhet vjetor të balancuar për administratën publike; dhe për krijimin e buxheteve shumëvjeçare dhe investimeve publike afatgjata për të ofruar shërbime sociale dhe familjare dhe mbështetje materiale për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet në nevojë.

Me mbështetjen e Bankës Botërore dhe donatorëve të tjerë, MFPT është në procesin e zhvillimit të dy sistemeve të reja të menaxhimit të të dhënave për menaxhimin e shërbimeve dhe pagesave për mbështetje materiale (ekzistojnë më shumë se 25 skema të ndryshme për mbështetjen materiale për të cilat MFPT është përgjegjëse). Për këto dy sisteme të reja - **Sistemi i Integruar i Mirëqenies Sociale** në MFPT dhe **Platforma e Integruar për Shërbime Sociale** në MD– parashikohet të duhen të paktën tre vjet për t'u zhvilluar dhe do të integrojnë skemat sociale, shërbimet sociale dhe platformën e menaxhimit të rasteve për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke zëvendësuar sistemet e menaxhimit të lartpërmendura Baza e të Dhënave të Shërbimeve Sociale, **Baza e të Dhënave të SIMFAK dhe Strehimit Familjar.**

- Sistemi i Integruar i Mirëqenies Sociale (SIMS) është një platformë e integruar që proceson pagesat për mbështetje materiale, sipas 25 skemave të ndryshme sociale për të cilat është përgjegjëse MFPT dhe transferon para për shërbimet e ofruara. SIMS duhet të ndihmojë në eliminimin e pagesave të dyfishta të cilat kanë qenë problematike në të kaluarën. Veçanërisht, SIMS nuk kap të dhëna në lidhje me transfertat e parave për shërbimet e ofruara për fëmijët e moshës 0-17 vjeç, të rriturve 18 vjeç dhe më të vjetër dhe shërbimet e ofruara për fëmijët me aftësi të kufizuara ose kategori specifike të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (p.sh. fëmijë viktima të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit). Zbërthimi i të dhënave të SIMS sipas moshës së fëmijës nëpër vite (në vend të datës së lindjes dhe vitit) do të mundësojë analizinë e shpenzimet financiare që lidhen me shërbimet dhe mbështetjen materiale (p.sh. skemat e pagesave për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe transferet e parave për lloje të tjera të mbështetjes materiale) për fëmijët e moshës 0-17 vjeç. Kjo mund të çojë në një rishikim të shpenzimeve të sektorit social për fëmijët, me fokus të veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në nevojë për mbrojtje.
- Platforma e Integruar për Shërbime Sociale (PIShS) është parashikuar si një sistem i menaxhimit të rasteve. Mirëpo, në kohën e këtij rishikimi, nuk është e qartë nëse PIShS do të funksionojë si një sistem i vërtetë i menaxhimit të rasteve që mund të përdoret nga punonjësit social në QPS dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve për të automatizuar të gjithë rrjedhën e tyre të punës (p.sh. regjistrimi i klientëve, qasja dhe regjistrimi i nevojave të tyre, shërbimet e planifikimit dhe monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve të ofruara). Pasi që MFPT/MD ka qasje të fragmentuar për zhvillimin e moduleve të veçanta për punën e fëmijëve, adoptimin, strehimin familjar, kujdestarinë, strehimin rezidenciale dhe licencimin e punonjësve social, nuk është e qartë se si do të integrohen ose lidhen të dhënat në secilin prej moduleve. Zhvillimi dhe vazhdimi i të cilave varet nga vendimi i MD.

Do të duhet ende kohë para se të lansohen SIMS dhe PIShS. Në atë pikë, MFPT / MD do ti duhet kohë për të monitoruar dhe vlerësuar funksionalitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e këtyre dy sistemeve të reja të menaxhimit të të dhënave.

# MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT (MASHTI)

## Të dhënat administrative

### *Sistemi për menaxhimin e informatave të Arsimit (SMIA)*

Globalisht, shtetet në nivel kombëtar kanë zhvilluar **Sistemet për Menaxhimit e Informative të Arsimit (SMIA)** për të mbledhur, integruar, përpunuar, ruajtur dhe shpërndarë të dhëna dhe informacione për të mbështetur vendimmarrjen, analizën dhe formulimin e politikave, planifikimit, monitorimit dhe menaxhimit në të gjitha nivelet e sistemit arsimor. Miratimi i OZhQ 4, për të siguruar arsim cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe për të promovuar mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë, kërkon dhëna më komplekse. Për më tepër, theksi mbi barazinë dhe përfshirjen, të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe nevoja për të matur rezultatet e të nxënit kanë zgjeruar gamën e të dhënave që duhen mbledhur dhe menaxhuar.

Në Kosovë, MASHTI menaxhon SMIA-n i cili ka të dhëna dhe informacione për fëmijët që janë të regjistruar në sistemin e shkollave publike (p.sh. parashkollore, shkolla fillore dhe shkolla të mesme të ulëta dhe të larta). Të dhënat si emrat, numrat e identifikimit dhe informacionet nga shkollat në komunitetet serbe nuk janë mbledhur në SMIA. Të dhënat të nivelit nxënësit/individual mblidhen nëpërmjet regjistrave të klasave në letër duke përdorur një numër unik nxënësit, i cili është i ndarë nga SMIA. Çdo mësimdhënës është përgjegjës për plotësimin e regjistrave të klasës dhe dorëzimin e tyre tek drejtori i shkollës. Në SMIA, të dhënat bazë (pa emra apo numra identifikues) mblidhen për çdo nxënës duke përfshirë gjininë, moshën, përkatësinë etnike, prindërit, vendbanimin, distancën nga shtëpia në shkollë dhe aftësitë e kufizuara. Të dhënat e përgjithshme për numrin e fëmijëve që përsërisin klasat gjithashtu regjistrohen çdo vit në SMIA. Pavarësisht nga avantazhet e shumta të SMIA, ka disa kufizime kryesore, duke përfshirë pamundësinë për të identifikuar nxënësit dhe për të monitoruar performancën akademike me kalimin e kohës. Kjo do të thotë se SMIA nuk mund të përdoret si një sistem paralajmërimi i hershëm për nxënësit që rrezikojnë të përsërisin klasën ose të braktisin shkollën. Gjithashtu SMIA nuk mund të monitorojë rëniet e papritura të performancës akademike, gjë që mund të jetë një shenjë paralajmëruese e hershme për fëmijët në krizë, si fëmijët që janë viktima të dhunës, abuzimit, neglizhencës dhe/ose shfrytëzimit. Zakonisht shkollat nuk raportojnë të dhëna apo informacione në modulet që regjistrojnë braktisjen dhe dhunën e shkollës, duke krijuar sfida shtesë për MASHTI-n.

Me mbështetjen e UNICEF-it, moduli i veçantë shtesë i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm u zhvillua në SMIA për të identifikuar fëmijët në rrezik të braktisjes së shkollës. Kur u zhvillua moduli, mësimdhënësit (kujdestërt e klasës) në shkolla u trajnuan për të identifikuar nxënësit sa më shpejt që të ishte e mundur për t'i parandaluar ata që të braktisnin shkollën. Megjithatë, me kalimin e kohës, moduli i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm nuk ka funksionuar siç ishte planifikuar fillimisht, dhe shkollat në vetëm 10 nga 30 komunat në Kosovë raportojnë rregullisht të dhëna për fëmijët në rrezik të braktisjes së shkollës. Ndërsa shumica e shkollave kanë informacion për fëmijët në rrezik të braktisjes, atyre u mungon kapaciteti teknik për të raportuar informacionin në sistem. Gjatë konsultimeve, palët e interesit në sektorin e arsimit e përshkruajnë Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm si modul për regjistrimin e të dhënave për fëmijët që braktisin shkollën dhe që largohen nga Kosova për të jetuar jashtë vendit. Megjithatë, Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm nuk funksionon si një sistem paralajmërimi i hershëm për të zvogëluar rrezikut e braktisjes.

UNICEF-i gjithashtu mbështeti MASHTI-n për të zhvilluar një modul të veçantë në SMIA për dhunën në shkollë (p.sh. lloji i dhunës, gjinia, mosha dhe klasa e viktimave dhe autorëve, si dhe emrat e viktimave dhe autorëve). Moduli i dhunës në shkollë është gjithashtu një modul shtesë.[7] Mirëpo,

7 Në kohën që UNICEF dhe MESTI zhvillojnë Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm dhe modulet e dhunës në shkollë, ishte parashikuar që të dhënat të futeshin në këto module në baza ditore. Gjithashtu ishte parashikuar që këto dy module të ndërlidheshin në një farë mënyre, të paktën konceptualisht. Megjithatë, në praktikë këto module nuk janë të lidhura, që do të thotë se modulet nuk komunikojnë me njëri-tjetrin dhe të dhënat në këto module nuk lidhen; këto module janë sisteme të veçanta të të dhënave brenda SMIA. Për më tepër, të dhënat në këto dy module nuk lidhen me të dhënat në SMIA, sepse të dhënat individuale të nxënësit nuk regjistrohen në SMIA.

shkollat rrallë fusin të dhëna në lidhje me dhunën në shkollë në modulin SMIA; shpesh rastet raportohen në polici por jo në sistem. Modulet e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm dhe Dhunës në Shkolla janë integruar në SMIA, por nuk janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën ose me të dhëna të tjera në SMIA.

Sipas Udhëzimit Administrativ 25/2013[8], shkollat fusin të dhëna për nxënësit në SMIA gjatë gjithë vitit shkollor:

- Në shtator, në fillim të vitit shkollor
- Në tetor, kur të dhënat përditësohen
- Në janar, kur përditësohen të dhënat dhe regjistrohen arritjet/rezultatet
- Në qershor, në fund të vitit shkollor kur regjistrohen notat dhe informacionet për mungesat e nxënësve nga mësimi
- Në gusht, shkalla e braktisjes regjistrohet në SMIA për të gjithë vitin shkollor

Pasi që SIMA nuk regjistron të dhënat në nivel të nxënësit, emra apo numra identifikues, këto të dhëna nuk mund të lidhen me nxënësit individual. Kjo do të thotë se ka një margjinë të lartë gabimi me të dhënat në SMIA. Kështu, notat përfundimtare raportohen të agreguara me ndarje sipas gjinisë.

Futja e të dhënave ndryshon ndjeshëm në shkolla. Gjatë vizitës në një shkollë në komunë është vërejtur se shkolla përdor sistemin në letër ose në një tabelë në Microsoft Word për të mbledhur informacion nga mësuesit për nxënësit në klasat e tyre, duke përdorur kategoritë që janë në përputhje me SMIA. Mësuesit pastaj ia dërgojnë këto tabela drejtorit të shkollës; drejtori i shkollës ose një person i besuar i stafit të shkollës fut të dhënat në SMIA. Në shkolla të tjera, të dhënat e nxënësve mund të futen në SMIA nga kujdestarët e klasës. Pavarësisht nga metoda për futjen e të dhënave, është pothuajse e pamundur për shkollat dhe mësuesit të mbajnë gjurmët e nxënësve në SMIA sepse nuk ka emra apo numra identifikues dhe nxënësit në klasa shpesh kanë karakteristika ose demografi të ngjashme.

Gjithashtu është evidente që SMIA nuk arrin të paraqes me saktësi të dhëna për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ekziston një kolonë në SMIAqë lejon shkollat të regjistrojnë informacione për llojin e aftësisë së kufizuar që mund të ketë një fëmijë; megjithatë, nuk ka përkufizime ose udhëzime se si të përcaktohet ose kategorizohet aftësia e kufizuar. Për më tepër, mund të zgjidhet vetëm një kategori e aftësisë së kufizuar. Nëse një fëmijë ka më shumë se një aftësi të kufizuar, ai regjistrohet si person me aftësi të kufizuara të shumëfishta pa mundësi të ndarjes sipas llojeve të aftësisë së kufizuar. Për më tepër, nuk ekzistojnë fusha për të futur informacion në lidhje me certifikimin/validimin e një aftësie të kufizuar nga autoritetet zyrtare. Në disa raste, nxënësit që mbanin syze u raportuan nga mësuesit si persona me aftësi të kufizuara në shikim, që tregon mungesën e njohurisë mbi të kuptuarit e përkufizimeve dhe kategorizimeve zyrtare të aftësisë së kufizuar.

Ka edhe raste kur shkollat përpiqen t'i kapërcejnë këto kufizime. Një shkollë komunale, për shembull, përdor një sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave në shkollë, i zhvilluar në Excel, për të gjurmuar nxënësit (individualisht) sipas klasës dhe performancës akademike. Shkolla ka gjithashtu dosje në letër për çdo nxënës me aftësi të kufizuara, e cila përmban të gjitha dokumentet e kërkuara që vërtetojnë aftësinë e kufizuar të fëmijës, duke përfshirë të dhënat personale dhe informacionin për fëmijën dhe familjen e tij, si dhe akomodime të veçanta të ofruara nga shkolla. Këto të dhëna në Excel dhe të bazuara në dosje të letrës mbledhin të dhëna dhe informacione më të sakta dhe të besueshme për fëmijët, përfshirë ata me aftësi të kufizuara. Të dhënat e vetme që nuk regjistrohen nga shkollat janë të dhënat për fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje, si p.sh. fëmijët që janë viktima të dhunës, abuzimit të fëmijëve dhe/ose neglizhencës në shtëpi dhe familje, apo fëmijë që shfrytëzohen për punë, apo cenueshmëri të tjera.

Sfidat teknike mbizotërojnë. Disa shkolla, veçanërisht ato jashtë Prishtinës, përballen me probleme me qasjen në internet, duke e bërë të vështirë futjen e të dhënave. Për shembull, nëse lidhja me

8 Udhëzimi Administrativ 25/2013 për Regjistrimin, Mirëmbajtjen dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Sistemin Arsimor, siç është qasur në http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Udhezues-per-perdorim-te-SMIA_FINAL_02.pdf

SMIA shkëputet nga interneti ndërsa stafi po fut të dhëna, ata duhet t'i rifusin të dhënat. Për më tepër, serveri ose rrjeti i SMIA mund të mbingarkohet kur shumë shkolla përpiqen të përdorin SMIA në të njëjtën kohë për të futur të dhëna. Shkollat gjithashtu raportojnë probleme me ruajtjen dhe mbajtjen e të dhënave dhe shënimeve në SMIA. Për shembull, shkollat futin të dhëna dhe shënime, por më pas ato nuk shfaqen në sistem, kështu që të dhënat duhet të rifuten. Shkollat raportojnë gjithashtu një hapësirë të kufizuar për futjen e shënimeve. Përfundimisht, mbështetja në mbledhjen manuale të të dhënave, raportimin dhe grumbullimin në nivel klase mund të rezultojë në gabime gjatë futjes së të dhënave në sistem.

MASHTI raportoi se një manual trajnimi u zhvillua kur u zhvillua fillimisht SMIA. Megjithatë, manuali nuk është përditësuar që atëherë, duke e bërë atë pothuajse të papërdorshëm. Është raportuar se ekziston një video tutorial se si të përdoret SMIA, që është përditësuar herën e fundit kur është përditësuar SMIA, por është e paqartë nëse shkollat përballen me sfida në qasjen dhe/ose shikimin e video-tutorialit duke pasur parasysh problemet e lidhjes me internetin, veçanërisht në shkollat jashtë Prishtinës. Për më shumë se tre vjet, Banka Botërore është përpjekur të mbështesë MASHTI-n për të fuqizuar SMIA, por kjo punë nuk u realizua.

Dy herë gjatë vitit SMIA përdoret nga MASHTI për të prodhuar statistika për fëmijët në shkolla me ndarje sipas gjinisë, moshës, klasës, aftësisë së kufizuar, rajonit dhe më shumë, për qëllime monitorimi. Në baza vjetore, statistikat publikohen në vjetarin statistikor të arsimit. Këto publikime janë Statistikat e Arsimit në Kosovë dhe Raporti Vjetor Statistikor me Treguesit Arsimor. Të gjitha publikimet theksojnë se të dhënat për fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë të besueshme. Së paku një herë në vit, MASHTI, në bashkëpunim me ASK-në, publikon vjetorin statistikor të arsimit

MASHTI raportoi se statistikat e arsimit përdoren nga ministria për të marrë vendime mbi politikat dhe për të informuar shkollat. Vitet e fundit, ata raportuan gjithashtu shpërblimin e shkollave për parandalimin e hershëm të braktisjes së shkollës dhe atyre pa dhunë në shkollë. MASHTI raportoi se komunat gjithashtu kenë qasje në SMIA për të gjeneruar raporte.

Megjithatë, shkollat nuk janë në gjendje të përdorin SMIA për të gjeneruar statistika për shkollat e tyre.

### *Shkolla speciale dhe qendra burimore për fëmijët me aftësi të kufizuara*

Udhëzimi Administrativ për Qendrat Burimore (MASHTI) 23/2013[9] është dokumenti kryesor ligjor për deinstitucionalizimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Këtë e arrin duke krijuar pesë qendra burimore si institucione arsimore mësimore për fëmijët aftësi të kufizuara , duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta. Qendrat burimore gjithashtu pritet të ofrojnë shërbime profesionale dhe këshillime për të gjitha shkollat e rregullta dhe komunitetin. Pavarësisht futjes së kësaj rregulloreje, jo të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara janë deinstitucionalizuar dhe disa fëmijë me aftësi të kufizuara vazhdojnë të qëndrojnë në shkolla speciale.

Megjithëse disa fëmijë me aftësi të kufizuara janë të integruar në shkolla dhe klasa të rregullta, disa në shkolla të rregullta që kanë dhoma burimore të caktuara për fëmijët me aftësi të kufizuara (p.sh., klasa të bashkangjitura ose burime), fëmijët e tjerë me aftësi të kufizuara mbeten në shkolla speciale dhe qendra burimore (p.sh. qendra ditore) për fëmijët me aftësi të kufizuara. Fëmijët me aftësi të kufizuara ose dëmtime të rënda kanë më shumë gjasa të qëndrojnë në një shkollë speciale ose të ndjekin një qendër burimore, të cilat në thelb janë objekte alternative të kujdesit për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Për këtë vlerësim është intervistuar vetëm një drejtor i shkollës speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kështu, ky seksion fokusohet në sistemet e menaxhimit të të dhënave administrative në shkollat speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Shkollave speciale dhe qendrave burimore për fëmijët me aftësi të kufizuara u kërkohet të futin të dhëna për fëmijët në SMIA. Përveç kësaj, shkollat speciale kanë sisteminnë dosje të letrës për regjistrimin e fëmijëve në këto institucione dhe të ashtuquajturat Libra Protokollit. Librat e protokollit përdoren në klasat 1-5, 6-9 dhe 10-12 dhe një Libër tjetër Protokolli përdoret për të lëshuar certifikata dhe për evidentimin e arritjeve të çdo fëmije (d.m.th. certifikimin për shkollë të mesme në fushën

9 UDHËZIM ADMINISTRATIV: Nr 23/2013 për QENDRAT BURIMORE. Burimi: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10578

e bujqësisë). Është e rëndësishme të kuptohet se Librat e Protokollit që përdoren sot në shkollat speciale janë të njëjta me ato të përdorura në vitet 1960.[10] Librat e Protokollit përfshijnë informacione të tilla si emri, mbiemri, emri i prindërve, vendlindja dhe vendbanimi i fëmijës. Megjithatë, nuk ka asnjë informacion apo shënim për aftësinë e kufizuar të fëmijës. Shkollat speciale regjistrojnë të dhëna vetëm në Librat e Protokollit dhe në SMIA që kërkohet nga MASHTI, ashtu sikurse informtat që mbledhen fëmijët në shkollë të rregullt. Si rezultat, shkollat speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara konstatojnë se të dhënat në Librat e Protokollit dhe SMIA janë të kufizuara dhe jo relevante për shkollat speciale. Mangësitë e dukshme të të dhënave përfshijnë të dhëna të pasakta për numrin e fëmijëve në shkollat speciale dhe qendrat burimore për fëmijët me aftësi të kufizuara për shkak të kycjes më vonë të fëmijëve në mjedise shkollore gjatë gjithë vitit shkollor. Ky sistem i të mbledhjes së të dhënave nuk regjistron të dhëna ose informacione se kur ose për çfarë arsye një fëmijë largohet nga shkolla speciale ose qendra burimore, ku shkon fëmija ose nëse ndonjë fëmija ka vdekur.

Prej dy vitesh drejtorët e shkollave speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara kanë biseduar me MASHTI-n për problemet që lidhen me të dhënat dhe informacionin e regjistruar në Librat e Protokollit dhe SMIA. Shkollat speciale kanë përfshirë edhe qendra burimore për fëmijët me aftësi të kufizuara në diskutime për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave përkatëse. Më konkretisht, ata i kanë kërkuar MASHTI-t për të reviduar dhe përditësuar Librat e Protokollit dhe SMIA për mbledhjen e të dhëna dhe informatave për fëmijët me aftësi të kufizuara (d.m.th., të dhëna dhe informacione që do të dokumentojnë më saktë aftësitë e kufizuara dhe diagnozat e fëmijëve, performancën e tyre akademike dhe progresin dhe akomodimet dhe shërbimet speciale të ofruara për fëmijët). Një shkollë speciale raportoi organizimin e grupeve të punës me stafin e shkollës dhe mësuesit për të diskutuar mënyrën më të mirë për të rishikuar dhe përditësuar Librat e Protokollit dhe SMIA për të regjistruar të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Një sfidë tjetër me të cilën përballen shkollat speciale dhe qendrat burimore për fëmijët me aftësi të kufizuara është se ato bashkëpunojnë shumë pak me agjencitë e shërbimeve sociale, siç është QPS. Ka pak ose aspak bashkëpunim ndër-sektorial për të mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre. Ekzistojnë gjithashtu boshllëqe në shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit: shkollat speciale dhe qendrat e burimore duhet të jenë në gjendje të shkëmbejnë të dhëna dhe informacion me agjencitë e shërbimeve sociale, duke përfshirë QPS-në, për menaxhimin e rasteve për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për të siguruar ofrimin e shërbimeve të integruara dhe të koordinuara për fëmijët dhe familjet e tyre. Nevojiten sisteme të menaxhimit të rasteve ndërinstitucionale, por ende nuk është e qartë nëse kjo do të bëhet përmes PIShS.

Për të kapërcyer këto probeleme, një shkollë speciale theksoi se shkolla përdor sistemin e brendshëm të menagjimit, i cili u zhvillua në Excel për të gjurmuar nxënësit individualisht sipas klasës dhe performancës akademike. Shkolla gjithashtu zhvilloi dosje të shkruar me dorë të bazuar në letër[11] që përdorin për të regjistruar të dhënat për një fëmijë, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin e secilit fëmijë; emrin dhe mbiemrin e prindërve; vendin e lindjes; datën e lindjes; komunën; numrin e identifikimit në Librat e Protokollit; gjendja familjare; llojin e aftësisë së kufizuar dhe/ose dëmtimeve; kur një fëmijë është regjistruar nga komisioni vlerësues për pranim në shkollë; diagnoza nga komisioni i vlerësimit dhe/ose psikologu; plani i trajtimit dhe trajtimet e ofruara. Këto të dhëna dhe informacione regjistrohen vetëm për qëllime të brendshme.

## Anketa e mbështetur nga UNICEF për funksionimin e fëmijëve

Edhe pse nuk ishte pjesë e këtij vlerësimi të sistemeve të të dhënave administrative, si pjesë e nismës globale të UNICEF-it për të fuqizuar statistikat për fëmijët me aftësi të kufizuara, UNICEF në bashkëpunim me Grupin e Uashingtonit kanë zhvilluar një instrument të standardizuar – Modulin e Funksionimit të Fëmijëve të UNICEF/Grupit të Uashingtonit (CFM). CMF u zhvillua ekskluzivisht për fëmijët e moshës 2 - 17 vjeç. CFM mat vështërsitë funksionale në tetë fusha për fëmijët e moshës

10 Librat e Protokollit të gjetur në një nga shkollat ishin nga viti 1966 deri në 1998, para luftës.

11 Në këtë shkollë speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara u përdor një formë e shkruar me dorë, e bazuar në letër, sepse shumica e stafit ishin të moshuar dhe nuk kishin aftësi kompjuterike.

24 vjeç (d.m.th., shikimi, dëgjimi, ecja, motorika e përsosur, komunikimi, mësimi, loja dhe kontrolli i sjelljeve) dhe 13 fusha për fëmijët e moshës 5 -17  vjeç (d.m.th., shikimi, dëgjimi, ecja, komunikimi, mësimi, kujdesi për veten, kujtimi, përqendrimi, pranimi i ndryshimeve, kontrolli i sjelljes, krijimi i miqve dhe shenjat e ankthit dhe depresionit).[12] Moduli i Arsimit Gjithëpërfshirës i UNICEF/Grupit të Uashingtonit (IEM) u zhvillua gjithashtu për të përfshirë pyetje specifike në lidhje me pjesëmarrjen në shkollë dhe faktorët që lehtësojnë dhe pengojnë pjesëmarrjen në shkollë.[13]

Në kohën e këtij rishikimi, UNICEF dhe MASHTI ishin në proces të kryerjes së një ankete që do të testonte nëse CFM mund të përdoret për të gjeneruar të dhëna të besueshme për aftësinë e kufizuar në kuadër të SMIA. Rezultatet e anketës do të informojnë hapat e ardhshëm kritikë në proces dhe do të vlerësojnë më tej nëse dhe në çfarë kushtesh, mësuesit mund të ofrojnë raporte të besueshme mbi vështirësitë funksionale të nxënësve. Kjo përfshin matjen e besueshmërisë ndërmjet vlerësuesve[14] midis mësuesve të ndryshëm për të njëjtin fëmijë dhe midis mësuesve dhe kujdestarëve të fëmijës. Gjetjet e anketës duhet të konsiderohen si pjesa thelbësore e SMIA për adresimin e aftësive të kufizuara dhe duhet të ndërtohen në mënyrë standarde që garanton cilësi të mirë të të dhënave dhe krijimin e treguesve të krahasueshëm. Ky projekt do të gjenerojë gjithashtu informacione relevante për të identifikuar komponentët thelbësore të një qasjeje të standardizuar për matjen e aftësisë së kufizuar në SMIA.

12 Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (2022). Statistikat për Fëmijët: Në qendër të vëmendjes fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës, në përkujdesje alternative dhe me aftësi të kufizuara. UNECE: Gjenevë, Zvicër. Marrë më 4 dhjetor 2022 nga:ECECESTAT20225.pdf (unece.org)

13 Po aty, 2022.

14 Besueshmëria ndërmjet vlerësuesve është shkalla në të cilën dy ose më shumë vlerësues (ose vëzhgues, kodues, ekzaminues) bien dakord dhe punon për të siguruar qëndrueshmëri brenda sistemeve të vlerësimit.

# MINISTRIA E SHËNDETËSISË (MSH)

## Të dhënat administrative

Në nivel global, vendet kanë prezantuar sistemet kombëtare të informacionit të menaxhimit të shëndetit për të mbledhur, ruajtur, analizuar dhe vlerësuar të dhënat e lidhura me shëndetin nga institucionet shëndetësore në nivele administrative, rajonale dhe kombëtare. Këto sisteme informacioni mund të prodhojnë raporte analitike dhe vizualizime që lehtësojnë vendimmarrjen në të gjitha këto nivele. Pjesa më e madhe e informacionit rrjedh nga ndërveprimet pacient-ofrues në institucionet shëndetësore, duke përfshirë spitalet, qendrat shëndetësore dhe shërbimet e komunikimit në komunitet që ofrojnë kujdes shëndetësor (p.sh., ndërhyrjet parandaluese, mjekësore, kirurgjikale dhe rehabilituese). Këto sisteme menaxhimi regjistrojnë gjithashtu informacione për ngjarjet shëndetësore, kontrollojnë cilësinë e shërbimeve në nivele të ndryshme të sistemit të kujdesit shëndetësor dhe shërbejnë si instrument për të përmirësuar kënaqësinë e pacientëve.

Në vitin 2018, me mbështetjen e Bankës Botërore, Ministria e Shëndetësisë filloi procesin e zhvillimit të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH) për Kosovën; katër vjet më vonë MSH është ende duke punuar për zhvillimin dhe vënien në përdorim të SISH. Megjithatë, SISH i Kosovës nuk është duke u zhvilluar për të funksionuar si një SISH tipik; është zhvilluar për t'u përshtatur me Klasifikimin e Brendshëm të Sëmundjeve-9 (ICD-9) dhe ICD-10, të cilat janë lista të klasifikimit mjekësor të zhvilluara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Këto lista përfshijnë kodet për sëmundjet dhe infeksionet; çrregullime mendore dhe të sjelljes; kushte të caktuara; keqformime kongjenitale, deformime dhe anomali; simptoma dhe shenja; lëndime dhe pasoja të tjera të shkaqeve të jashtme dhe të tjera. ICD-9 dhe ICD-10 përfshijnë gjithashtu kode për aftësitë e kufizuara, duke përfshirë aftësitë e kufizuara në të nxënë, çrregullimet e zhvillimit të aftësive shkollore (p.sh. lexim, matematikë drejtshkrim, shkollim), funksione motorike dhe kufizime të aktiviteteve për shkak të aftësisë së kufizuar. Megjithatë, prezantimi i rishikimit i njëmbëdhjetë i ICD (ICD-11), më 1 janar 2022, e ka bërë SISH të vjetruar. Nuk dihet nëse MSH ka plane për të rishikuar SISH për ta përafruar me ICD-11, veçanërisht pasi SISH është ende në zhvillim.

Një nga gjetjet tjetër është se SISH nuk përfshin emrat e pacientëve ose numrat e identifikimit; kështu, SISH nuk mund të përdoret nga pacientët ose ofruesit e kujdesit shëndetësor për të menaxhuar dhe monitoruar kujdesin shëndetësor të pacientit. Përveç kësaj, SISH nuk përfshin shënimet e ofruesve të kujdesit shëndetësor për pacientët që do të thotë se nuk mund të përdoret nga ofruesit e kujdesit shëndetësor për të menaxhuar kujdesin dhe trajtimin e pacientit të tyre. Nuk ishte plotësisht e qartë për sa i përket qëllimit të SISH, veçanërisht pasi ai nuk është projektuar për të funksionuar si një sistem tipik informativ i menaxhimit në shëndetësi.

SISH është funksionalizaur në objektet shëndetësore parësore në 29 nga 31 komunat, por jo në spitalet parësore. Megjithatë, shumica e ofruesve të kujdesit shëndetësor, përfshirë institucionet shëndetësore parësore, nuk e përdorin sistemin dhe mbështeten kryesisht në të dhënat shëndetësore të bazuara në letër. SISH duhet të funksionalizohet në objektet shëndetësore dytësore ose tretësore ose tek klinika gjinekologjike obstetrike. MSH raportoi se disa objekte të kujdesit shëndetësor nuk kanë sistem rrjetëzimi për të mbështetur SISH, por këto sisteme nuk janë përgjegjësi e MSH.

Gjithashtu u raportua se SISH është i ndërlidhur me RCSV, ose do të jetë, gjë që do të ndihmojë për të identifikuar nëse lindja e një të porsalinduri është regjistruar apo jo në RCSV dhe anasjelltas. Aktualisht, kjo do të funksiononte vetëm në objektet e kujdesit parësor shëndetësor që janë të lidhura me SISH. Kjo nuk përfshin spitalet parësore, klinikat gjinekologjike obstetrikeose apo objektet e kujdesit shëndetësor dytësor dhe tretësor ku gratë mund të lindin ose të marrin kujdesin pas lindjes dhe kontrollet shëndetësore pasuese të të porsalindurve.

Në vitin 2022, MSH raportoi se po përdorin SISH por nuk është plotësisht i digjitalizuar apo i përdorur në të gjitha objektet e kujdesit shëndetësor apo nga të gjithë ofruesit e kujdesit shëndetësor. MSH pranoi se SISH duhet të përshtatet për të punuar në të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor parësor, duke përfshirë spitalet, dhe duhen bërë akoma më shumë përshtatje për shtrirje të

suksesshme në institucionet e kujdesit shëndetësor dytësor dhe tretësor. Institucionet private të kujdesit shëndetësor ende nuk përdorin SISH.

Për sa i përket të dhënave të mbledhura për shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve, SISH nuk mbledh në mënyrë adekuate të dhëna për fëmijët ose nuk i zbërthen të dhënat në një mënyrë që mundëson monitorimin e shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve. Për më tepër, masat e Klasifikimin e Brendshëm të Sëmundjeve (ICD) për dhunën ndaj fëmijëve janë të kufizuara dhe nuk është e qartë nëse këto masa dhe kode janë të përfshira në SISH.

MSH përmendi gjithashtu zhvillimin e një moduli për vizitat në shtëpi, por ai modul ende nuk është zbatuar apo integruar plotësisht në SISH. Gjithashtu është raportuar se MSH ende nuk e ka përdorur SISH-in për të gjeneruar raporte.

# POLICIA E KOSOVËS

## Të dhënat administrative

Policia e Kosovës ka një sistem informativ të të dhënave, i referuar këtu si Sistemi për menaxhimin e informatave të Policisë së Kosovës (SIMPK), i cili është lënë pas nga Misioni Paqeruajtës i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe për herë të fundit është përditësuar në vitin 2014. Thirrjet e bëra në numrin 192 ruhen në një bazë të dhënash të dytë dhe komunikimet radiofonike të policisë ruhen në një bazë të dhënash të tretë.

Fillimisht, raportimet në polici regjistrohen në një sistem të bazuar në letër me raportet e incidenteve të regjistruara në një regjistër letre në komisariatet e policisë. Pas regjistrimit të një incidenti (rasti) në stacionin policor, ai mund të transferohet në operacione dhe të shpërndahet për futjen e të dhënave në SIMPK. Më pas i transferohet një zyrtari të policisë për ndjekje dhe/ose hetim. Në situata të tilla, çështja dërgohet në bazën e të dhënave kompjuterike si rast incidenti ose policie.

Jo të gjithë zyrtarët e policisë janë në gjendje të fusin të dhëna në SIMPK. Për shembull, policia mund të ketë katër raporte të rastit, por vetëm një zyrtar ka qasje në SIMPK për të futur të dhënat dhe informacionin e rastit. Në shumicën e situatave, zyrtari e inicion rastin nga regjistri i letrës ku rastit i caktohet një numër. Ky është procesi i përgjithshëm, por procesi mund të ndryshojë sipas stacioneve policore dhe sipas natyrës së rastit ose krimit.

Kur një i mitur është kryes, çështja do të trajtohet nga Njësia Hetimore dhe Zyrtarët Hetimor. Lloje të tjera rastesh, përfshirë abuzimin me fëmijët dhe të miturit e dyshuar nën moshën e përgjegjësisë penale trajtohen gjithashtu nga kjo njësi. Nëse fëmija ose i mituri është nën 14 vjeç, vetëm inicialet e tyre shënohen në SIMPK, sepse të miturit nën moshën 14 vjeç janë nën moshën e përgjegjësisë penale dhe nuk mund të ndiqen penalisht sipas ligjit. Rastet që përfshijnë fëmijë të dyshuar nën moshën e përgjegjësisë penale i referohen QPS-së.

Në rastet kur një i mitur në moshën e përgjegjësisë penale dyshohet për vepër penale në lidhje me substancat narkotike, rasti hetohet nga Drejtoria e Specializuar Kundër Narkotikëve. Në rastet kur një fëmijë shfrytëzohet për kërkim lëmoshe, atëherë rasti hetohet nga Drejtoria e Specializuar Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Në përgjithësi, rastet që përfshijnë të mitur në konflikt me ligjin dhe fëmijë që kanë përjetuar abuzime trajtohen ose hetohen nga njësi apo drejtori të tjera, në varësi të shkeljes së dyshuar.

Pyetjet në SIMPK mund të drejtohen sipas numrit të lëndës, klasifikimit të krimit dhe kodeve penale (në lidhje me krimet kundër fëmijëve). Nuk ishte e qartë nëse pyetjet mund të ndaheshin sipas gjinisë dhe moshës së fëmijëve viktima që janë nën 18 vjeç. Për më tepër, të dhënat për fëmijë dëshmitarë dhe autorë nuk mund të nxirren lehtësisht sipas llojit të krimeve dhe/ose grupeve të ndara të gjinisë dhe moshës. Për të nxjerrë të dhëna dhe informacione të tilla, dosjet e rastit do të duhej të rishikoheshin dhe të dhënat do të duhej të nxirreshin në mënyrë manuale për të përcaktuar nëse viktima dhe/ose dëshmitarët ishin fëmijë ose të mitur nën 18 vjeç.

Ekzistojnë gjithashtu sfida të tjera. SIMPK nuk ka një dosje specifike për të ndarë të dhënat për fëmijët dhe të rriturit, kështu që gjatë kërkimit të rasteve që përfshijnë fëmijë ose të mitur, duhet të shënohet një moshë. Përveç kësaj, mosha e fëmijës regjistrohet sipas datës së lindjes në kohën e incidentit. Megjithatë, mosha e fëmijës rritet në sistem nga viti në vit; nëse një kërkesë për raportim është bërë në 2021 kur fëmija është 17 vjeç, kërkesë për raportim në vitin 2022 raporton të njëjtin fëmijë si 18 vjeç. Kështu, mosha e fëmijës në momentin e incidentit humbet në SIMPK me kalimin e viteve. Së fundi, nëse statusi i një rasti ndryshon, si për shembull një arrestim, është e vështirë të analizohet ose të nxirret ai informacion nga sistemi.

Lidhjet ndërmjet dhe brenda zyrave të zbatimit të ligjit vazhdojnë të jenë të paqëndrueshme. Për shembull, Policia e Kosovës ka një sistem që është i lidhur me Prokurorinë për dërgimin e rasteve për ndjekje penale. Ky proces dikur bëhej me kopje fizike, por tani është digjitalizuar me PDF që skanohen dhe ngarkohen në sistem dhe njoftime që konfirmojnë marrjen. Drejtoria e Specializuar Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore megjithatë ka një sistem të veçantë të dhënash që nuk është i bashkangjitur në internet dhe nuk është i integruar me SIMPK-në apo ndonjë platformë tjetër të të dhënave të policisë.

# KËSHILLAT PROKURORIAL DHE GJYQËSOR TË KOSOVËS

## Të dhënat administrative

Që nga viti 2014, Këshilli Prokuroria dhe i Drejtësisë i Kosovës kanë punuar për zhvillimin e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SMIL) me rreth 10 milionë euro financim nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze. SMIL synon të përmirësojë efikasitetin në sistemin gjyqësor, të sigurojë të dhëna të disponueshme për rastet gjyqësore dhe të përmirësojë aftësinë e gjyqësorit për të menaxhuar rrjedhat e çështjeve duke braktisur procedurat manuale të ngadalta dhe të pasakta që janë përdorur tradicionalisht.

Pas gati 10 vitesh zhvillim, SMIL nuk është ende plotësisht funksional. Konkretisht, SIML nuk funksionon në Këshillin Prokurorial, i cili është përballur me sfida të shumta të zhvillimit të sistemit me zhvilluesin. Si rezultat, Këshilli Prokurorial ende mbështetet në regjistrat e bazuar në letër në Prokuroritë për informacionin e rastit. Këshilli Prokurorial është duke punuar për të ndërtuar një modul për statistika dhe parashikon se do t'i duhen të paktën edhe dy vite të tjera para se SMIL të funksionalizohet. Megjithatë, është e pasigurt nëse ata do të jenë në gjendje të përdorin SMIL për të gjeneruar raporte. SMIL është dashur të finalizohej më 15 shtator 2022, por deri në kohën e zhvillimit të  këtij raporti, ishte ende në proces.

Sigurimi i të dhënave të sakta dhe cilësore ka qenë një sfidë e madhe për Këshillin Prokurorial. Kjo është pjesërisht sepse informacioni regjistrohet për çdo rast specifik duke përdorur një regjistër të bazuar në letër. Zyra e menaxhimit të lëndëve cakton një zyrtar për çdo regjistër përkatës, i cili është përgjegjës për nxjerrjen e informacionit nga regjistri në formularin standard. Çdo Prokurori ka një regjistër dhe një formular standard të veçantë me informacion të nxjerrë nga regjistrat, në varësi të llojit të raporteve që duhet të krijohen. Informacioni më pas transferohet manualisht nga regjistri i bazuar në letër në formularin standard të bazuar në letër dhe ndahet me Këshillin Prokurorial, ku futet në një tabelë të Excel. Më pas krijohet një tabelë e Excel në nivel të Kosovës dhe për secilën nga 10 Prokuroritë.

Sfidat përfshijnë futjen e gabimeve kur informacioni transferohet në Excel. Kur të dhënat transferohen përfundimisht në SMIL, përsëri nuk ka garanci se të dhënat do të jenë të sakta.

Mbledhja e të dhënave për dhunën në familje është një tjetër rol i Këshillit Prokurorial, prokurorët specialë të të cilit trajtojnë rastet e dhunës në familje. Megjithatë, të dhënat që ata mbledhin për viktimat janë të kufizuara dhe shpesh jo të plota (p.sh. gjinia, mosha dhe mënyra se si u zgjidh rasti) dhe mungojnë gjithashtu të dhënat për autorët. Përkundër këtyre kufizimeve, Këshilli Prokurorial raportoi se kanë përgatitur raporte speciale për dhunën në familje. Gjithashtu, të dhënat për rastet që përfshijnë të mitur, zakonisht si kryes, publikohen në baza tremujore dhe vjetore. Pasi të jetë funksionalizuar SMIL-i, është e pasigurt nëse do të përdoren të dhënat në lidhje me fëmijët, të miturit (si viktima, dëshmitarë ose kryes). Këshilli Prokurorial parashikon që SMIL-i do të ketë ndikim në aftësinë e tyre për t'iu qasur të dhënave dhe informacioneve të rasteve më shpejt dhe për të gjeneruar me efikasitet statistika dhe raporte në lidhje me prokuroritë dhe rastet gjyqësore.

**Këshilli Gjyqësor** ka një sistem të ngjashëm, por mbulon 30 gjykata. Tradicionalisht, gjykatat kanë përdorur regjistra të bazuar në letër për të dokumentuar manualisht çështjet gjyqësore, por kjo ka qenë një barrë e madhe pasi shpesh kishte më shumë se 300,000 çështje gjyqësore. Rreth tre vjet më parë, Këshilli Gjyqësor filloi të kalonte nga regjistrat e bazuar në letër në SMIL, por gjykatat rezistuan ndaj përdorimit të SMIL-it dhe vazhduan të përdorin regjistrat e bazuar në letër. Përfundimisht, Këshilli Gjyqësor vendosi të ndërpresë regjistrin, duke i detyruar gjykatat të përdorin SMIL. Gjykatat vazhduan të rezistonin ndaj përdorimit të SMIL-it, kështu që Këshilli Gjyqësor përdori SMIL-in si pjesë e procesit të vlerësimit për gjyqtarët, gjë që ofroi nxitjen për të kaluar.

Gjykatat vazhdojnë të përballen me sfida të rëndësishme për futjen e të dhënave në SMIL për shkak se atyre u mungojnë dokumentet ose informacionet për çdo rast gjyqësor, duke përfshirë informacionin për viktimat dhe autorët (p.sh. gjininë, moshën dhe kombësinë). Informacioni që përmban dosjet për çështjet gjyqësore me të mitur është edhe më i kufizuar.

Nisur nga këto sfida të të dhënave, Këshilli Gjyqësor është në proces të kryerjes së një auditimi të të dhënave gjyqësore për nene të caktuara. Gjetjet e deritanishme tregojnë se sa e vështirë është gjetja e një personi në dokumentet gjyqësore. Për shembull, kur një person akuzohet për pesë vepra të ndryshme, secila vepër, së bashku me vendimin e rastit, mund të shfaqet në forma të ndryshme në procesverbalet gjyqësore. Në praktikë, informacioni i rastit për një rast të vetëm gjyqësore mund të shpërndahet në shumë forma, gjë që e bën atë të shfaqet si raste të shumta. Dosjet e vjetra të rasteve gjithashtu priren të kenë mungesë informacioni përkatës dhe kodet penale kanë ndryshuar me kalimin e kohës, duke rezultuar në kode të vjetra dhe të reja penale që nuk përputhen me sistemin e të dhënave administrative.

Si Këshilli Prokurorial ashtu edhe ai Gjyqësor i njohin sfidat dhe mangësitë e shumta në lidhje me saktësinë e të dhënave dhe përballen me një mori sfidash në gjenerimin e raporteve të rregullta. Këto probleme ekzistojnë pjesërisht nga të dhënat e kufizuara brenda regjistrave dhe dosjeve të bazuara në letër. Kjo është gjithashtu për shkak se prokurorët dhe zyrtarët e gjykatave nuk regjistrojnë sistematikisht informacionin e çështjes ose nuk futin dhe përditësojnë rregullisht të dhënat në sistemet e menaxhimit të të dhënave, qofshin ato në letër apo digjitale, ndërsa rasti vazhdon nëpër gjykata.

Në të ardhmen, SMIL do t'u mundësojë qytetarëve të përcjellin plotësisht ecurinë e rasteve të tyre. (Modeli i testimit që është zhvilluar ilustron se si një person mund të zgjedhë një çështje gjyqësore, të identifikojë kryetarin e trupit gjykues dhe të shohë se si u zgjidh rasti.)

# MINISTRIA E DREJTËSISË (MD)

## Të dhënat administrative

Ministria e Drejtësisë nuk ka databazë të unifikuar, megjithëse ka interesim për krijimin e databazës së unifikuar që do të përfshinte Policinë e Kosovës, Këshillin Prokurorial dhe atë Gjyqësor, si dhe Shërbimet Korrektuese dhe Sprovuese. Për arritjen e këtij qëllimi, është duke u hartuar një ligj për të siguruar databazë të unifikuar të shkelësve dhe të burgosurve. Në kohën e këtij shqyrtimi, MD-ja kishte databaza për shërbime korrektuese dhe sprovuese që kishin kufizime të shumta.

Në Kosovë, sistemi i shërbimeve korrektues përfshin 11 institucione penale që secila ruan të dhënat veç e veç. Sistemet e menaxhimit të të dhënave ndryshojnë nga institucioni në institucion. Disa institucione kanë të dhëna dhe informacione në Excel, ndërsa institucionet korrektuese priren të përdorin sistemet e bazuara në letër. Kjo mungesë konsistence krijon sfida të konsiderueshme për MD-në, e cila ka mungesë të dhënash ose informacionesh të përditësuara lidhur me të pandehurit në institucionet korrektuese, duke përfshirë emrat e tyre dhe historitë kriminale (p.sh. arrestimet dhe dënimet). Për të mbledhur këto të dhëna, MD-ja duhet të telefonojë secilin prej 11 institucioneve korrektuese dhe të kërkojë të dhëna për personat, së bashku me historitë e tyre kriminale dhe dënimet, në masën që ato janë në dispozicion. Përkundër këtyre kufizimeve dhe barrierave, MD-ja është përpjekur të ndërtojë databazë të pandehurve që kanë qenë më parë dhe aktualisht janë në institucionet korrektuese në mbarë Kosovën, sipas llojit të institucionit penal. Kjo databazë nuk është as e plotë dhe as e saktë. Ndërtimi i databazës së shërbimit korrektues ka rezultuar të jetë sfidues sepse MD-ja nuk ka qasje në informacionet mbi arrestimet apo dënimet. Në shumë raste, MD-ja duhet të kërkojë informacionet e tilla nga Policia e Kosovës dhe gjykatat.

Në vitet e fundit, MD-ja është mbështetur në disa OJQ për të përpiluar dhe analizuar të dhënat për pandehurit me vepra penale në institucionet korrektuese për të plotësuar databazën e saj. MD-ja është mbështetur gjithashtu në statistikat (p.sh. përqindjet) të publikuara në raportet e OJQ-ve, sepse MD-ja nuk ka të dhëna për të burgosurit dhe recidivizmin. Përveç kësaj, MD-ja nuk ka databazë për të pandehurit e mitur dhe zakonisht duhet të kërkojë të dhëna dhe informacion nga punonjësit socialë që hulumtojnë dosjet e tyre të rasteve të cilat janë në formë letre. Në shumicën e rasteve, MD-ja dhe punonjësit socialë thjesht duhet të pyesin të miturit për historitë e tyre kriminale dhe kontaktet e mëparshme me policinë dhe sistemin e drejtësisë për të mbledhur informacionet e tilla. Për fëmijët nën moshën 14 vjeç – mosha e përgjegjësisë penale – nuk ka informacion në dispozicion. Për më tepër, të dhënat për krimet ndaj fëmijëve dhe fëmijëve viktima nuk janë mbledhur nga MD-ja.

Shërbimet Sprovuese kanë databazë të veçantë nga Shërbimet Korrektuese. Databaza e shërbimit sprovues përfshin të dhëna për të pandehurit e mitur dhe të rritur në shërbim sprovues, si emri dhe mbiemri i tyre, certifikata e lindjes dhe numri i identifikimit. Përsëri, MD-ja duhet të pyesë të miturit për kontaktet e tyre të mëparshme me policinë dhe sistemin e drejtësisë për të plotësuar databazën e shërbimit sprovues.

Në vitin 2019, MD-ja dhe Koordinatori Kombëtar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje filluan menaxhimin e Sistemit Informativ të Menaxhimit të Dhunës në Familje (SIMDhF). Kjo u zhvillua me financimin e BE-së dhe mbështetjen e Programit Rajonal të UN Women për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.[15]

SIMDhF-ja është i dedikuar posaçërisht për rastet e dhunës në familje dhe bazohet në memorandum mirëkuptimi ndërmjet institucioneve qeveritare që merren me dhunën ndaj grave dhe vajzave[16]

15 'Kosova do të fillojë të përdorë një bazë të dhënash të integruar për rastet e dhunës në familje', UN Women Europe dhe Azia Qendrore, 2 prill 2019. Marrë më 23 tetor 2022 nga:Kosova do të fillojë përdorimin e bazës së të dhënave të integruar për rastet e dhunës në familje | UN Women – Evropë dhe Azinë Qendrore

16 'Kosova do të fillojë të përdorë një bazë të dhënash të integruar për rastet e dhunës në familje', UN Women Europe dhe Azia Qendrore, 2 prill 2019. Marrë më 23 tetor 2022 nga:Kosova do të fillojë përdorimin e bazës së të dhënave të integruar për rastet e dhunës në familje | UN Women – Evropë dhe Azinë Qendrore

duke përfshirë Policinë e Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, QPS-të, Mbrojtësit e Viktimave në Prokurori dhe strehimoret e viktimave të dhunës në familje. SIMDhF-ja mbledh të dhëna administrative për rastet e dhunës në familje, të cilat i mundësojnë MD-së të monitorojë dhe përmirësojë trajtimin dhe ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje. Gjithashtu siguron llogaridhënien e institucioneve përkatëse për të menaxhuar në mënyrë të duhur rastet e dhunës në familje dhe për të plotësuar databazën me informacionin e nevojshëm nga niveli qendror dhe lokal.[17]

Të dhënat e marra në SIMDhF përfshijnë, por nuk kufizohen në llojin e dhunës në familje; ku ka ndodhur ngjarja; të dhëna të përgjithshme për viktimën(-at) dhe autorin(-et) duke përfshirë marrëdhënien e tyre; referimet e bëra ndërmjet institucioneve; regjistrimin e shërbimeve dhe veprave penale; dhe vendimet e gjykatave. Të dhënat për fëmijët viktima të dhunës në familje ose abuzimit të fëmijëve zakonisht ndahen sipas grupmoshave dhe ekziston mundësia për filtrimin e të dhënave për personat me aftësi të kufizuara. Ka të dhëna në dispozicion edhe për viktimat e dhunës në familje që shkojnë në strehimore, por këto të dhëna janë shënuar si numër dhe pa ndodnjë emër.

Së fundmi, është hartuar një ligj që do të kërkonte që rastet e dhunës në familje të regjistroheshin nga policia brenda 48 orëve, gjë që do të ndihmonte që SIMDhF-ja të sigurojë të dhëna në kohë reale për dhunën në familje. Në kohën e realizimit të këtij raporti, ishte e pasigurt se sa mirë funksiononte SIMDhF dhe shkalla në të cilën po përdorej nga secili prej institucioneve përkatëse qeveritare, duke përfshirë strehimoret pjesëmarrëse të dhunës në familje.

17 Po aty, 2019.

# STREHIMORET PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE TË OPERUARA NGA OJQ-të

## Të dhënat administrative

Në vitin 2018, më shumë se 400 gra me fëmijë kërkuan strehim në njërën nga shtatë strehimoret operative për viktimat e dhunës në familje në Kosovë. Mbi 1,100 raste të dhunës në familje janë raportuar nga Policia e Kosovës ndërmjet muajve janar dhe shtator të vitit 2018, duke përfshirë shtatë që kanë rezultuar me vdekje – me rritje prej më shumë se 13 për qind nga viti paraprak.[18]

Nga konsultimi me një strehimore për viktimat e dhunës në familje të drejtuar nga një OJQ doli se strehimoret e dhunës në familje nuk lejohen të pranojnë fëmijë pa kujdes prindëror, megjithëse herë pas here pranojnë vajza të moshës 15 -17 vjeç për periudha të shkurtra kohore, në bazë të vendimit të Prokurorisë, deri në transferimin e tyre në strehimore tjetër. Zakonisht, vajzat e moshës 15-17 vjeç të cilat ishin vendosur në strehimore për dhunën në familje nga Prokuroria vendosen aty për shkak se janë viktima të mundshme të trafikimit ose viktima të dhunës seksuale dhe/ose dhunës në familje. Në Kosovë ekzistojnë strehimore dhe institucione të veçanta për fëmijët pa përkujdesje prindërore. Megjithatë, këto nuk janë domosdoshmërisht të përshtatshme për viktimat e trafikimit ose viktimat e dhunës seksuale dhe/ose dhunës në familje që shpesh kanë nevoja për mbrojtje të specializuar, kujdes për traumën dhe shërbime sociale.

Në Kosovë, strehimoret e dhunës në familje nuk janë të përgatitura për të strehuar gratë apo fëmijët me aftësi të kufizuara, edhe pse ato kanë strehuar gra dhe fëmijë që janë të shurdhër ose memec. Strehimoret për dhunën në familje janë udhëzuar që të mos regjistrojnë fëmijët me aftësi të kufizuara në SIMDhF, por t'i referojnë ata në institucione dhe/ose organizata që janë të specializuara për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ta dokumentojnë këtë në SIMDhF. Nëse një strehimore do të ofronte shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara, transporti në qendrat burimore për fëmijët me aftësi të kufizuara është i pranueshëm.

Viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre që vijnë në strehimore shpesh referohen nga Policia e Kosovës. Pasi një strehimore e dhunës në familje hap rast për një person, ata regjistrohen në sistemin e regjistrimit të brendshëm të strehimores dhe në SIMDhF. Viktimat e trafikimit nuk regjistrohen kurrë si viktima trafikimi, por vetëm si viktima të mundshme të trafikimit ose viktima të dyshuara të dhunës seksuale.

Vite më parë, nuk kishte të dhëna për numrin e fëmijëve apo shërbimeve që u ofroheshin fëmijëve në strehimoret e dhunës në familje dhe SIMDhF-ja nuk kishte mundësi për të regjistruar fëmijët e viktimave të dhunës në familje. Përkundër kësaj, strehimoret ishin të hapura për fëmijët viktima të dhunës në familje dhe u ofronin atyre pako shërbimesh esenciale (p.sh. strehim, ushqim dhe veshje, qasje në arsim dhe shërbime të kujdesit ditor, detyra shtëpie dhe mbështetje për mësimin). Në vitin 2019, pas marrjes së kërkesës nga strehimoret e dhunës në familje, SIMDhF-ja u përditësua për të mbledhur dhe ofruar informacione për fëmijët në strehimore me nënat e tyre.

Për fëmijët që vijnë në strehimoret e dhunës në familje me nënat e tyre, zakonisht nuk ka kufi moshe për vajzat, por djemtë nuk mund të jenë më shumë se 12 vjeç, sipas praktikve ndërkombëtare. Ekzistojnë disa parakushte në regjistrimin e fëmijëve: 1) Pasi nëna dhe fëmijët e saj arrijnë në strehimore, ata regjistrohen (d.m.th., nëse nëna arrin me tre fëmijë, strehimorja i regjistron ata si katër persona). 2) Strehimret e dhunës në familje u udhëzuan që të mos regjistrojnë fëmijët si viktima të dhunës në familje, sepse autoritetet nuk donin të rrisnin numrin e viktimave të dhunës në familje. 3) Vetëm shërbimet e qasshme nga viktimat e dhunës në familje janë të regjistruara në SIMDhF; Shërbimet e ofruara për fëmijët në strehimore nuk janë të regjistruara në SIMDhF.

Strehimoret e dhunës në familje raportojnë gjithashtu për numrin e grave dhe fëmijëve në stre-

18 OSBE (2019). Strehimoret për viktimat e dhunës në familje në Kosovë. Misioni i OSBE-së në Kosovë: Prishtinë, Kosovë. Marrë më 23 tetor 2022 nga:Strehimore për viktimat e dhunës në familje në Kosovë | OSBE

himoret e tyre në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Kjo për shkak se strehimoret mbështeten financiarisht nga MFPT për t'u kujdesur për të mbijetuarit e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre, duke përfshirë rastet kur strehimorja i përgjigjet thirrjeve nga OJQ-të për të ofruar mbështetje dhe shërbime për viktimat e dhunës në familje.

Për shkak se SIMDhF është relativisht e re, institucionet ende janë në tranzicion të SIMDhF. Një nga sfidat me SIMDhF-në është se strehimoret nuk kanë qasje në informacione në lidhje me llojin e mbështetjes dhe shërbimeve që të mbijetuarat e dhunës në familje marrin nga zyrat e prokurorit ose nga mbrojtësit e viktimave në prokurori. Kjo mund të jetë sfiduese për strehimoret që janë përgjegjëse për menaxhimin e rasteve dhe për të siguruar që të mbijetuarit e dhunës në familje të kenë mbështetje ligjore dhe lloje të tjera të mbështetjes. Më shpesh, strehimoret e dhunës në familje informohen për rastet e dhunës në familje të atyre që banojnë në strehimoret e tyre. Për të qenë të suksesshëm në ofrimin e shërbimeve, strehimoret kërkojnë informacionin më të përditësuar të mundshëm për rastin e secilës viktimë.

Përveç regjistrimit të të mbijetuarve të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre në SIMDhF, strehimoret e dhunës në familje shpesh kanë sistemet e tyre të brendshme të menaxhimit të të dhënave ku regjistrojnë informacione për gratë dhe fëmijët që hyjnë në strehimoret e tyre. Këto sisteme të brendshme të menaxhimit të të dhënave përfshijnë dosjet e rasteve me informacion më të detajuar sesa disponon SIMDhF-ja (p.sh., llojet e dhunës dhe abuzimit të përjetuar, lëndimet e lidhura me dhunën, kujdesi shëndetësor dhe shërbimet e ofruara, urdhrat e kufizimit dhe mbrojtjes, dhe më shumë). Një strehimore raportoi se kishte nevojë të plotësonte dhjetë dosje të ndryshme për çdo të mbijetuar të dhunës në familje dhe fëmijët e tyre (p.sh. dosjen e pranimeve që përfshin emrin e agjencisë ose personit që referoi dhe/ose solli të mbijetuarit në strehimore, dhe të gjitha shërbimet që e mbijetuara ka nevojë dhe/ose i ka marrë).

Strehimoret e dhunës në familje zakonisht u caktojnë viktimave të dhunës në familje numër rasti i cili përdoret në të gjitha proceset e raportimit për të garantuar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e grave. Gratë që vijnë për herë të parë gjithmonë dallohen nga gratë që kanë qenë tashmë në strehimore. Në baza mujore, tremujore dhe vjetore, strehimoret e dhunës në familje raportojnë në MFPT numrin total të grave dhe fëmijëve në kujdesin e tyre. Këto të dhëna më pas regjistrohen në shabllon Excel (p.sh., numri i grave dhe fëmijëve, qyteti i origjinës dhe kush i solli) që ofrohet nga MFPT. Në të ardhmen, strehimoret e dhunës në familje duhet të jenë në gjendje ta fusin këtë informacion direkt në PIShS.

Sfidë kryesore me të cilën përballen strehimoret e dhunës në familje është se ato ende duhet të raportojnë veçmas nëpër ministri të ndryshme (p.sh. MD dhe MFPT). Aktualisht, nuk ka koordinim apo lidhje midis këtyre sistemeve të menaxhimit të të dhënave, madje edhe midis sistemeve të menaxhimit të të dhënave të MFPT-së. Përveç kësaj, strehimoret e dhunës në familje nuk mund të përdorin SIMDhF për të gjeneruar raporte rreth strehimorës së tyre. Strehimoret për dhunën në familje raportuan gjithashtu që ndonjeherë fëmijët që vijnë lindjet e tyre nuk janë regjistruar. Në këto raste, strehimoret kërkojnë shërbime shtesë mbështetëse për të siguruar që lindja e fëmijës të regjistrohet siç duhet dhe t'i jepet numër kombëtar identifikimi.

Për të përmirësuar SIMDhF-në, të dhënat duhet të jenë në dispozicion në nivel rajonal dhe kombëtar në mënyrë që ofruesit e shërbimeve në secilin prej rajoneve të kenë qasje në të dhëna më të sakta. Kjo përfshin numrin e të mbijetuarve të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre që kanë qasje në shërbime të mbrojtjes dhe mbështetjes, si dhe llojet e shërbimeve që u nevojiten dhe janë në gjendje të përdorin. Ofruesit e shërbimeve mund të mësojnë shumë nga SIMDhF-ja, duke përfshirë identifikimin se kush çfarë është duke bërë me të mbijetuarit e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre në nivel rajonal. Menaxherët e rasteve gjithashtu mund të monitorojnë rastet dhe të identifikojnë kur ofruesit e shërbimeve nuk arrijnë të menaxhojnë siç duhet viktimat e dhunës në familje, veçanërisht në nivel rajonal.

Përmirësimet në SIMDhF mund të sigurojnë ndryshim të rëndësishëm për strehimoret e dhunës në familje dhe jetën e atyre që i përdorin ato. Konsultimet me strehimoret e dhunës në familje nxorrën se përpjekjet për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave duhet të përfshijnë edhe ngritjen e kapacitete njerëzore dhe burimeve të përshtatshme për të menaxhuar SIMDhF dhe për të mbështetur të mbijetuarit e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre. Kjo kërkon trajnimin e duhur për ofruesit e shërbimeve të linjës së parë dhe agjencitë e shërbimeve sociale për të futur me saktësi të dhëna dhe informacion në SIMDhF. Kërkon gjithashtu burime njerëzore me aftësi për të monitoruar të dhënat SIMDhF për të siguruar saktësinë, rëndësinë dhe afatin e tyre.

# KONKLUZIONET

Gjetjet nga ky rishikim i të dhënave administrative dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe çështjeve të ndërlidhura me mbrojtjen e fëmijëve nxorrën në pah se të dhënat janë të fragmentuara nëpër dhe brenda ministrive dhe sektorëve të Kosovës. Të dhënat priren të fshihen pjesërisht sepse institucionet qeveritare zhvilluan sisteme të menaxhimit të pavarura nga njëra-tjetra. Megjithatë, u vërejt se kanalet për ndarjen e të dhënave nuk ishin funksionale nëpër ministri dhe sektorë, duke kufizuar aftësinë e shërbimeve arsimore, sociale dhe familjare për të ofruar shërbime të integruara dhe të koordinuara të kërkuara nga fëmijët me aftësi të kufizuara dhe që kanë nevojë për mbrojtje. Aftësia për të monitoruar rastet dhe krimet kundër dhe që përfshijnë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në nevojë për mbrojtje është gjithashtu e kufizuar.

Një sërë faktorësh ndikojnë në rëndësinë, saktësinë dhe afatin kohor të të dhënave administrative të Kosovës në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve. Rrjedha e të dhënave është sfidë në shumicën e ministrive/agjencive, sepse ato priren të kenë sisteme të dyfishta të menaxhimit të të dhënave që përfshijnë sisteme të mbajtjes së të dhënave të bazuara në letër (p.sh., regjistrat, librat dhe dosjet e rasteve) dhe sisteme të menaxhimit të të dhënave të bazuara në kompjuter që mbledhin informacion të kufizuar dhe të grumbulluar. Transferimi i të dhënave nga sistemet e menaxhimit të të dhënave të bazuara në letër në sistemet e menaxhimit të të dhënave të bazuara në kompjuter kërkon kohë dhe është e lodhshme, ku shpesh bëhet me dorë, gjë që kontribuon në mundësi të larta gabimi dhe boshllëqe të konsiderueshme të të dhënave. Fuqizimi i sistemeve të menaxhimit të të dhënave dhe sigurimi i të dhënave më të mira në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve shpesh ka rezultuar në module të reja ose shtesa në sistemet ekzistuese të menaxhimit të të dhënave. Megjithatë, kjo ka shkaktuar fragmentim të mëtejshëm të sistemeve të menaxhimit të të dhënave. Zbutja e kësaj situate do të kërkonte sisteme më gjithëpërfshirëse të menaxhimit të të dhënave që integrojnë plotësisht masat dhe fushat shtesë të të dhënave.

SMIA, për shembull, është një nga burimet kryesore të të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara me qasje në arsim. Por SMIA nuk arrin të mbledhë me saktësi të dhënat përkatëse në mjediset arsimore, duke përfshirë shkollat e rregullta, shkollat speciale dhe qendrat burimore. Çështjet që e ndikojnë integrimin e plotë të  të dhënave përfshijnë:

- Mungesa e njohurive nga edukatorët që janë përgjegjës për futjen e të dhënave në SMIA për përkufizimet dhe kategorizimet e aftësisë së kufizuar për fëmijët. Kjo çon në raportime të pasakta për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe llojet e aftësive të kufizuara.
- Problemet në SMIA lidhen me mënyrën se si raportohet aftësita e kufizuara dhe mospërputhjet midis 'një lloj aftësie të kufizuar ose 'aftësive të kufizuara të shumëfishta' pa kuptuar qartë aftësitë e kufizuara të shumëfishta.
- Mungesën e një fushe për të vërtetuar nëse aftësia e kufizuar është verifikuar/certifikuar nga ekipet e vlerësimit ose autoritetet përkatëse.
- Mungesën e një fushe për të raportuar për llojin e shërbimeve të veçanta që u ofrohen fëmijëve me aftësi të kufizuara në mjediset arsimore.
- Shkollat speciale dhe qendrat burimore për fëmijët me aftësi të kufizuara që përdorin 'Librat e Protokollit' dhe të njëjtin sistem SMIA si shkollat e rregullta, të cilat të dyja nuk arrijnë të kapin të dhënat përkatëse për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në përgjithësi, të dhënat janë po aq të mira sa metodat e grumbullimit, të dhënat hyrse (inputi) dhe metodologjia validuese që përdoren. Përpjekjet për dixhitalizimin e sistemeve të menaxhimit të të dhënave kanë qenë të ngadalta dhe sfiduese, siç dëshmohet nga përpjekjet për të zhvilluar SWIS, IPSS dhe SMIL. Menaxhimi i të dhënave ndërlikohet më tej kur ata që janë përgjegjës për futjen e informatave  në sistemet e digjitalizaura  të menaxhimit të të dhënave kanë probleme me lidhjen me internetin. Kjo çështje ishte veçanërisht e theksuar në shkollat që fusin të dhënat e nxënësve në

SMIA. Për më tepër, mungesa e udhëzimeve, trajnimeve dhe manualeve në dispozicion për stafin për të futur siç duhet të dhënat dhe informacionin në sistemet e menaxhimit të të dhënave nëpër ministri/agjenci dhe sektorë çon në rritjen e rreziqeve të gabimeve dhe boshllëqeve të të dhënave.

Përpilimi dhe vlefshmëria e të dhënave janë sfiduese në ministri/agjenci, pjesërisht për shkak se atyre u mungon personeli me ekspertizë në sistemet e menaxhimit të të dhënave administrative. Nga ky rishikim, ishte e paqartë se si dhe nëse të dhënat administrative vërtetohen nga ministritë / agjencitë që mbledhin të dhëna të tilla. Përveç kësaj, me numër të vogël të stafit me aftësi në analizën e të dhënave, ministritë /agjencitë nuk janë në gjendje të monitorojnë dhe vlerësojnë sistemet e tyre administrative të menaxhimit të të dhënave, duke përfshirë vlerësimin nëse të dhënat në sisteme të tilla janë relevante, të sakta dhe në kohë (shih Kornizën 3). Është gjithashtu e vështirë të analizohen të dhënat në mënyra që janë kuptimplote për politikat dhe vendimmarrjen që mund të ndikojnë pozitivisht tek fëmijët me aftësi të kufizuara dhe në çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve.

Shumë shpesh, analiza e të dhënave është e kufizuar në numra të papërpunuar, totale dhe përqindje (në disa raste të llogaritura me dorë) me ndarje të kufizuar në gjini, moshë, etni dhe rajon dhe/ose komunë. Gjithashtu, ka analizë të kufizuar për të kuptuar të marrëdhëniet ndërmjet variablave (p.sh. gjinia dhe mosha e fëmijës, lloji i aftësisë së kufizuar dhe qasja në arsim dhe shërbime).

Nuk ishte e qartë se si ministritë ose ofruesit e shërbimeve përdorin të dhënat administrative për të gjurmuar trendet për fëmijët me aftësi të kufizuara ose çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve. As nuk ishte e qartë se si përdoren të dhënat administrative në nivel kombëtar dhe komunal për planifikimin ose vendimmarrjen, formulimin e politikave, zhvillimin e programeve dhe intervenimeve, si dhe buxhetimin dhe alokimin e burimeve.

Gjatë dekadës së kaluar, donatorët dhe ministritë kanë bërë investime të konsiderueshme në digjitalizimin dhe fuqizimin e sistemeve administrative të të dhënave. Megjithatë, kalimi nga sistemet e mbajtjes së të dhënave të bazuara në letër në sistemet e menaxhimit të të dhënave dixhitale ka qenë i ngadaltë. Përderisa ka potencial të madh për të fuqizuar të dhënat administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve, institucionet e Kosovës duhet të bëjnë gjithçka që munden për të përballuar këto sfida urgjente dhe të angazhohen për këto ndryshime shumë të nevojshme.

**Korniza 3. Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit të të dhënave administrative**

Për të siguruar që të dhënat cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve të dhënat duhet të jenë në dispozicion, sistemet duhet të jenë të sakta, të besueshme dhe në kohë.

Zhvillimi i një plani për të monitoruar dhe vlerësuar rregullisht përdorimin dhe funksionin e sistemeve administrative të të dhënave është një detyrë kritike e Grupit Teknik të Punës Ndër-Agjenciore.

Pyetjet kryesore që duhet të marrin përgjigje përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- Çfarë do të monitorohet dhe vlerësohet?
- Si do të bëhet monitorimi dhe vlerësimi?
- Sa shpesh do të bëhet?
- Kush do ta zbatojë monitorimin dhe vlerësimin?
- Si do të shpërndahen rezultatet e vlerësimit?
- Si do të veprohet dhe do të trajtohen rezultatet e vlerësimit dhe rekomandimet?

# REKOMANDIME

Rekomandimet në vijim bazohen në gjetjet dhe konkluzionet e paraqitura në këtë raport dhe në diskutimet me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë dhe Grupin e Referencës. Rekomandimet bazohen gjithashtu në praktikat e mira të identifikuara në rishikimet dhe vlerësimet e sistemeve të të dhënave administrative nga vende të tjera, dhe dokumente udhëzuese praktike dhe strategjike që synojnë të fuqizojnë të dhënat administrative për fëmijët.[19] Rekomandimet e përgjithshme që ndërlidhen me ministritë/agjencitë dhe sektorët, dhe rekomandimet specifike të rëndësishme për ministritë/agjencitë dhe sektorët e veçantë janë theksuar në mënyrë specifike.

Palët kryesore të interesit në Kosovë duhet së bashku të rishikojnë dhe t'i japin prioritet rekomandimeve dhe të diskutojnë se si ato lidhen me ministritë/agjencitë e tyre. Palët kryesore të interesit duhet gjithashtu të planifikojnë mënyrat për të investuar në fuqizimin e sistemeve të të dhënave administrative, duke përfshirë aftësinë e tyre për të marrë të dhëna përkatëse, të sakta dhe në kohë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve. Hap i menjëhershëm mund të jetë zhvillimi i planeve shumëvjeçare të veprimit specifike për ministrinë/agjencinë **që fuqizojnë sistemet administrative të të dhënave,** duke përfshirë, por pa u kufizuar në mbledhjen e të dhënave; analizën e të dhënave; vizualizimin, shpërndarjen dhe përdorimin e të dhënave; dhe ndarjen e të dhënave.

## Koordinimi për Fuqiaimin e Sistemeve Administrative të të Dhënave

1. **Në kuadër të përgjegjësive të Këshillit për të Drejtat e Fëmijës, të fuqizohet koordinimi rreth të dhënave për fëmijë, me fokus të veçantë tek fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve.** Diçka e tillë do të kërkojë qasje dhe reagim ndërinstitucional që synon fuqizimin e koordinimit dhe të kuptuarit e treguesve kombëtarë dhe rajonalë që lidhen me fëmijët dhe përafrimin me qëllimet dhe prioritetet kombëtare për të drejtat e fëmijëve. Rishikimi i udhëzimeve të ofruara nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën mund të ndihmojë në përmirësimin e disponueshmërisë, cilësisë dhe krahasueshmërisë së statistikave për fëmijët, siç është avancuar nga Konferenca për Statisticienët Evropianë. Botuar në vitin 2022, *Statistikat për Fëmijët: Vëmendje për fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës, në kujdesin alternativ dhe me aftësi të kufizuara*[20] trajton burimet e të dhënave, boshllëqet e të dhënave dhe sfidat që lidhen me të dhënat për dhunën ndaj fëmijëve, fëmijëve në kujdesin alternativ dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ky dokument ofron udhëzime dhe rekomandime përkatëse për zyrën kombëtare të statistikave dhe sugjeron punë të mëtejshme që mund të ndërmerren në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar për të përmirësuar statistikat për fëmijët dhe të rinjtë.[21] Këshillit për të Drejtat e Fëmijës do të përfitonte nga trajnime shtesë për ngritjen e kapaciteteve në lidhje me statistikat dhe fëmijët. Përveç kësaj, përgjegjësi dhe detyra specifike i janë dhënë Komitetit Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës dhe Këshillit për të Drejtat e Fëmijës për të zhvilluar kornizën kombëtare të politikave, për të siguruar koordinim ndërministror dhe ndërsektorial për të dhënat administrative për fëmijët, dhe për t'u ofruar udhëzime për mbledhjen, ndarjen, analizën, shpërndarjen dhe përdorimin e të dhënave. (Menjëherë)

2. **Facilitimi i grupeve të punës ose konsultimeve me drejtorët e qendrave burimore dhe shkollave speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara.** Identifikimi i rekomandimeve domethënëse dhe relevante që MASHTI dhe MFPT mund të përdorin për të fuqizuar sistemet e menaxhimit të të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara në qendrat burimore, shkollat speciale dhe shkollat e rregullta. Rritja e kapacitetit të MASHTI-t, MFPT-së dhe qendrave burimore, shkollave speciale dhe shkollave të rregullta për të mbledhur të dhëna administra-

19 Haarr, RN (2018). Një udhëzues praktik për forcimin e të dhënave administrative mbi dhunën ndaj fëmijëve. UNICEF;

20 Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (2022). Statistikat për Fëmijët: Në qendër të vëmendjes fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës, në përkujdesje alternative dhe me aftësi të kufizuara. UNECE: Gjenevë, Zvicër.

21 Po aty, 2022.

tive domethënëse dhe përkatëse për fëmijët me aftësi të kufizuara në të gjithë mjediset, duke përfshirë shkollat dhe qendrat burimore (d.m.th., të dhënat e nevojshme për të raportuar mbi treguesit kombëtarë, rajonalë dhe globalë). (Menjëherë)

3. **Mbështetje Ministrisë së Shëndetësisë për të zhvilluar modul specifik në SISH për punonjësit e shëndetësisë për të monitoruar zhvillimin në fëmijërinë e hershme,, për të dokumentuar vonesat në zhvillim dhe aftësitë e kufizuara të fëmijëve dhe për të bërë referime tek specialistët për testim, diagnostikim, trajtim dhe ndërhyrje të hershme.** Kjo do të siguronte qasje në instrumente të lehta për përdoruesit për të monitoruar, gjurmuar dhe dokumentuar progresin për çdo fëmijë. Një modul i tillë mund të mbështesë gjithashtu identifikimin e hershëm të abuzimit dhe neglizhencës së fëmijëve dhe të gjurmojë referimet në shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë shërbimet sociale dhe familjare. (Afatgjatë)

### Të zhvillohen standarde/udhëzime për të dhënat administrative

4. **Të rishikohen dhe fuqizohen standarde/udhëzime kombëtare specifike për sektorët në lidhje me mbledhjen e të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje.** Kjo do të synojë të përmirësojë standardet/udhëzimet kombëtare dhe të sigurojë që të dhënat për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje dhe fëmijët në lëvizje të mblidhen, regjistrohen, përpilohen, analizohen dhe shpërndahen nga institucionet përkatëse. Standardet/udhëzimet kombëtare duhet të përputhen me standardet/udhëzimet ndërkombëtare për të gjeneruar të dhëna cilësore, të besueshme dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht. Këto udhëzime mund të përdoren gjithashtu për ta monitoruar progresin drejt OZhQ-ve dhe për ta informuar vendimmarrjen dhe formulimin e politikave. Këtu përfshihen standardet/udhëzimet rajonale të përcaktuara nga UNICEF-i për të raportuar mbi treguesit që janë pjesë e databazës së Monitorimi transformues për barazi të avansuar (TransMonEE), që lidhen me çështjet sociale dhe ekonomike dhe që janë me rëndësi për situatën dhe mirëqenien e fëmijëve, të rinjve dhe grave. Gjithashtu duhet të kryhet një rishikim i rekomandimeve apo udhëzimeve të ofruara nga Zyra e BE-së në Kosovë në lidhje me fuqizimin e të dhënave administrative, veçanërisht të dhënave që kanë të bëjnë me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve. Kjo vepër është pjesë e një projekti më madhor që ka Zyra e UNICEF-it në Kosovë me Zyrën e BE-së në Kosovë për të mbështetur fëmijët nga komunitetet e margjinalizuara. (Menjëherë)

5. **Të mbështeten institucionet përkatëse të Kosovës për të zhvilluar standarde/udhëzime për analizimin dhe përdorimin e të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë të dhënat rreth shpenzimeve financiare, për të monitoruar modelet dhe trendet dhe për të marrë vendime të bazuara në dëshmi.** Rezultati i pritshëm është që institucionet relevante të Kosovës të jenë më të afta t'i përdorin të dhënat administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë të dhënat rreth shpenzimeve financiare (p.sh., shpenzimet që lidhen me skemat e personave me aftësi të kufizuara, mbështetjen materiale dhe ofrimin e shërbimeve sociale) për t'i monitoruar modelet dhe trendet dhe për të marrë vendime të bazuara në dëshmi për ta përmirësuar mbrojtjen e fëmijëve. (Afatmesme)

### Ngritja e kapaciteteve për të përmirësuar mbledhjen dhe analizën e të dhënave

6. **Të realizohet ngritja e kapaciteteve për të gjithë ofruesit e shërbimeve nga institucionet përkatëse për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave administrative për fëmijët, veçanërisht fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve.** Fuqizimi i rolit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës në lidhje me koordinimin dhe raportimin për treguesit në lidhje me fëmijët është gjithashtu kyç. Si rezultat, ofruesit e shërbimeve në institucionet e Kosovës do të kenë kapacitete të ngritura për t'i koordinuar dhe kuptuar kërkesat për treguesit kombëtarë

në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve. Për shembull, të gjithë punëtorët socialë dhe ofruesit e shërbimeve përgjegjës për futjen e të dhënave në SIMS dhe PIShS do të dinë se si të futin siç duhet të dhënat në këto sisteme dhe ta përdorin PIShS-në për menaxhimin e rasteve. Ata gjithashtu do ta kuptojnë rëndësinë e të dhënave administrative për fëmijët, veçanërisht fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve, për të raportuar mbi treguesit kombëtarë, rajonalë dhe globalë. (Menjëherë)

7. **Ngritja e kapaciteteve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për qasje efikase dhe të automatizuara, dhe konsolidim të dhënave të institucioneve përkatëse dhe analiza e treguesve relevantë në lidhje me fëmijët.** Kjo do të fokusohet shumë në treguesit që lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara, mbrojtjen e fëmijëve dhe drejtësinë për fëmijët, së bashku me praktikat e mira për raportimin e të dhënave, duke përfshirë vizualizimin, interpretimin dhe publikimin e të dhënave. Kjo do të ngritë kapacitetin e ASK-së për të kryer analizën e të dhënave; gjenerojnë statistika për treguesit; për të pasur njohuri për vizualizimin, interpretimin dhe publikimet e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara, mbrojtjen e fëmijëve, drejtësinë për fëmijët; dhe për të kuptuar praktikat e mira për raportimin e të dhënave administrative. (Menjëherë))

### Ngritja e kapaciteteve për të forcuar përdorimin e të dhënave

8. **Të ngriten kapacitetet e përdoruesve të të dhënave administrative, duke përfshirë vendimmarrësit dhe politikëbërësit, për të siguruar që përdoruesit ta kuptojnë se si t'i interpretojnë dhe përdorin me saktësi të dhënat administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve.** Rezultati i pritshëm është se përdoruesit e të dhënave administrative kanë përmirësuar njohuritë dhe aftësitë për të marrë vendime të bazuara në dëshmi për programet, politikat dhe shpërndarjen e burimeve. (Afatmesme)

### Të zhvillohen grupe minimale të të dhënave dhe ndarje

9. **Të sigurohet që të dhënat e SIMS-it janë të ndara sipas moshës së fëmijës në vite (jo bazuar vetëm në datëlindjen dhe vitin) dhe që shpenzimet financiare që lidhen me mbështetjen materiale dhe shërbimet sociale të ofruara për fëmijët e moshës 0-17 vjeç mund të nxirren dhe analizohen lehtësisht.** Rezultati i pritshëm është se MFPT-ja është në gjendje të përdorë të dhënat e SIMS-it për të kryer një rishikim dhe analizë të duhur të shpenzimeve të sektorit social në lidhje me mbështetjen materiale (p.sh. skemat e pagesave për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe transferet në para për lloje të tjera të mbështetjes materiale të ofruara). Kjo do të lejonte gjithashtu llojet e mëparshme të shërbimeve sociale për fëmijët e moshës 0-17 vjeç dhe shpenzimet e sektorit social për fëmijët do të analizohen dhe rishikohen, me fokus të veçantë në shpenzimet për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje. (Menjëherë)

10. **Të rishikohet dhe përmirësohet mbledhja e të dhënave administrative të SIMDhF-së për fëmijët viktima dhe/ose dëshmitarë të dhunës në familje.** Të kuptohet se kush merr mbrojtje dhe shërbime mbështetëse, duke përfshirë strehimin, për të siguruar që të dhënat mund të ndahen në përputhje me grupin minimal të të dhënave (shih Kornizën 4). Kjo do të ndihmonte në përmirësimin e ndarjes së të dhënave në lidhje me fëmijët që janë viktima dhe/ose dëshmitarë të dhunës në familje, dhe do të siguronte që ata të marrin mbrojtje dhe shërbime mbështetëse, duke përfshirë strehimin. Gjithashtu mund të përmirësojë ndjeshëm analizën dhe raportimin e të dhënave për krimet kundër fëmijëve dhe fëmijëve viktima të dhunës në familje. Sigurimi që të dhënat ndahen në mënyra që janë domethënëse dhe të rëndësishme për palët kryesore të interesit dhe përdoruesit e të dhënave dhe që të dhënat mund të nxirren dhe analizohen lehtësisht nga SIMDhF-së janë rezultate shtesë. (Menjëherë)

**Korniza 4. Grupi minimal i të dhënave për dhunën në familje ndaj fëmijëve**

- Lloji i dhunës
- Lëndimet e lidhura me dhunën
- Lloji i armëve të përfshira
- Data kur ka ndodhur dhuna e raportuar
- Informacionet rreth fëmijës viktimë (p.sh. gjinia, mosha, vendbanimi)
- Informacionet rreth dhunuesit (p.sh., gjinia dhe grupmosha siç raportohet nga fëmija; nëse policia ose streha ka kontakt me dhunuesin; gjinia dhe mosha aktuale e dhunuesit)
- Marrëdhënia viktimë- dhunues
- Regjistrimi (p.sh. data e regjistrimit të dhunës, subjekti/personi regjistrues dhe sektori i tyre)
- Referenca gjeografike (p.sh., ku ka ndodhur dhuna)
- Vendndodhja e ngjarjes (p.sh. shtëpi, shkollë, punë, hapësirë publike)
- Shërbimet e ofruara për fëmijën

11. **Të rishikohet dhe forcohet SMIL-i për të siguruar që ekziston një grup minimal i të dhënave për krimet kundër fëmijëve dhe të zhvillohet një modul në SMIL për të mbledhur të dhëna për fëmijët viktima të dhunës/krimeve që marrin mbrojtje ligjore dhe/ose mbështetje psikologjike në procedurat gjyqësore.** Kjo do të rezultonte në të dhëna lehtësisht të disponueshme për fëmijët viktima dhe krimet kundër fëmijëve, të cilat mund të nxirren dhe analizohen nga SMIL-i (shih Kutinë 5). Gjithashtu do t'u sigurojë gjykatave një modul për të dokumentuar dhe mbledhur të dhëna për fëmijët viktima të dhunës/krimeve që marrin mbështetje në procedurat penale, civile dhe administrative ligjore/gjyqësore sipas gjinisë, moshës dhe llojit të viktimizimit. (Afatgjatë)

**Korniza 5. Grupi minimal i të dhënave për krimet kundër fëmijëve**

- Klasifikimi i krimeve ndaj fëmijëve
- Lëndimet e lidhura me dhunën
- Lloji i armëve të përfshira
- Data kur ka ndodhur dhuna e raportuar
- Informacionet rreth fëmijës viktimë (p.sh. gjinia, mosha, vendbanimi)
- Informacionet rreth dhunuesit (p.sh., gjinia dhe grupmosha siç raportohet nga fëmija; nëse policia ka kontakt me dhunuesin; gjinia dhe mosha aktuale e dhunuesit).
- Marrëdhënia viktimë- dhunues
- Regjistrimi (p.sh. data e regjistrimit të dhunës, subjekti/personi regjistrues dhe sektori i tyre)
- Referenca gjeografike (p.sh., ku ka ndodhur dhuna)
- Vendndodhja e ngjarjes (p.sh. shtëpi, shkollë, punë, hapësirë publike)

## Të zhvillohen Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Ndarjen e të Dhënave

12. **Grupi Punues Teknik Ndërinstitucional për të Dhënat për Fëmijët duhet të zhvillojë procedura standarde të veprimit që përshkruajnë qartë hapat për kërkesat për të dhëna dhe ndarjen e të dhënave (ndërmjet ASK-së dhe institucioneve relevante), si dhe afate kohore për raportimin dhe shpërndarjen e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve.** Institucionet relevante të Kosovës do të kenë gjithashtu PSV të qarta për shkëmbimin e të dhënave me ASK-në për të siguruar që ASK-ja është në gjendje t'i përdorë të dhënat për të raportuar mbi treguesit që kanë të bëjnë me fëmijët. (Menjëherë)

## Të fuqizohet rëndësia, saktësia dhe afati kohor i të dhënave

13. **Të zhvillohen procese për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e rëndësisë, saktësisë dhe afatit kohor të të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e fëmijëve në institucionet relevante në Kosovë.** Përpjekjet për të prodhuar statistika cilësore lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çështjet në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve kërkojnë përkushtim, angazhim dhe mbështetje aktive nga organizatat ndërkombëtare, partnerët financiarë globalë, agjencitë kombëtare statistikore, ministritë/agjencitë e Kosovës dhe ofruesit

e shërbimeve të organizatave të shoqërisë civile, ndër të tjera.[22] Kjo mund arrihet duke zbatuar praktikat më të mira për prodhimin e statistikave cilësore, duke përfshirë Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane, të miratuar për herë të parë nga Komiteti Evropian i Sistemit Statistikor në vitin 2005. Rishikimi i vitit 2017 i këtij Kodi të Praktikës përbëhet nga 16 parime kyçe që drejtojnë prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare evropiane dhe ofron një mjedis standard institucional brenda të cilit funksionojnë autoritetet statistikore kombëtare dhe evropiane.[23] 16 parimet përfshijnë pesë parime që lidhen me outputet statistikore – rëndësinë, saktësinë dhe besueshmërinë; afatin kohor dhe përpikmërinë; koherencën dhe krahasueshmërinë; dhe qasshmërinë dhe qartësinë.[24]

Në vitin 2019, Sistemi Statistikor Evropian prezantoi gjithashtu një version të përmirësuar dhe të rishikuar të Kornizës për Sigurimin e Cilësisë (KSC), i cili ofron udhëzime plotësuese për mënyrën e zbatimit të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.[25] KSC-ja përfaqëson një koleksion metodash, mjetesh dhe praktikash të mira që sugjerohen për përdorim nga autoritetet statistikore për të përmirësuar zbatimin e treguesve duke ekzaminuar mjedisin institucional, proceset statistikore dhe outputet.[26] Si Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane, ashtu edhe KSC-ja shërbejnë si modele për organizatat për të zhvilluar mjetet e tyre, duke përfshirë kornizat e vlerësimit, dhe për të vendosur standarde për përmirësimin e sistemeve statistikore dhe prodhimit statistikor.

Në vitin 2019, Komisioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara miratoi Manualin për Statistikat Zyrtare të Kornizave Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë (KKSC-të e OKB-së) të Kombeve të Bashkuara dhe rekomandimet e tij. Manuali bazohet dhe zëvendëson modelin dhe udhëzimet më të përgjithshme të KKSC-së të OKB-së që u miratuan në vitin 2012. Më konkretisht, manuali ofron rekomandime dhe udhëzime në lidhje me sigurimin e cilësisë në kontekstin global[27] për përdorim nga vendet dhe Kornizat e Sigurimit të Cilësisë të Statistikave (KSCS-të e OKB-së) për përdorim nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara që prodhojnë statistika.[28]

Rezultati i pritur është që institucionet relevante të Kosovës të ndërmarrin hapa për të siguruar që të dhënat për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në nevojë për mbrojtje, duke përfshirë ata që përdorin shërbimet sociale dhe familjare, janë relevante, të sakta dhe në kohë (shih Kornizën 6), si dhe koherente, të krahasueshme dhe të arritshme. (Afatmesme)

| **Korniza 6. Rëndësia, saktësia dhe afati kohor i të dhënave** | |
|---|---|
| **Rëndësia e të dhënave** | ↘ Rëndësia e përmbajtjes dhe artikujve të të dhënave<br>↘ Rëndësia e të dhënave të ndara / zbërthyera<br>↘ Analiza e të dhënave paraqitet në mënyrë kuptueshme<br>↘ Aftësia për të përdorur të dhënat e mbledhura për vendimmarrje dhe alokimin e burimeve<br>↘ Aftësia për të përdorur të dhënat e mbledhura për zhvillimin e programeve dhe politikave |
| **Saktësia e të dhënave** | ↘ Përqindja e vlerave që mungojnë për secilën fushë të të dhënave<br>↘ Përqindja e gabimeve në të dhëna për shkak të gabimeve në kyçje ose kodim<br>↘ Fushat e të dhënave që më së shpeshti keqinterpretohen ose kanë gabime në kodim<br>↘ Problemet e njohura me nën-numërime ose mbi-numërime<br>↘ Hapat e ndërmarrë për të minimizuar gabimet në futjen/përpunimin të të dhënave |
| **Afati kohor i të dhënave** | ↘ Periudha kohore për të dhënat e disponueshme<br>↘ Koha e kaluar midis ndodhjes së incidentit dhe disponueshmërisë së të dhënave<br>↘ Mjetet e transferimit të të dhënave<br>↘ Sa shpesh të dhënat mblidhen dhe janë të disponueshme për analizë<br>↘ Sa shpesh të dhënat e analizuara vihen në dispozicion për shqyrtim dhe vendimmarrje |

22 Faktori i Cilësisë: Forcimi i të dhënave kombëtare për të monitoruar Objektivin 4 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (2017). Instituti i UNESCO-s për Statistika: Montreal, Quebec, Kanada, f. 25.
23 Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane: Për Autoritetet Kombëtare Statistikore dhe Eurostatin (autoriteti statistikor i BE-së). Miratuar nga Komiteti Evropian i Sistemit Statistikor, 18 Nëntor 2017. EUROSTAT. Marrë më 4 dhjetor 2022 nga: Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane | Insee
24 Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane: Për Autoritetet Kombëtare Statistikore dhe Eurostatin (autoriteti statistikor i BE-së). Miratuar nga Komiteti Evropian i Sistemit Statistikor, 18 Nëntor 2017. Sistemi Evropian Statistikor. Marrë më 4 dhjetor 2022 nga: Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane | Insee
25 Korniza e Sigurimit të Cilësisë së Sistemit Statistikor Evropian (Versioni 2.0). Sistemi i Statistikave Evropiane, 2019. Marrë më 4 dhjetor 2022 nga: ESS-QAF-V2.0-final.pdf (europa.eu)
26 Po aty, 2019.
27 Manuali i Kornizës Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë e Kombeve të Bashkuara për Statistikat Zyrtare: Përfshirë rekomandimet, kornizën dhe udhëzimet e zbatimit. Departamenti i OKB-së për Çështjet Ekonomike dhe Sociale, Divizioni i Statistikave, 2019. Marrë më 4 dhjetor 2022 nga: 1902216-UNNQAFManual-WEB.pdf
28 Instituti i Statistikave të UNESCO-s, 2017, f. 25.

# SHTOJCA A: TREGUESIT PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE TË MBROJTJES SË FËMIJËVE

| Lloji | Numri | Treguesi | Raportuar nga institucionet e Kosovës në baza të rregullta | Burimi kryesor i të dhënave | Zbërthimet ekzistuese | Numëruesi | Emëruesi | Propozimi për llogaritjen e treguesit | Institucioni përgjegjës për llogaritjen e këtij treguesi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **1** | **Fëmijët pa kujdes prindëror** | | | | | | | |
| N | 1.1 | Numri i fëmijëve (të moshës nga 0-17) pa përkujdesje prindërore | **Po** | Administrative data collected by MFLT, reported by KAS in 'Social Welfare Statistics, June 2022' | Gjinia, Komuna | | | | MFPT |
| N | 1.2 | Përqindja e fëmijëve në kujdesstari | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Ofruesi i të dhënave MFPT: Numri i fëmijëve në kujdestari gjatë vitit | Ofruesi i të dhënave MFPT: Numri i fëmijëve pa përkujdesje prindërore që janë marrë në përkujdesje formale gjatë vitit | Duke përdorur të dhënat administrative të numëruesit dhe emëruesit, ASK-ja mund ta llogarisë treguesin | MFPT |
| | **2** | **Fëmijët nën përkujdesje alternative** | | | | | | | |
| N | 2.1 | Numri i fëmijëve (0-17 vjeç) pa përkujdesje prindërore në përkujdesje alternative | **Po** | Të dhënat administrative të mbledhura nga MFPT, të raportuara nga ASK në 'Statistikat e Mirëqenies Sociale, Qershor 2022' | Gjinia Komuna | | | | MFPT |
| T | 2.2 | Shkalla e fëmijëve (të moshës nga 0-17) nën kujdesin alternativ formal në fund të vitit (për 100,000) | **Jo** | Për Numëruesin: Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT<br><br>Për emëruesin: Të dhënat e popullsisë bazuar në vlerësimet vjetore të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës | | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT: Numri i fëmijëve pa përkujdesje formale prindërore gjatë një viti | Të dhënat e popullsisë bazuar në vlerësimet vjetore të popullsisë nga ASK-ja: Popullsia totale nën 18 vjeç në vitin përkatës | Duke përdorur të dhënat administrative të numëruesit dhe emëruesit, ASK-ja mund ta llogarisë treguesin | MFPT |

| Lloji | Numri | Treguesi | Raportuar nga institucionet e Kosovës në baza të rregullta | Burimi kryesor i të dhënave | Zbërthimet ekzistuese | Numëruesi | Emëruesi | Propozimi për llogaritjen e treguesit | Institucioni përgjegjës për llogaritjen e këtij treguesi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **3** | **Fëmijët në përkujdesje rezidenciale** | | | | | | | |
| N | 3.1 | Përqindja e fëmijëve në përkujdesje rezidenciale | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Ofruesi i të dhënave MFPT: Numri i fëmijëve që jetojnë në përkujdesje rezidenciale gjatë vitit | Ofruesi i të dhënave MFPT: Numri i fëmijëve pa përkujdesje prindërore që janë marrë në përkujdesje formale gjatë vitit | Duke përdorur të dhënat administrative të numëruesit dhe emëruesit, ASK-ja mund ta llogarisë treguesin | MFPT |
| T | 3.2 | Shkalla e fëmijëve (të moshës nga 0-17) në kujdesin rezidencial formal në fund të vitit (për 1000) | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFLT | | Ofruesi i të dhënave MFPT: Numri i fëmijëve që jetojnë në përkujdesje rezidenciale gjatë vitit | Population data based on annual population estimates by the KAS: Total population under 18 years in the respective year, per 1,000 | Using the numerator and denominator administrative data, KAS can calculate the indicator | MFLT |
| T | 3.3 | Përqindja e fëmijëve (0-17 vjeç) me aftësi të kufizuara nën përkujdesje rezidenciale formale në fund të vitit | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Ofruesi i të dhënave MFPT: Numri i fëmijëve që jetojnë në përkujdesje rezidenciale gjatë vitit (të ndarë sipas aftësisë së kufizuar) | Ofruesi i të dhënave MFPT: Numri i fëmijëve që jetojnë në përkujdesje rezidenciale gjatë vitit | Të punohet me ekipin RO TransMonEE për llogaritjen e treguesve | MFLT |
| T | 3.4 | Numri i të rinjve (10-24 vjeç) nën përkujdesje rezidenciale formale në fund të vitit | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Ofruesi i të dhënave MFPT: Numri i fëmijëve pa kujdes prindëror që marrin kujdes formal gjatë vitit (të ndarë sipas moshës) | | Duke përdorur të dhënat administrative, MFPT-ja mund ta llogarisë dhe raportojë treguesin | |
| T | 3.5 | Shkalla e fëmijëve (0-17 vjeç) në përkujdesjen rezidenciale formale gjatë vitit (për 100,000) | **Jo** | | | | | MFPT-ja duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFLT |
| T | 3.6 | Përqindja e fëmijëve (0-17 vjeç) me aftësi të kufizuara në përkujdesjen rezidenciale formale gjatë vitit | **Jo** | | | | | MFPT duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFPT |
| T | 3.7 | Numri i fëmijëve (0-17 vjeç) që u larguan nga përkujdesja rezidenciale formale gjatë vitit, sipas destinacionit pas largimit nga përkujdesja/vdekja e fëmijës | **Jo** | | | | | MFPT-ja duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFPT |

| Lloji | Numri | Treguesi | Raportuar nga institucionet e Kosovës në baza të rregullta | Burimi kryesor i të dhënave | Zbërthimet ekzistuese | Numëruesi | Emëruesi | Propozimi për llogaritjen e treguesit | Institucioni përgjegjës për llogaritjen e këtij treguesi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T | 3.8 | Përqindja e fëmijëve (0-17 vjeç) me aftësi të kufizuara që u larguan nga përkujdesja formale rezidenciale gjatë vitit | **Jo** | | | | | MFPT-ja duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFPT |
| T | 3.9 | Përqindja e fëmijëve (0-17 vjeç) në përkujdesje rezidenciale formale nga totali i numrit të fëmijëve në përkujdesje alternative formale në fund të vitit | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Ofruesi i të dhënave MFLT: Numri i fëmijëve pa përkujdesje formale prindërore gjatë vitit | Ofruesi i të dhënave MFPT: Numri i fëmijëve pa kujdes prindëror që marrin kujdes formal gjatë vitit | Duke përdorur të dhënat administrative të numëruesit dhe emëruesit, MFPT-ja mund ta llogarisë dhe raportojë treguesin | MFPT |
| | 4 | Fëmijët në përkujdesje familjare | | | | | | | |
| N | 4.1 | Përqindja e fëmijëve (të moshës nga 0-17 vjeç) në strehim farefisnor | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Ofruesi i të dhënave MFPT: Numri i fëmijëve në strehim familjar gjatë vitit | Ofruesi i të dhënave MFPT: Numri i fëmijëve pa përkujdesje prindërore që janë marrë në përkujdesje formale gjatë vitit | Duke përdorur të dhënat administrative të numëruesit dhe emëruesit, MFPT-ja mund ta llogarisë dhe raportojë treguesin | MFPT |
| N | 4.2 | Përqindja e fëmijëve (të moshës nga 0-17 vjeç) në strehim familjar jashtë familjes biologjike | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Ofruesi i të dhënave MFPT: Numri i fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes biologjike gjatë vitit | Ofruesi i të dhënave MFPT: Numri i fëmijëve pa përkujdesje prindërore që janë marrë në përkujdesje formale gjatë vitit | Duke përdorur të dhënat administrative të numëruesit dhe emëruesit, MFPT-ja mund ta llogarisë dhe raportojë treguesin | MFPT |
| T | 4.3 | Shkalla e fëmijëve (të moshës nga 0-17 vjeç) në kujdesin formal të bazuar në familje në fund të vitit (për 100,000) | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Ofruesi i të dhënave MFPT: Shuma e: Numrit të fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes biologjike gjatë vitit dhe numrit të fëmijëve në strehim familjar me lidhje farefisnore gjatë vitit | Të dhënat e popullsisë bazuar në vlerësimet vjetore të popullsisë nga ASK-ja: Popullsia totale nën 18 vjeç në vitin përkatës, për 100,000 | Duke përdorur të dhënat administrative të numëruesit dhe emëruesit, ASK-ja mund ta llogarisë treguesin | MFPT |
| T | 4.4 | Përqindja  e fëmijëve (të moshës nga 0–17 vjeç) në kujdesin formal të bazuar në familje në fund të vitit (për 100,00) | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Ofruesi i të dhënave MFPT: SHUMA e: Numrit të fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes biologjike gjatë një viti dhe numrit të fëmijëve në strehim familjar me lidhje farefisnore gjatë vitit | Të dhënat e popullsisë bazuar në vlerësimet vjetore të popullsisë nga ASK-ja: Popullsia totale nën 18 vjeç në vitin përkatës, për 100,000 | Duke përdorur të dhënat administrative të numëruesit dhe emëruesit, MFPT-ja mund ta llogarisë dhe raportojë treguesin | MFLT |

| Lloji | Numri | Treguesi | Raportuar nga institucionet e Kosovës në baza të rregullta | Burimi kryesor i të dhënave | Zbërthimet ekzistuese | Numëruesi | Emëruesi | Propozimi për llogaritjen e treguesit | Institucioni përgjegjës për llogaritjen e këtij treguesi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T | 4.5 | Përqindja e fëmijëve (të moshës nga 0–17 vjeç) në kujdesin formal farefisnor, nga numri i përgjithshëm i fëmijëve në kujdesin formal të bazuar në familje në fund të vitit | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Ofruesi i të dhënave MFPT për: Numrin e fëmijëve në strehim familjar me lidhje farefisnore gjatë vitit | Data provider MFLT: SUM of: Number of children in foster care outside the biological family during the year and number of children in foster care with kinship ties during the year | Using the numerator and denominator administrative data, MFLT can calculate and report the indicator | MFLT |
| T | 4.6 | Përqindja e fëmijëve (të moshës 0–17 vjeç) në forma të tjera të kujdesit formal të bazuar në familje ndaj numrit të përgjithshëm të fëmijëve në kujdesin formal të bazuar në familje në fund të vitit | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Ofruesi i të dhënave MFPT: SHUMA e: Numrit të fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes biologjike gjatë vitit | Data provider MFLT: SUM of: Number of children in foster care outside the biological family during the year and number of children in foster care with kinship ties during the year | Using the numerator and denominator administrative data, MFLT can calculate and report the indicator | n/a |
| T | 4.7 | Përqindja e fëmijëve (të moshës nga 0-17 vjeç) me aftësi të kufizuara në kujdesin formal të bazuar në familje në fund të vitit | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Ofruesi i të dhënave MFPT: SHUMA e: Numrit të fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes biologjike gjatë vitit (të ndarë sipas aftësisë së kufizuar) dhe numrit të fëmijëve në strehim familjar me lidhje farefisnore gjatë vitit (të ndarë sipas aftësisë së kufizuar) | Ofruesi i të dhënave MFPT: SHUMA e: Numrit të fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes biologjike gjatë vitit dhe numrit të fëmijëve në strehim familjar me lidhje farefisnore gjatë vitit | Using the numerator and denominator administrative data, MFLT can calculate and report the indicator | MFLT |
| T | 4.8 | Numri i të rinjve (të moshës nga 10 -24 vjeç) në përkujdesje formale me bazë familjare në fund të vitit | Jo | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Ofruesi i të dhënave MFPT: SHUMA e: Numrit të fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes biologjike gjatë vitit (të ndarë sipas grupmoshës) dhe numrit të fëmijëve në strehim familjar me lidhje farefisnore gjatë vitit (të ndarë sipas grupmoshës) | | Duke përdorur të dhënat administrative, MFPT-ja mund ta llogarisë dhe raportojë treguesin | MFLT |

| Lloji | Numri | Treguesi | Raportuar nga institucionet e Kosovës në baza të rregullta | Burimi kryesor i të dhënave | Zbërthimet ekzistuese | Numëruesi | Emëruesi | Propozimi për llogaritjen e treguesit | Institucioni përgjegjës për llogaritjen e këtij treguesi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T | 4.9 | Shkalla e fëmijëve (të moshës nga 0-17 vjeç) që iu nënshtruan kujdesit formal të bazuar në familje gjatë vitit (për 100,000) | **Jo** | | | | | MFPT duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFPT |
| T | 4.10 | Përqindja e fëmijëve (të moshës nga 0–17 vjeç) në strehim familjar formal gjatë vitit | **Jo** | | | | | MFPT duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFPT |
| T | 4.11 | Numri i fëmijëve (të moshës nga 0–17 vjeç) në strehimit familjar formal gjatë vitit | **Jo** | | | | | MFPT duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFPT |
| T | 4.12 | Numri i fëmijëve (të moshës nga 0–17 vjeç) në kujdesin farefisnor formal gjatë vitit | **Jo** | | | | | MFPT duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFPT |
| T | 4.13 | Numri i fëmijëve (të moshës nga 0–17 vjeç) në format tjera të kujdesit formal të bazuar në familje gjatë vitit | **Jo** | | | | | MFPT duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFPT |
| T | 4.14 | Numri i fëmijëve (të moshës nga 0–17 vjeç) që lanë kujdesin formal të bazuar në familje gjatë vitit, sipas destinacionit pas largimit nga kujdesi/vdekja e një fëmije | **Jo** | | | | | MFPT duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFPT |
| T | 4.15 | Përqindja e fëmijëve (të moshës nga0-17 vjeç) me aftësi të kufizuara që u laguan nga kujdesin formal të bazuar në familje gjatë vitit | **Jo** | | | | | MFPT duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFPT |
| T | 4.16 | Numri i të rinjve (të moshës nga 10 -24 vjeç) që u laguan nga kujdesin formal të bazuar në familje gjatë vitit | **Jo** | | | | | MFPT duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFPT |
| T | 4.17 | Numri i fëmijëve (të moshës nga 0–17 vjeç) që u laguan nga strehimin familjar formal gjatë vitit, sipas destinacionit pas largimit nga kujdesi/vdekja e fëmijës | **Jo** | | | | | MFPT duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFPT |
| T | 4.18 | Numri i fëmijëve (të moshës nga 0–17 vjeç) që u laguan nga forma të tjera të kujdesit formal të bazuar në familje gjatë vitit sipas destinacionit pas largimit nga kujdesi/vdekja e një fëmije | **Jo** | | | | | MFPT duhet t'i raportojë të dhënat në baza vjetore | MFPT |

| Lloji | Numri | Treguesi | Raportuar nga institucionet e Kosovës në baza të rregullta | Burimi kryesor i të dhënave | Zbërthimet ekzistuese | Numëruesi | Emëruesi | Propozimi për llogaritjen e treguesit | Institucioni përgjegjës për llogaritjen e këtij treguesi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T | 4.19 | Përqindja e fëmijëve (të moshës nga 0–17 vjeç) në kujdes formal me bazë familjare krahasuar me i numrin e përgjithshëm të fëmijëve në përkujdesje alternative formale në fund të vitit | **Jo** | | | | | | MFLT |
| N | 4.20 | Numri i familjeve strehuese | **Jo** | Të dhënat administrative nga databaza qendrore në departamentin përkatës në MFPT | | Numri i familjeve strehuese të identifikuara nga QPS-ja gjatë një viti | | Duke përdorur të dhënat administrative, MFPT-ja mund ta llogarisë dhe raportojë treguesin | MFLT |
| | **5** | **Adoptimi i fëmijëve** | | | | | | | |
| N | 5.1 | Shkalla  bruto e adoptimit të fëmijëve gjatë një viti | **Jo** | Për numëruesin: Të dhënat administrative nga databaza qendrore në Departamentin për Mirëqenie Sociale, MFPT | | Administrative data from the central database in the Department of Social Welfare, MFLT: Number of adoptions (during the year) | Population data based on annual population estimates produced by KAS: Number of populations under the age of 18 (0–17) in the respective year | Using the numerator and denominator administrative data, KAS can calculate the indicator | KAS |
| N | 5.2 | Numri i fëmijëve (të moshës nga 0-17 vjeç) të adoptuar në vit | **Po** | Të dhënat administrative të mbledhura nga MFPT, të raportuara nga ASK në 'Statistikat e Mirëqenies Sociale, Qershor 2022' | Komuna | | | | MFLT |
| T | 5.3 | Shkalla e adoptimit të fëmijëve (të moshës nga 0-17 vjeç) gjatë vitit, sipas llojit të adoptimit formal (për 100,000) | **Jo** | Të dhënat administrative të mbledhura nga MFPT; | | Administrative data from the central database in the Department of Social Welfare, MFLT: Number of adoptions (during the year) (disaggregated by type of adoption) | Population data based on annual population estimates produced by KAS: Number of population under the age of 18 (0–17) in the respective year, per 100,000 | Using the numerator and denominator administrative data, KAS can calculate the indicator | MFLT |

| Lloji | Numri | Treguesi | Raportuar nga institucionet e Kosovës në baza të rregullta | Burimi kryesor i të dhënave | Zbërthimet ekzistuese | Numëruesi | Emëruesi | Propozimi për llogaritjen e treguesit | Institucioni përgjegjës për llogaritjen e këtij treguesi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T | 5.4 | Përqindja e fëmijëve (të moshës nga 0–17 vjeç) me aftësi të kufizuara që janë adoptuar zyrtarisht gjatë vitit | **Jo** | Të dhënat administrative të mbledhura nga MFPT-ja; | | Administrative data from the central database in the Department of Social Welfare, MFLT: Number of adoptions (during the year) (disaggregated by disability) | Administrative data from the central database in the Department of Social Welfare, MFLT: Number of adoptions (during the year) | Using the numerator and denominator administrative data, MFLT can calculate and report the indicator | MFLT |
| | **6** | **Dhuna dhe Shfrytëzimi i Fëmijëve** | | | | | | | |
| N | 6.1 | Numri i rasteve të fëmijëve që kanë përjetuar dhunë dhe janë raportuar | **Jo** | Policia e Kosovës: të gjitha rastet e raportuara dhe rastet e referuara<br><br>Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale: raste të raportuara<br><br>Ministria e Shëndetësisë: rastet e trajtuara dhe raportuara në nivel të shërbimeve shëndetësore<br><br>Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë: rastet e trajtuara dhe të mbyllura në nivel shkolle | | | | Using the administrative data, KAS can calculate the indicator | Kosovo Police, MoJ |
| T | 6.2 | Numri i fëmijëve viktima të dhunës të regjistruar nga autoritetet e mirëqenies sociale/ së fëmijëve gjatë vitit | **Jo** | | | | | | MFPT |
| T | 6.3 | Numri i fëmijëve viktima të dhunës të regjistruar nga kujdesi shëndetësor gjatë vitit | **Jo** | | | | | | MSH |
| T | 6.4 | Numri i fëmijëve viktima të dhunës të regjistruar nga autoritetet arsimore gjatë vitit | **Jo** | | | | | | MASHTI |

| Lloji | Numri | Treguesi | Raportuar nga institucionet e Kosovës në baza të rregullta | Burimi kryesor i të dhënave | Zbërthimet ekzistuese | Numëruesi | Emëruesi | Propozimi për llogaritjen e treguesit | Institucioni përgjegjës për llogaritjen e këtij treguesi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| N | 6.5 | Përqindja e fëmijëve (mosha 1-17 vjeç) të cilët kanë përjetuar çfarëdo forme të dhunës fizike dhe/ose psikologjike nga kujdestarët gjatë muajit të kaluar | **Jo** | Anketat e amvisërive, si MICS dhe DHSK, me një modul të veçantë për disiplinimin e fëmijëve | | Numri i fëmijëve të moshës 1 vjeç-17 që kanë përjetuar çdo formë ndëshkimi fizik ose dhunë psikologjike (agresiv) gjatë muajit të kaluar | Numri i fëmijëve (popullsia) 1 -17 vjeç të intervistuar | Duke përdorur të dhënat ekzistuese, ASK-ja mund ta llogarisë treguesin | Policia e Kosovës, MD |
| N | 6.6 | Numri i fëmijëve (5 -17 vjeç) të identifikuar si të përfshirë në punë të rënda dhe të rrezikshme | **Jo** | | | | | | Policia e Kosovës, MPB |
| N | 6.7 | Numri i fëmijëve të trafikuar të regjistruar nga autoritetet kompetente | **Jo** | Policia e Kosovës/Departamenti i Trafikimit me Qenie Njerëzore: të gjitha rastet e raportuara dhe të referuara<br><br>Zyra e Prokurorit të Shtetit/Avokimi dhe Asistenca për Viktimat: rastet e trajtuara<br><br>Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale/ Strehimoret (strehimorja shtetërore dhe OJQ të licencuara): rastet e personave të strehuar<br><br>Ministria e Shëndetësisë: rastet e trajtuara dhe raportuara në nivel të shërbimeve shëndetësore | | | | | Policia e Kosovës, MPB |
| N | 6.8 | Numri i viktimave nën 18 vjeç të vrarë për 100,000 banorë | **Jo** | Këshilli Gjyqësor | | Burimi i të dhënave Këshilli Gjyqësor: Numri total i viktimave nën moshën 18 vjeç të vrarë, në bazë të nenit 173 të Kodit Penal, të regjistruar në një vit të caktuar. | Burimi i të dhënave ASK-ja: Numri total i popullsisë rezidente për atë vit, për 100,000 | Duke përdorur të dhënat administrative për numëruesin dhe emëruesin, ASK-ja mund ta llogarisë treguesin | Policia e Kosovës |

| Lloji | Numri | Treguesi | Raportuar nga institucionet e Kosovës në baza të rregullta | Burimi kryesor i të dhënave | Zbërthimet ekzistuese | Numëruesi | Emëruesi | Propozimi për llogaritjen e treguesit | Institucioni përgjegjës për llogaritjen e këtij treguesi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **7** | **Qasja në drejtësi** | | | | | | | |
| T | 7.1 | Përqindja e fëmijëve viktima të krimeve të regjistruara nga policia gjatë vitit (për 100,000) | **Jo** | | | | | | Policia e Kosovës |
| T | 7.2 | Përqindja e fëmijëve dëshmitarë të krimeve të regjistruara nga policia gjatë vitit (për 100,000) | **Jo** | | | | | | Policia e Kosovës |
| | **8** | **Fëmijët me Aftësi të Kufizuara dhe Mbrojtja Sociale** | | | | | | | |
| N | 8.1 | Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që janë përfitues të skemave për aftësitë e kufizuara | **Po** | Të dhënat administrative të mbledhura nga MFPT-ja, të raportuara nga ASK-ja në 'Statistikat e Mirëqenies Sociale, Qershor 2022' | Gjinia, Komuna | | | | MFPT |
| T | 8.2 | Numri i fëmijëve (të moshës nga 0–17 vjeç) që marrin përfitime në formë të parave për aftësitë e kufizuara në fund të viteve | **Jo** | | | | | | MFPT |
| T | 8.3 | Numri i fëmijëve (mosha 0-4) që marrin përfitime në formë të parave për aftësitë e kufizuara në fund të vitit | **Jo** | | | | | | MFPT |
| T | 8.4 | Numri i fëmijëve (5 -9 vjeç) që marrin përfitime për rastin e aftësive të kufizuara në fund të vitit | **Jo** | | | | | | MFPT |
| T | 8.5 | Numri i fëmijëve (10 -15 vjeç) që marrin përfitime për rastin e aftësive të kufizuara në fund të vitit | **Jo** | | | | | | MFPT |
| T | 8.6 | Numri i fëmijëve (16 -17 vjeç) që marrin përfitime në formë të parave për aftësitë e kufizuara në fund të vitit | **Jo** | | | | | | MFPT |
| T | 8.7 | Shpenzimet për rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë përfituar (milionë në monedhën vendore) | **Jo** | | | | | | MFPT |

| Lloji | Numri | Treguesi | Raportuar nga institucionet e Kosovës në baza të rregullta | Burimi kryesor i të dhënave | Zbërthimet ekzistuese | Numëruesi | Emëruesi | Propozimi për llogaritjen e treguesit | Institucioni përgjegjës për llogaritjen e këtij treguesi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **9** | **Fëmijët me Aftësi të Kufizuara** | | | | | | | |
| T | 9.1 | Numri i fëmijëve të regjistruar të moshës nga 5 -9 vjeç me aftësi të kufizuara në fund të vitit | **Jo** | | | | | | Agjencia e Regjistrimit Civil, MFPT |
| T | 9.2 | Numri i fëmijëve të regjistruar të moshës nga 10-15 vjeç me aftësi të kufizuara në fund të vitit | **Jo** | | | | | | Agjencia e Regjistrimit Civil, MFPT |
| T | 9.3 | Numri i fëmijëve të regjistruar të moshës nga 16-17 vjeç me aftësi të kufizuara në fund të vitit | **Jo** | | | | | | Agjencia e Regjistrimit Civil, MFPT |
| T | 9.4 | Numri i fëmijëve të sapo regjistruar të moshës nga 0–17 vjeç me aftësi të kufizuara gjatë vitit | **Jo** | | | | | | Agjencia e Regjistrimit Civil, MFPT |
| T | 9.5 | Numri i rasteve të reja të regjistruar të fëmijëve me aftësi të kufizuara të moshës nga 0-4 vjeç me gjatë vitit | **Jo** | | | | | | Agjencia e Regjistrimit Civil, MFPT |
| T | 9.6 | Numri i rasteve të reja të regjistruar të fëmijëve me aftësi të kufizuara të moshës nga 5-9 vjeç gjatë vitit | **Jo** | | | | | | Agjencia e Regjistrimit Civil, MFPT |
| T | 9.7 | Numri i rasteve të reja të regjistruar të fëmijëve me aftësi të kufizuara 10-15 vjeç me aftësi të kufizuara gjatë vitit | **Jo** | | | | | | Agjencia e Regjistrimit Civil, MFPT |
| T | 9.8 | Numri i rasteve të reja të regjistruar të fëmijëve me aftësi të kufizuara të moshës nga 16 vjeç-17 me aftësi të kufizuara gjatë vitit | **Jo** | | | | | | Agjencia e Regjistrimit Civil, MFPT |
| T | 9.9 | Number of newly registered children aged 5–9 with disabilities during the year | **Jo** | | | | | | Agjencia e Regjistrimit Civil, MFPT |
| T | 9.10 | Number of newly registered children aged 10–15 with disabilities during the year | **Jo** | | | | | | Agjencia e Regjistrimit Civil, MFPT |
| T | 9.11 | Number of newly registered children aged 16–17 with disabilities during the year | **Jo** | | | | | | Agjencia e Regjistrimit Civil, MFPT |

| Lloji | Numri | Treguesi | Raportuar nga institucionet e Kosovës në baza të rregullta | Burimi kryesor i të dhënave | Zbërthimet ekzistuese | Numëruesi | Emëruesi | Propozimi për llogaritjen e treguesit | Institucioni përgjegjës për llogaritjen e këtij treguesi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 10 | Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe arsimimi | | | | | | | |
| N | 10.1 | Përqindja i fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim | **Jo** | | | | | | MASHTI |
| T | 10.2 | Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim, sipas gjinisë dhe llojit të shkollës | **Yes** | Të dhënat administrative të mbledhura dhe gjeneruara nga MASHTI dhe ASK-ja 'Statistikat e Arsimit në Kosovë, 2021/2022' | Gjinia<br>Komuna<br>Lloji i aftësive të kufizuara<br>Përkatësia etnike<br>Klasa | | | Duke përdorur të dhënat administrative, MASHTI mund ta llogarisë dhe raportojë treguesin | MASHTI |
| T | 10.3 | Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim sipas nivelit të Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit (ISCED). | **No** | Të dhënat administrative të mbledhura dhe gjeneruara nga MASHTI dhe ASK-ja 'Statistikat e Arsimit në Kosovë, 2021/2022' | | | | Duke përdorur të dhënat administrative, MASHTI mund të llogarisë dhe raportojë treguesin | MASHTI |

N = Treguesi kombëtar

T = Treguesi i TransMonEE

n/a = Nuk zbatohet

# SHTOJCA B : MJETI PËR RISHIKIMIN E TË DHËNAVE ADMINISTRATIVE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE[29]

## Korniza Kombëtare Ligjore dhe Politike për Mbledhjen e të Dhënave për Mbrojtjen e Fëmijëve

1. A ekziston një plan kombëtar veprimi për mbrojtjen e fëmijëve dhe/ose të drejtave të fëmijëve? Sipas planit kombëtar të veprimit, cilat ministri/institucione janë përgjegjëse për parandalimin dhe reagimin ndaj çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve?
2. A ekziston një kornizë kombëtare ligjore/politike që mandaton mbledhjen e të dhënave administrative për mbrojtjen e fëmijëve nga/nëpër ministri/institucione?
3. A i përcakton korniza kombëtare ligjore ose e politikave standardet/protokollet për menaxhimin e të dhënave, sigurimin e cilësisë dhe ndarjen e të dhënave për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje?
4. A janë zhvilluar tregues kombëtarë në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve?
5. Në nivel kombëtar, a ekziston një institucion/grup teknik i punës përgjegjës për monitorimin e cilësisë së të dhënave administrative lidhur me mbrojtjen e fëmijëve?
6. Në nivel kombëtar, a ekziston një buxhet i dedikuar për monitorimin dhe vlerësimin e të dhënave administrative të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve?
7. A ekzistojnë standarde/protokolle kombëtare për mbledhjen e të dhënave administrative në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nëpër sektorë? Cilat ministri/institucione janë të mandatuara për të mbledhur të dhëna administrative për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve?
8. A ekzistojnë marrëveshje/protokolle ndërinstitucionale për të lehtësuar shkëmbimin e të dhënave administrative për mbrojtjen e fëmijëve nëpër sektorë dhe ministri/institucione?
9. Në nivel kombëtar, a kanë institucionet përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave burime dhe kapacitete të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe financiare për të përpiluar dhe analizuar të dhëna administrative për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjithë sektorët dhe ministritë/institucionet?
10. A ka kapacitete në nivel kombëtar për të publikuar raporte vjetore për mbrojtjen e fëmijëve, përfshirë dhunën, abuzimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve, bazuar në të dhënat administrative nga të gjithë sektorët dhe ministritë/institucionet?
11. A publikohen raportet vjetore kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve duke përdorur të dhëna administrative nga të gjithë sektorët dhe ministritë/institucionet?

## Korniza Kombëtare Ligjore dhe Politike për Mbledhjen e të Dhënave për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

12. A ekziston një ligj/rregullore që përcakton qartë se çfarë është një person me aftësi të kufizuara dhe përcakton kërkesat për identifikimin dhe kategorizimin e aftësive të kufizuara për qëllime të përshtatshmërisë për dispozitat e shërbimit për aftësitë e kufizuara?
13. A ekziston një ligj/rregullore që kërkon përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara?
14. A ekziston një ligj/rregullore që siguron që personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, të kenë të drejta, duke përfshirë transfere të parave?

29 ©Udhëzuesi për Rishikimin e të Dhënave Administrative për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara dhe Mbrojtjen e Fëmijëve u zhvillua nga Dr. Robin Haarr, PhD, Konsulent i Lartë i UNICEF-it. Mos e kopjoni ose mos e përdorni këtë Paketë të Veglave, tërësisht ose pjesërisht, pa citim të duhur. Citim i rekomanduar: Haarr, RN (2022). Pako për Rishikimin e të Dhënave Administrative për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. UNICEF: Prishtinë, Kosovë.

15. A ekziston një plan kombëtar veprimi për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara që përfshin fëmijët me aftësi të kufizuara? Sipas planit kombëtar të veprimit, cilat ministri/institucione janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara?
16. A ekziston një kornizë kombëtare ligjore/politike që mandaton mbledhjen e të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara nga ministritë/institucionet përkatëse?
17. A i përcakton korniza kombëtare ligjore/politike standardet/protokollet për menaxhimin e të dhënave, sigurimin e cilësisë dhe ndarjen e të dhënave për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara?
18. A janë zhvilluar tregues kombëtarë në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara?
19. Në nivel kombëtar, a ekziston një institucion/grup teknik i punës që është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara apo personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët?
20. Në nivel kombëtar, a ekziston një buxhet i dedikuar për monitorimin dhe vlerësimin e të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara apo personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët?
21. A ka kapacitet në nivel kombëtar për të publikuar raporte vjetore për fëmijët me aftësi të kufizuara?

## Sektori i Arsimit

### *Mbrojtja e Fëmijëve në Arsim*

22. A janë shkollat e mandatuara/të detyruara me ligj t'i regjistrojnë çështjet e dyshuara/identifikuara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë dhunën, abuzimin dhe neglizhimin e fëmijëve në shtëpi/familje dhe dhunën apo bullizmin në shkollë?
23. A ka MASHTI formularë standardë që të gjitha shkollat duhet t'i përdorin për të regjistruar incidentet e mbrojtjes së fëmijëve të identifikuara nga shkolla?
24. Çfarë lloj të dhënash/informacionesh (me shpërndarje) mblidhen si pjesë e regjistrimit dhe kërkohen nga udhëzimet/protokollet apo shkolla?
25. Cili është formulari kryesor në të cilin shkollat dhe ministritë regjistrojnë informacionet/të dhënat për çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve?
26. Sa shpesh shkollat grumbullojnë të dhëna administrative për çështjet në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve dhe i ndajnë ato me nivelet rajonale dhe kombëtare të MASHTI-t?
27. A i ka mashti kapacitetet dhe burimet për t'i menaxhuar dhe analizuar të dhënat administrative për çështjet në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në shkolla? Cilat janë boshllëqet?
28. Sa shpesh MASHTI shpërndan të dhëna administrative për çështjet në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në shkolla?
29. Në cilat ministri/institucione MASHTI shpërndan të dhëna administrative për çështjet në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në shkolla?
30. Në çfarë mënyrash MASHTI përdor të dhënat administrative për çështjet në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në shkolla për ndonjërin nga qëllimet e mëposhtme?

### *Fëmijët me aftësi të kufizuara në shkolla*

31. A janë shkollat të obliguara/detyruara me ligj që të regjistrojnë numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm të ulët dhe të lartë?
32. A janë të shkollat të obliguara/detyruara me ligj që të regjistrojnë/shënojnë llojet e ndryshme të aftësive të kufizuara të fëmijëve që janë të regjistruar në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm të ulët dhe të lartë?
33. Çfarë lloje të dhënash/informacionesh (me ndarje) mblidhen për llojet e ndryshme të aftësive

të kufizuara? Cilat janë kategorizimet e aftësive të kufizuara në sistemin e menaxhimit të të dhënave?

34. A ka MASHTI udhëzime/protokolle kombëtare që të gjitha shkollat duhet t'i ndjekin për t'i identifikuar dhe regjistruar informacionet/të dhënat për fëmijët e regjistruar me aftësi të kufizuara?
35. A ka MASHTI formularë standardë që shkollat duhet t'i ndjekin për t'i regjistruar informacionet/të dhënat për fëmijët e regjistruar me aftësi të kufizuara? Çfarë lloje të dhënash/informacionesh (me ndarje) mblidhen?
36. A ka MASHTI udhëzime/protokolle kombëtare që të gjitha shkollat duhet t'i ndjekin për t'i regjistruar informacionet/të dhënat për llojet e shërbimeve arsimore speciale që ofrohen për fëmijët e regjistruar me aftësi të kufizuara?
37. Cili është formulari kryesor në të cilin shkollat dhe MASHTI regjistrojnë informacionet/të dhënat për fëmijët me aftësi të kufizuara?
38. Sa shpesh shkollat grumbullojnë të dhëna administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe i ndajnë ato me nivelet komunale dhe kombëtare të MASHTI-t?
39. A i ka MASHTI KAPACITETET DHE BURIMET E MJAFTUESHME PËR TË MENAXHUAR DHE ANALIZUAR TË DHËNA ADMINISTRATIVE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA? CILAT JANË BOSHLLËQET?
40. Sa shpesh MASHTI shpërndan të dhëna administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara, përfshirë llojet e shërbimeve arsimore speciale të ofruara?
41. Si i përdor MASHTI të dhënat administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara, përfshirë llojet e shërbimeve arsimore speciale të ofruara?

## Sektori i Shëndetësisë

### *Mbrojtja e Fëmijëve në Sektorin e Shëndetësisë*

42. A janë punëtorët shëndetësorë të mandatuar/të detyruar me ligj të regjistrojnë incidente të dhunës, abuzimit dhe/ose sulmit ndaj fëmijëve, të moshës nga 0–17 vjeç? Sulmit seksual/përdhunimit/incestit të një fëmije, të moshës nga 0–17 vjeç? Numrin e fëmijëve viktima që marrin kujdes pas përdhunimit/sulmit seksual?
43. A ka MSH-ja udhëzime/protokolle kombëtare që të gjitha spitalet/institucionet shëndetësore duhet t'i ndjekin për të regjistruar incidentet e dhunës, abuzimit dhe sulmit ndaj fëmijëve, të moshës nga 0-17 vjeç? Sulmit seksual/përdhunimit/incestit të një fëmije, të moshës nga 0–17 vjeç? Numrin e fëmijëve viktima që marrin kujdes pas përdhunimit/sulmit seksual?
44. A ka MSH-ja formularë standardë që spitalet/institucionet shëndetësore duhet t'i ndjekin për t'i regjistruar informacionet/të dhënat për incidentet e dhunës, abuzimit dhe sulmit ndaj fëmijëve, të moshës nga 0-17 vjeç? Sulmin seksual/përdhunimin/incestin ndaj një fëmije, të moshës nga 0–17 vjeç? Numrin e fëmijëve viktima që marrin kujdes pas përdhunimit/sulmit seksual?
45. Çfarë lloj të dhënash/informacionesh (me shpërndarje) mblidhen si pjesë e regjistrimit?
46. Cili është formulari kryesor në të cilin institucionet shëndetësore regjistrojnë/ruajnë informacionet/të dhënat për incidentet e dhunës, abuzimit dhe sulmit ndaj fëmijëve? Incidentet e sulmit seksual/përdhunimit/incestit të fëmijëve? Fëmijët viktima që marrin kujdes pas përdhunimit/sulmit seksual?
47. Cili është formulari kryesor në të cilin Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në nivel komunal regjistron/ruan informacione/të dhëna për dhunën, abuzimin dhe sulmin ndaj fëmijëve? Sulmin seksual/përdhunimin/incestin ndaj fëmijëve? Fëmijët viktima që morën kujdes pas përdhunimit/sulmit seksual?
48. Cili është formulari kryesor në të cilin MSH-ja në nivel kombëtar regjistron/ruan informacionet/të dhënat për dhunën, abuzimin dhe sulmin ndaj fëmijëve? Sulmin seksual/përdhunimin/incestin ndaj fëmijëve? Fëmijët viktima që morën kujdes pas përdhunimit/sulmit seksual?

49. Sa shpesh i grumbullojnë institucionet shëndetësore të dhënat administrative për dhunën, abuzimin dhe/ose sulmin ndaj fëmijëve dhe i ndajnë ato me nivelet komunale dhe kombëtare të MSH-së? Sulmin seksual/përdhunimin/incestin ndaj fëmijëve dhe i ndajnë ato me nivelet komunale dhe kombëtare të MSH-së? Numrin e fëmijëve viktima, nën 18 vjeç, të cilët marrin kujdes pas përdhunimit/sulmit seksual dhe i ndajnë ato me nivelet komunale dhe kombëtare të MSH-së?
50. A i ka MSH-JA KAPACITETET DHE BURIMET E MJAFTUESHME PËR TË MENAXHUAR DHE ANALIZUAR TË DHËNA ADMINISTRATIVE PËR DHUNËN, ABUZIMIN DHE SULMIN SEKSUAL/PËRDHUNIMIN E FËMIJËVE? CILAT JANË BOSHLLËQET?
51. Sa shpesh MSH-ja shpërndan të dhëna administrative për dhunën, abuzimin dhe sulmin seksual/përdhunimin e fëmijëve?
52. A i përdor MSH-ja të dhënat administrative për dhunën, abuzimin dhe sulmin seksual/përdhunimin e fëmijëve për ndonjë nga qëllimet e mëposhtme?

*Fëmijët me Aftësi të Kufizuara*

53. A janë punëtorët shëndetësorë të mandatuar/detyruar me ligj t'i regjistrojnë fëmijët me vonesa në zhvillim? Me aftësi të kufizuara? Fëmijët që mbeten me aftësi të kufizuara për shkak të sëmundjes?
54. A ka MSH-ja udhëzime/protokolle kombëtare që të gjitha spitalet/institucionet shëndetësore duhet t'i ndjekin për t'i regjistruar fëmijët e identifikuar/diagnostikuar/klasifikuar si fëmijë me vonesa në zhvillim? Me aftësi të kufizuara? Fëmijë që mbeten me aftësi të kufizuara për shkak të sëmundjes?
55. A ka MSH-ja formularë standardë që spitalet/institucionet shëndetësore duhet t'i përdorin për t'i regjistruar/shënuar informacionet/të dhënat për fëmijët e identifikuar/diagnostikuar/klasifikuar si fëmijë me vonesa në zhvillim? Me aftësi të kufizuara? Fëmijë që mbeten me aftësi të kufizuara për shkak të sëmundjes?
56. Çfarë lloj të dhënash/informacionesh (me shpërndarje) mblidhen si pjesë e regjistrimit?
57. Cili është formulari kryesor në të cilin institucionet shëndetësore regjistrojnë/ruajnë informacione/të dhëna për fëmijët me aftësi të kufizuara?
58. Cili është formulari kryesor në të cilin departamentet shëndetësore në nivel komunal regjistrojnë/ruajnë informacione/të dhëna për fëmijët me aftësi të kufizuara?
59. Cili është formulari kryesor në të cilin MSH-ja në nivel kombëtar regjistron/ruan informacione/të dhëna për fëmijët me aftësi të kufizuara?
60. Sa shpesh spitalet/institucionet shëndetësore grumbullojnë të dhëna administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe i ndajnë ato me nivelet komunale dhe kombëtare të MSH-së?
61. A i ka MSH-ja kapacitetet dhe burimet e mjaftueshme për të menaxhuar dhe analizuar të dhëna administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara? Cilat janë boshllëqet?
62. Sa shpesh MSH-ja shpërndan të dhëna administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara?
63. A i përdor MSH-ja të dhënat administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara për ndonjë nga qëllimet e mëposhtme?

## Sektori i Mirëqenies Sociale dhe Mbrojtjes së Fëmijëve

64. A janë punëtorët socialë të mandatuar/detyruar me ligj të regjistrojnë informacione/të dhëna për:

- Incidentet e dhunës/abuzimit ndaj fëmijëve?
- Llojet e shërbimeve të cilat ofrohen apo në të cilat kanë qasje fëmijët e cenueshëm, të abuzuar dhe të neglizhuar?
- Fëmijët që jetojnë në përkujdesje alternative formale?
- Fëmijët që janë gjetur duke punuar në format më të këqija të punës së fëmijëve? Fëmijët e trafikuar?

- Fëmijët që jetojnë në amvisëri që marrin grante dhe/ose transfere në para?
- Fëmijët me aftësi të kufizuara që janë përfitues të skemave për aftësitë e kufizuara?

65. A ka MFPT-ja udhëzime/protokolle kombëtare që të gjithë punëtorët socialë duhet t'i përdorin për t'i regjistruar:

- Incidentet e dhunës/abuzimit ndaj fëmijëve?
- Llojet e shërbimeve të cilat ofrohen apo në të cilat kanë qasje fëmijët e cenueshëm, të abuzuar dhe të neglizhuar?
- Fëmijët që jetojnë në përkujdesje alternative formale?
- Fëmijët që janë gjetur duke punuar në format më të këqija të punës së fëmijëve? Fëmijët e trafikuar?
- Fëmijët që jetojnë në familje që marrin grante dhe/ose transfere në para?
- Fëmijët me aftësi të kufizuara që janë përfitues të skemave për aftësitë e kufizuara?

66. Çfarë lloj të dhënash/informacionesh (me shpërndarje) mblidhen si pjesë e regjistrimit/shënimit dhe kërkohen nga udhëzimet/protokollet që kanë të bëjnë me:

- Incidentet e dhunës/abuzimit ndaj fëmijëve?
- Llojet e shërbimeve të cilat ofrohen apo në të cilat kanë qasje fëmijët e cenueshëm, të abuzuar dhe të neglizhuar?
- Fëmijët që jetojnë në përkujdesje alternative formale?
- Fëmijët që janë gjetur duke punuar në format më të këqija të punës së fëmijëve? Fëmijët e trafikuar?
- Fëmijët që jetojnë në familje që marrin grante dhe/ose transfere në para?
- Fëmijët me aftësi të kufizuara që janë përfitues të skemave për aftësitë e kufizuara?

67. A ka MFPT-ja formularë standardë që punëtorët socialë duhet t'i ndjekin për të regjistruar/shënuat informacione/të dhëna për:

- Incidentet e dhunës/abuzimit ndaj fëmijëve?
- Llojet e shërbimeve të cilat ofrohen apo në të cilat kanë qasje fëmijët e cenueshëm, të abuzuar dhe të neglizhuar?
- Fëmijët që jetojnë në përkujdesje alternative formale?
- Fëmijët që janë gjetur duke punuar në format më të këqija të punës së fëmijëve? Fëmijët e trafikuar?
- Fëmijët që jetojnë në familje që marrin grante dhe/ose transfere në para?
- Fëmijët me aftësi të kufizuara që janë përfitues të skemave për aftësitë e kufizuara?

68. Cili është qëllimi i sistemit të sapo zhvilluar të menaxhimit të rasteve?
69. Cilët fëmijë do të mbulohen ose do të përfshihen në sistemin e menaxhimit të rasteve?
70. Si funksionon sistemi i sapo zhvilluar i menaxhimit të rasteve?
71. Cilët janë kontribuesit/të dhënat hyrëse në sistemin e menaxhimit të rasteve?
72. Cilët janë përdoruesit e sistemit të menaxhimit të rasteve?
73. Si do ta përmirësojë sistemi i menaxhimit të rasteve mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave?
74. Çfarë lloj të dhënash dhe raportesh do të gjenerohen në mënyrë të rregullt nga sistemi i menaxhimit të rasteve?
75. Sa shpesh MFPT-ja grumbullon të dhëna administrative për:

- Incidentet e dhunës/abuzimit ndaj fëmijëve?
- Llojet e shërbimeve të cilat ofrohen apo në të cilat kanë qasje fëmijët e cenueshëm, të abuzuar dhe të neglizhuar?
- Fëmijët që jetojnë në përkujdesje alternative formale?

- Fëmijët që janë gjetur duke punuar në format më të këqija të punës së fëmijëve? Fëmijët e trafikuar?
- Fëmijët që jetojnë në familje që marrin grante dhe/ose transfere në para?
- Fëmijët me aftësi të kufizuara që janë përfitues të skemave për aftësitë e kufizuara?

76. A i ka MFPT-JA KAPACITETET DHE BURIMET E MJAFTUESHME PËR TË MENAXHUAR DHE ANALIZUAR TË DHËNA ADMINISTRATIVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE, NË TË GJITHA FORMAT QË KEMI DISKUTUAR? CILAT JANË BOSHLLËQET?
77. Sa shpesh MFPT-ja shpërndan të dhëna administrative për mbrojtjen e fëmijëve?
78. A i përdor MFPT-ja të dhënat administrative për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve për ndonjë nga qëllimet e mëposhtme?

## Sektori i Policisë

79. A është Policia e Kosovës e mandatuar/detyruar me ligj t'i regjistrojë të dhënat për:

- Fëmijët viktima të krimeve?
- Fëmijët dëshmitarë të krimeve? Krimet ndaj fëmijëve?
- Fëmijët viktima të vrasjeve, përfshirë vrasjet me dashje dhe pa dashje?
- Punën e fëmijëve dhe/ose fëmijët e përfshirë në punë të rrezikshme?
- Llojet e mbrojtjes/shërbimeve të ofruara për fëmijët viktima të krimit? Fëmijët në punë dhe/ose punë të rrezikshme?

80. A ka Policia e Kosovës udhëzime/protokolle kombëtare që zyrtarët policorë duhet t'i zbatojnë për të regjistruar informacione për:

- Fëmijët viktima të krimeve?
- Fëmijët dëshmitarë të krimeve? Krimet ndaj fëmijëve?
- Fëmijët viktima të vrasjeve, përfshirë vrasjet me dashje dhe pa dashje?
- Punën e fëmijëve dhe/ose fëmijët e përfshirë në punë të rrezikshme?
- Llojet e mbrojtjes/shërbimeve të ofruara për fëmijët viktima të krimit? Fëmijët në punë dhe/ose punë të rrezikshme?

81. A ka Policia e Kosovës formularë standardë që zyrtarët policorë duhet t'i përdorin për të regjistruar/shënuar informacionet për:

- Fëmijët viktima të krimeve?
- Fëmijët dëshmitarë të krimeve? Krimet ndaj fëmijëve?
- Fëmijët viktima të vrasjeve, përfshirë vrasjet me dashje dhe pa dashje?
- Punën e fëmijëve dhe/ose fëmijët e përfshirë në punë të rrezikshme?
- Llojet e mbrojtjes/shërbimeve të ofruara për fëmijët viktima të krimit? Fëmijët në punë dhe/ose punë të rrezikshme?

82. Çfarë lloj të dhënash/informacionesh (me shpërndarje) mblidhen si pjesë e regjistrimit/shënimit dhe kërkohen sipas udhëzimeve/protokolleve?
83. Cili është formulari kryesor në të cilin Policia e Kosovës regjistron/ruan të dhënat për:

- Fëmijët viktima të krimeve?
- Fëmijët dëshmitarë të krimeve? Krimet ndaj fëmijëve?
- Fëmijët viktima të vrasjeve, përfshirë vrasjet me dashje dhe pa dashje?
- Punën e fëmijëve dhe/ose fëmijët e përfshirë në punë të rrezikshme?
- Llojet e mbrojtjes/shërbimeve të ofruara për fëmijët viktima të krimit? Fëmijët në punë dhe/ose punë të rrezikshme?

84. Sa shpesh i grumbullon Policia e Kosovës të dhënat administrative për:

- Fëmijët viktima të krimeve?

- Fëmijët dëshmitarë të krimeve? Krimet ndaj fëmijëve?
- Fëmijët viktima të vrasjeve, përfshirë vrasjet me dashje dhe pa dashje?
- Punën e fëmijëve dhe/ose fëmijët e përfshirë në punë të rrezikshme?
- Llojet e mbrojtjes/shërbimeve të ofruara për fëmijët viktima të krimit? Fëmijët në punë dhe/ose punë të rrezikshme?

85. A i ka Policia e Kosovës kapacitetet dhe burimet e mjaftueshme për të menaxhuar dhe analizuar të dhëna administrative për fëmijët viktima dhe dëshmitarë të krimeve? Krimet kundër fëmijëve dhe vrasjet e fëmijëve? Fëmijët në punë dhe në punë të rrezikshme?
86. Cilat janë boshllëqet?
87. Sa shpesh i shpërndan Policia e Kosovës të dhënat administrative për fëmijët viktima dhe dëshmitarë të krimeve? Krimet kundër fëmijëve dhe vrasjet e fëmijëve? Fëmijët në punë dhe në punë të rrezikshme?
88. A i përdor MPB-ja të dhënat administrative për fëmijët viktima dhe dëshmitarë të krimeve? Krimet kundër fëmijëve dhe vrasjet e fëmijëve? Fëmijët në punë dhe në punë të rrezikshme? Për çfarë qëllimesh?

## Sektori i Drejtësisë

89. A janë prokurorët e mandatuar/detyruar me ligj t'i regjistrojnë:

- Numrin e rasteve të krimeve ndaj fëmijëve që hetohen nga Prokuroria?
- Numrin e rasteve të krimeve ndaj fëmijëve të nxjerra në gjyq nga Prokuroria?
- Autorët e dënuar për krime kundër fëmijëve apo në të cilat një fëmijë ka qenë viktimë?
- Numrin e fëmijëve viktima që kanë marrë mbrojtje/ndihmë dhe mbështetje ligjore në procedurat gjyqësore?
- Numrin e fëmijëve të dyshuar ose të akuzuar në procedurë penale të pajisur me ndihmë dhe përfaqësim ligjor?

90. A ka MD-ja udhëzime/protokolle kombëtare që prokurorët duhet t'i ndjekin për t'i regjistruar/shënuar rastet e:

- Krimeve ndaj fëmijëve që hetohen nga Prokuroria?
- Krimeve ndaj fëmijëve të nxjerra në gjyq nga Prokuroria?
- Autorëve të dënuar për krime kundër fëmijëve apo në të cilat një fëmijë ka qenë viktimë?
- Fëmijëve viktima që kanë marrë mbrojtje/ndihmë dhe mbështetje ligjore në procedurat gjyqësore?
- Fëmijëve e dyshuar apo të akuzuar në procedurë penale të pajisur me ndihmë dhe përfaqësim ligjor?

91. A ka MD-ja formularë standardë që prokurorët duhet t'i përdorin për t'i regjistruar të dhënat/informacionet për:

- Krimet ndaj fëmijëve që hetohen nga Prokuroria?
- Krimet ndaj fëmijëve të nxjerra në gjyq nga Prokuroria?
- Autorët e dënuar për krime kundër fëmijëve apo në të cilat një fëmijë ka qenë viktimë?
- Fëmijët viktima që kanë marrë mbrojtje/ndihmë dhe mbështetje ligjore në procedurat gjyqësore?
- Fëmijët e dyshuar apo të akuzuar në procedurë penale të pajisur me ndihmë dhe përfaqësim ligjor?

92. Çfarë lloj të dhënash/informacionesh (me shpërndarje) mblidhen si pjesë e regjistrimit dhe kërkohen sipas udhëzimeve/protokolleve?
93. Cili është formulari kryesor në të cilin Këshilli Prokurorial dhe/ose Gjyqësor regjistron të dhënat për çështjet që përfshijnë:

- Krimet ndaj fëmijëve që hetohen nga Prokuroria?
- Krimet ndaj fëmijëve të nxjerra në gjyq nga Prokuroria?
- Autorët e dënuar për krime kundër fëmijëve apo në të cilat një fëmijë ka qenë viktimë?

- Fëmijët viktima që kanë marrë mbrojtje/ndihmë dhe mbështetje ligjore në procedurat gjyqësore?
- Fëmijët e dyshuar apo të akuzuar në procedurë penale u ofrohet ndihmë dhe përfaqësim ligjor?

94. Sa shpesh Këshilli Prokurorial dhe/ose Gjyqësor mbledh të dhëna administrative për:

- Krimet ndaj fëmijëve që hetohen nga Prokuroria?
- Krimet ndaj fëmijëve të nxjerra në gjyq nga Prokuroria?
- Autorët e dënuar për krime kundër fëmijëve apo në të cilat një fëmijë ka qenë viktimë?
- Fëmijët viktima që kanë marrë mbrojtje/ndihmë dhe mbështetje ligjore në procedurat gjyqësore?
- Fëmijët e dyshuar apo të akuzuar në procedurë penale u ofrohet ndihmë dhe përfaqësim ligjor?

95. A i ka MD-ja kapacitetet dhe burimet e mjaftueshme për t'i menaxhuar dhe analizuar të dhënat administrative për rastet që përfshijnë krimet kundër fëmijëve, duke përfshirë të dhënat/informacionet për fëmijët viktima dhe dëshmitarë të krimeve, dhe autorët e krimeve kundër fëmijëve? Cilat janë boshllëqet?
96. Sa shpesh MD-ja shpërndan të dhëna administrative për:

- Krimet ndaj fëmijëve që hetohen nga Prokuroria?
- Krimet ndaj fëmijëve të nxjerra në gjyq nga Prokuroria?
- Autorët e dënuar për krime kundër fëmijëve apo në të cilat një fëmijë ka qenë viktimë?
- Fëmijët viktima që kanë marrë mbrojtje/ndihmë dhe mbështetje ligjore në procedurat gjyqësore?
- Fëmijët e dyshuar apo të akuzuar në procedurë penale u ofrohet ndihmë dhe përfaqësim ligjor?

97. A i përdor MD-ja të dhënat administrative për rastet që përfshijnë krimet kundër fëmijëve, duke përfshirë të dhënat/informacionet për fëmijët viktima dhe dëshmitarë të krimeve dhe autorët e krimeve kundër fëmijëve? Për çfarë qëllimesh?

### Ofruesit e shërbimeve të OJQ-ve/OSHC-ve

98. A janë ofruesit e shërbimeve të OJQ-ve/OSHC-ve që punojnë me fëmijë të mandatuar/detyruar me ligj t'i regjistrojnë informacionet rreth fëmijëve për llojin e shërbimeve të ofruara?
99. A janë ofruesit e shërbimeve të OJQ-ve/OSHC-ve që punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara të mandatuar/detyruar me ligj ta regjistrojnë/shënojnë llojin e shërbimeve të ofruara?
100. A ka Kosova udhëzime/protokolle kombëtare që kërkojnë që ofruesit e shërbimeve të OSHC-ve/OJQ-ve ta mbledhin një grup minimal të të dhënave për fëmijët dhe llojin e shërbimeve/mbrojtjes që ata ofrojnë?
101. Çfarë lloj të dhënash/informacionesh (me shpërndarje) mblidhen si pjesë e regjistrimit dhe kërkohen sipas udhëzimeve/protokolleve?
102. Cili është formulari kryesor në të cilin stafi i OSHC-ve/OJQ-ve regjistron/ruan të dhënat për fëmijët dhe shërbimet që ata ofrojnë për fëmijët?
103. A u kërkohet ofruesve të shërbimeve të OJQ-ve/OSHC-ve t'i ndajnë me autoritetet komunale të dhënat për numrin dhe llojet e fëmijëve të shërbyer dhe llojet e shërbimeve të ofruara në baza vjetore? Nëse po, me kë i ndajnë të dhënat?
104. Sa shpesh ofruesi i shërbimeve i OSHC-ve/OJQ-ve i grumbullon të dhënat administrative për fëmijët dhe shërbimet që u ofrohen fëmijëve? Në cilat ministri/agjenci?
105. A i kanë OSHC-të/OJQ-të kapacitetet dhe burimet e mjaftueshme për t'i menaxhuar dhe analizuar të dhënat administrative për fëmijët dhe llojet e shërbimeve të ofruara? Cilat janë boshllëqet?
106. Sa shpesh ofruesi i shërbimeve i OSHC-ve/OJQ-ve shpërndan të dhëna administrative të grumbulluara për numrin dhe llojet e fëmijëve që u shërbejnë dhe llojet e shërbimeve të ofruara?
107. A përdor OSHC-ja/OJQ-ja të dhëna administrative për numrin dhe llojet e fëmijëve që u shërbejnë dhe llojet e shërbimeve të ofruara për ndonjë nga qëllimet e mëposhtme?

Funded by
the European Union

unicef
for every child

